

1 E martë, 11 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, paraqisni çështjen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Të

8 nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori

9 i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Konstatoj praninë e të akuzuarve në sallën e gjyqimit.

13 Do vazhdojmë me marrjen e dëshmisë së Dëshmitarit të

14 Mbrojtjes së Thaçit, 1DW-008.

15 Znj. Sekretare, sillni Dëshmitarin në sallë, ju lutem.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,

18 Ambasadori Hill. Uroj të kenë kaluar mbrëmje të këndshme.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk do të thoja se ishte kaq e

20 mirë, por...

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Aq sa mund të

22 jetë.

23 Ju kujtoj që të përpiqeni t'u përgjigjeni pyetjeve në

24 mënyrë të shkurtër, me përgjigje të shkurtra, fjali të

25 shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni ndonjë pyetje, kërkojini

1 Avokatit apo Prokurorit që të përsërisë pyetjen. Ose që ju nuk  
2 e kuptoni, dhe kërkoni qartësime. Gjithashtu, përpiquni të  
3 tregoni bazën mbi të cilën mbështetni njohurinë tuaj të  
4 fakteve dhe rrethanave për të cila merreni në pyetje.

5 Ju kujtoj gjithashtu që jeni akoma nën detyrimin për të  
6 thënë të vërtetën, siç keni deklaruar në betimin solemn.

7 Ju lutem, flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda  
8 përpara se të përgjigjeni, me qëllim që përkthyesit të  
9 përkthejnë.

10 Nëse keni nevojë të bëni pushim, ju lutem na thuani dhe  
11 do t'ju mundësojmë këtë gjë.

12 Së fundi, sa i takon përfaqësuesit të Shtetet e Bashkuara  
13 të Amerikës, ju faleminderit për praninë tuaj sot. Ju kujtoj  
14 se në qoftë se keni nevojë të flisni me Dëshmitarin apo t'i  
15 drejtoheni Trupit Gjykses mund të ngrini dorën dhe ju japim  
16 leje të bëni këtë gjë.

17 Që ta dini, sot orari i punës do jetë ndryshe nga dje. Do  
18 bëjmë një orë, pastaj do bëjmë një dhjetëminutësh pushim.  
19 Pastaj një orë tjetër, pra deri në orën 11.00. Dhe aty do  
20 bëjmë një gjysmë ore pushim deri në orën 11.30. Pastaj do  
21 vazhdojmë përsëri deri në orën 13.00 dhe do bëjmë pushimin e  
22 drekës. Pas pushimit të drekës, fillojmë në orën 14.00 deri në  
23 orën 16.00. Uroj që të përfundojmë me këtë në orën 16.00. Mund  
24 të ndodhë që të përfundojmë edhe më herët, por shohim se si do  
25 të shkojë.

Dëshmitari: Christopher Hill (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 3

1

2 Z. Misetic, e keni fjalën ju.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 DËSHMITARI: CHRISTOPHER HILL [Vijon]

5 Pyetje nga z. Misetic: [Vazhdim]

6 PY. Mirëmëngjesi, Ambasador.

7 PË. Mirëmëngjesi.

8 PY. Që të vazhdojmë aty ku e lamë dje, do të doja të  
9 kthehemi, të kalojmë tani tek fushata e bombardimeve ajrore të  
10 NATO-s. Kur filloi kjo fushata, kishit ndonjë kontakt me z.  
11 Thaçi?

12 PË. Jo.

13 PY. A patët ndonjë kontakt me të ashtuquajturën qeveri të  
14 përkohshme të Kosovës?

15 PË. Jo. Që të jap pak kontekst, kur filluan bombardimet e  
16 NATO-s, unë u ktheva tek detyra ime parësore, ajo që më ishte  
17 dhënë, që ishte Ambasador në Maqedoni, dhe përgjegjësitë e mia  
18 ishin që të kujdesesha për Ambasadën.

19 PY. Faleminderit. A vazhduat të ishit i përfshirë në mënyrë  
20 aktive në zgjidhjen e konfliktit të Kosovës gjatë fushatës së  
21 bombardimeve ajrore të NATO-s?

22 PË. Kam patur biseda me njerëz në Uashington, por kryesisht  
23 jam marrë me ambasadën time në Shkup, ku kishte patur mijëra  
24 persona që protestuan, bënë pra demonstrata.

25 PY. Ju kujtohet çfarë keni qenë duke bërë, cila ka qenë

1 detyra jua, puna jua, në përfundim të konfliktit në Kosovë?

2 PË. E keni fjalën për fundin e fushatës ajrore të

3 bombardimeve?

4 PY. Po.

5 PË. Dua të bëj një ndryshim këtu lidhur me atë që thashë. Kur  
6 thashë që po punoja në Maqedoni, lidhur me Maqedoninë. Në një  
7 moment të caktuar gjatë fushatës së bombardimeve, z. Rugova i  
8 cili ishte mbajtur kundër dëshirës së tij në Beograd, shkoi në  
9 Vatikan. Ai u lirua nga Beogradi dhe shkoi në Vatikan pas  
10 ftesës, që ishte Shën Gjeorgjia, që është një lloj, si lloj  
11 ministrie e punëve të jashtme të Vatikanit. Në pjesën e  
12 fundit, pra drejt përfundimit të fushatës ajrore të  
13 bombardimeve.

14 Mua m'u kërkua që ta kontaktoj, ta takoj atë dhe që të  
15 kuptoj se cilat ishin synimet e tij, qëllimet e tij, nëse po  
16 planifikonte të jepte ndonjë deklaratë publike lidhur me  
17 fushatën e bombardimeve. Unë bëra këtë gjë. Ai nuk kishte  
18 planifikuar në mend që të jepte deklarata publike, dhe u  
19 ktheva në Shkup.

20 Për t'iu përgjigjur pyetjes suaj kur përfundoi fushata e  
21 bombardimeve, ka qenë dita kur komanda e lartë e NATO-s bëri  
22 një takim, një mbledhje, në Kumanovë, në Maqedoninë e Veriut,  
23 për të biseduar me ushtrinë serbe lidhur me planet për të, në  
24 mënyrë që ushtria serbe dhe forcat e policisë të largoheshin  
25 nga Kosova dhe të zëvendësoheshin nga personeli i NATO-s, që

1 do të merrnin përgjegjësinë pastaj për çështjet e sigurisë.

2 Atë mbrëmje, nuk më kujtohet data e saktë, por ka qenë në  
3 fillim të qershorit, unë isha me disa shokë macedonas dhe ne  
4 u, ishim shumë të kënaqur, pra, u gëzuam me përfundimin e  
5 mundshëm të këtij konflikti, pra siç paraqitej.

6 U ktheva në shtëpi atë natë dhe sapo hyra në shtëpi, pra,  
7 mora një telefonatë, thirrje telefonike nga një zyrtar  
8 amerikan, i cili ishte në kamp refugjatësh dhe raportonte se  
9 aty kishte probleme në kamp, pra, kishte pakënaqësi që  
10 shpreheshin dhe më kërkoi në qoftë se mund të shkoja aty për  
11 të ndihmuar, për të qetësuar situatën. Kjo ishte vonë, pra  
12 rreth orës 22.00 të mbrëmjes.

13 E pyeta atë që të përshkruante problemet që po ndodhin  
14 aty. Më tha që me një zë shumë të shqetësuar se njerëzit që  
15 jetojnë, personat që ishin në kamp kishin gjetur një familje  
16 romësh për të cilën njerëzit besonin se ishin të përfshirë në  
17 një lloj njësiti serb i cili shkatërronte shtëpi në disa  
18 fshatra, në një fshat të caktuar. Nuk ishte e qartë, pra, por  
19 kjo ishte një përpjekje për të bërë drejtësinë ndaj kësaj  
20 familjeje romësh. Dhe familja romë ishte marrur nga një  
21 organizatë joqeveritare gjermane, siç e kuptova atë që m'u tha  
22 përmes telefonit, ishin dërguar në një ndërtesë, dhe  
23 mbroheshin nga kjo organizatë joqeveritare gjermane, por ishin  
24 të rrethuar nga njerëz shumë të zemëruar që gjendeshin në  
25 kamp.

1           Mua më kërkuan që të shkoj në kamp dhe të përpigem të  
2   qetësoj situatën. Gjithashtu, zyrtari amerikan më kërkoi që,  
3   në qoftë se kisha mundësi të kontaktoja qeverinë maqedonase  
4   dhe t'u kërkoja atyre që të dërgonin forca policore sepse  
5   mendonin se përfshirja apo ndërhyrja e policisë maqedonase në  
6   kampin e refugjatëve, pra më kërkoi që të mos -- qeveria  
7   maqedonase të mos dërgonte forca policore, sepse ata mendojnë  
8   që kjo do të përkeqësonte situatën.

9           Unë bëra këtë gjë dhe u pajtova që të shkoj në kamp atë  
10   natë rreth orës 23.00.

11   PY.   Faleminderit. Ju e dini miratimin, jeni në dijeni të  
12   miratimit të Rezolutës 1244?

13   PË.   Po.

14   PY.   A mund të na thoni detyrën, cila ishte detyra juaj kur  
15   lufta mes UÇK-së dhe forcave serbe përfundoi? Pra, sa kishit  
16   mundësi ju të vërenit.

17   PË.   Për atë sa e kisha mundësi të shihja, në ato ditë të  
18   menjëhershme pas takimit në Kumanovë, serbët filluan të  
19   tërhiqeshin nga Kosova. Njësitë policore e ushtarake serbe  
20   filluan të tërhiqeshin nga Kosova, NATO-ja filloi të futej në  
21   Kosovë, ku ishte vendosur paraprakisht, përfshirë, pra, dhe në  
22   Maqedoni. Pra, lëvizi nga Maqedonia në Kosovë dhe filloi të  
23   patrullonte, të kontrollonte situatën në Kosovë.

24   PY.   Faleminderit. A ndodhi në ndonjë moment të caktuar që  
25   Presidenti Klinton bëri vizitë në rajoni në verë të 1999?

1 PË. Po. Presidenti Klinton erdhi në rajon. Ai erdhi pak kohë  
2 pas përfundimit të luftimeve dhe hyrjes së NATO-s në Kosovë.  
3 Ai erdhi në Maqedoni për të falënderuar autoritetet maqedonase  
4 për mikpritjen, strehimin e shumë refugjatëve. Shkoi dhe  
5 vizitoi gjithashtu një kamp për refugjatët dhe inkurajoi  
6 njerëzit që të mos ktheheshin në shtëpitë e tyre derisa  
7 autoritetet e NATO-s të thonin që ishte e sigurt që ata të  
8 ktheheshin.

9 PY. Ju kujtohet në qoftë se kishte ndonjë shqetësim lidhur me  
10 praninë pra dërgimin e Presidentit Klinton në një zonë ku një  
11 konflikt i armatosur ishte në zhvillim e sipër?

12 PË. Nuk mund të dëshmoj për shqetësimet që mund të më jenë  
13 thënë mua. Unë mund të imagjinoj se ekipi i sigurisë së tij  
14 ishte i shqetësuar për praninë e tij në një vend që ishte afër  
15 një zone lufte. Thënë këtë, nuk më kujtohet të ketë patur  
16 ndonjë incident apo probleme gjatë vizitës së tij.

17 PY. Ambasador Hill, ju jeni pyetur në të kaluarën, a ju është  
18 kërkuar në të kaluarën që të intervistoheni nga prokurorët apo  
19 avokatët e mbrojtjes në çështje të krimeve të luftës  
20 ndërkombëtare?

21 PË. Disa vite më vonë, po e them këtë në periudhën kohore  
22 2002-2003 kur isha Ambasador në Varshavë, m'u kërkuar të  
23 dëshmoj në një tribunal për krime lufte. Unë isha, punoja,  
24 isha nëpunës i shërbimit të jashtëm dhe Ambasador në Poloni,  
25 dhe ndonëse nuk e refuzova bisedën me njerëzit në

1 Departamentin, me personat në Departamentin e Shtetit, nuk e  
2 refuzova këtë gjë, megjithatë bisedova me personat përgjegjës  
3 në Departamentin e Shtetit dhe thashë që preferoja të vazhdoja  
4 me funksionet e mia aktuale të cilat i kisha dhe, pra që të  
5 vazhdoja si Ambasador në Poloni.

6 PY. A jeni pajtuar, a ishit pajtuar paraprakisht që të  
7 intervistoheshit apo të jepnit dëshmi në Gjykime për krime  
8 lufte apo në hetime të tilla?

9 PË. Jo, me sa më kujtohet, jo. Prokurori në fakt erdhi dhe më  
10 takoi në Varshavë, në zyrën time. Emri i tij ishte, kujtohet  
11 lehtë, Geoffrey Nice. Pata një bisedë me të. Pas kësaj, shkova  
12 në Uashington për konsultime lidhur me çështje që kishin të  
13 bëjnë me Poloninë dhe u takova me përfaqësuesin ligjor të  
14 Departamentit të Shtetit, që ka emrin Taft, gjithashtu  
15 bisedova me Zëvendës Sekretarin e shtetit, Richard Armitage,  
16 lidhur me preferencën time pra që unë nuk doja të përfshihesha  
17 në këto gjëra.

18 PY. Pse vendosët të përfshiheshit në këtë gjykim, dhe u  
19 pajtuat të ishit këtë radhë dëshmitar i thirrur nga Hashim  
20 Thaçi?

21 PË. Tani, koha nuk i shëron të gjitha, siç thuhet, të gjitha  
22 plagët, por mendoj që pas 25 vitesh është kohë e madhe që të  
23 mendohet gjërat, nuk kam arsye, pikë së pari nuk kam arsye të  
24 besoj se z. Thaçi ishte përfshirë në aktivitetet e tilla, nuk  
25 kam arsye të besoj dhe as nuk kam dëgjuar në atë kohë që ai të



1 ketë urdhëruar aktivitete të tilla, apo veprimtari të tilla të  
2 paligjshme. Dhe me sa, siç e kuptoj unë, ai është mbajtur i  
3 burgosur për një kohë të caktuar lidhur me këto çështje, pra  
4 ndjeva kur m'u kërkua kjo gjë, nuk u kontaktova njerëz --  
5 njerëzit më kontaktuan mua, dhe ndjeva që duhet të thoja atë  
6 që dihej lidhur me situatën.

7 PY. Faleminderit, z. Ambasador Hill që erdhët dhe dhatë  
8 dëshmi.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Me kaq përfundon marrja në pyetje  
10 e imja.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
12 z. Misetiç.

13 Z. Dixon, nuk keni pyetje?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] E njëjta gjë, i nderuar Gjykatës,  
17 nuk kemi pyetje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Z. Ellis?

20 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të më jepet një kohë, një  
21 moment që të bisedoj me përfaqësuesin e Departamentit të  
22 Shtetit, sepse nuk kam ide se për -- me kë keni biseduar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Absolutisht,  
24 që po.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A dëshironi  
2 të largoheni nga salla e gjyqit?

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, thjesht të konsultohem me të.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e di kush është kush, pra.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju  
7 tregoj edhe unë, pikë së pari, z. Ellis që përfaqëson z.  
8 Krasniqi.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo më  
11 ndihmon.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. Ndoshta është e gjitha  
13 ajo që duhet të di. Mjafton.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
15 Vazhdoni.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Po.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të duhet  
21 të kisha përdorur emrin e z. Krasniqi, që është Jakup  
22 Krasniqi.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

25 Z. ELLIS: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjesi, z. Ambasador. Kërkoj ndjesë, nuk jam  
2 prezantuar. Unë jam Aidan Ellis, përfaqësoj Jakup Krasniqin.  
3 Kam disa pyetje sot në mëngjes, në vijim të çështjeve që u  
4 diskutuan gjatë dëshmisë suaj dje.

5 PË. Në rregull.

6 PY. Pyetja e parë ka të bëjë me një pjesë të intervistës në  
7 dokumentin e Blerim Shalës, që është DHT12206 deri në 12372,  
8 në faqen DHT12292.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se mund ta shfaqim në  
10 ekran, ju lutem.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Ellis, neve sa po na  
12 thanë që nuk e kemi marrë listën e dokumenteve që do të duhej  
13 të ishin paraqitur, pra do të përdorin atë që përdori Thaçi. A  
14 mund të siguroheni që kjo është me, është pra, lista e  
15 dokumenteve është dërguar te Zyra Administrative?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Sapo më thanë që është në proces të  
17 dërgimit dhe, pra versionin do t'ju vijë së shpejti, por mund  
18 të vazhdojë ndërkohë me versionin e z. Thaçi për këtë çështje.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, sepse do të doja të  
21 kaloj te dy faqe në, të dokumentit, ndoshta mund të ndihmojë  
22 që të përdorim versionin, atë version në vend të versionit të  
23 provës materiale të pranuar.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Juve ju bënë disa

1 pyetje dhe lidhur me pjesën ku fillon me pyetjen e z. Shala ku  
2 thotë:

3 "Në atë periudhë kohore, e dini kush ishte përgjegjës i  
4 UÇK-së, kush ishte personi më i rëndësishëm në UÇK?

5 Përgjigja juaj ishte:

6 "Nuk ishte, nuk mund të kishte sukses po të kërkoje kush  
7 ishte përgjegjës i UÇK-së".

8 Tani, dhe juve ju bënë disa pyetje lidhur me të, mendoj  
9 nga Gjykatësi Gaynor, lidhur me periudhën kohore për të cilën  
10 bëhej fjalë. Dhe përgjigja juaj ishte:

11 "Në fund të verës, fillim të vjeshtës 1998".

12 Pra, ajo që dua t'ju bëj është që t'ju tregoj dy faqe më  
13 herët në këtë dokument, dhe të përpiqemi të gjejmë që të  
14 ndihmojmë, pra, për të gjetur datën për të cilën bëhet fjalë.  
15 PË. Në rregull.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë dy faqe më përpara, ju  
17 lutem, në 12290. Dhe mund të kalojmë në fund të faqes.

18 PY. E shikoni, z. Shala fillon duke bërë pyetje lidhur me  
19 diçka që ishte refuzuar nga, hedhur poshtë nga diplomacia  
20 franceze në dhjetor të 1998, dhe pastaj vazhdon më tej në fund  
21 të faqes me pyetjen:

22 "... në dhjetor të 1998 ju ishit duke ecur drejt idesë,  
23 pra që të, duhej të bëhej një konferencë ndërkombëtare."

24 E shikoni këtë?

25 PË. Po, e shoh. Nuk jam i sigurt nëse më kujtohet a jam

1 pyetur për konferencën ndërkombëtare deri në momentin kur  
2 Madeleine Albright më thirri, që besoj ka ndodhur më vonë se  
3 sa në periudhën e dhjetorit. Duhet të shtoj se ka ndodhur  
4 shpesh në këto rrethana, pra në rrethana konflikti ku ishte  
5 secili me, të cilin ishte shumë e vështirë të zgjidhej.  
6 Ndodhte shpesh, ndodh shpesh që njerëzit të thonë pse të mos i  
7 mbledhim të gjithë së bashku në një dhomë dhe me siguri do të  
8 jemi në gjendje ta zgjidhim këtë problem.

9 Unë nga ana ime isha skeptik se një konferencë apo  
10 organizimi i një konference mund të zgjidhte këtë çështje. Për  
11 më tepër isha skeptik dhe në fakt i lodhur nga ideja se  
12 Dejtoni ishte modeli për të zgjidhur problemin e Kosovës, i  
13 cili mua më dukej një konflikt, unë e gjykoja si një konflikt  
14 shumë ndryshe.

15 PY. E kuptoj këtë.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tek  
17 faqja tjetër, faqja 12291.

18 PY. Së pari, në qoftë se mund të kalojmë në mes të faqes.  
19 ku përgjigja juaj është shënuar se -- ku ju thoni:

20 "Në rastet kur ka dyshime, është gjithmonë ideja" --

21 PË. Po.

22 PY. -- "që të bëjmë një konferencë". Në këtë paragraf ju  
23 shprehni të njëjtën ide që ju përmendët sot në mëngjes, pra se  
24 njerëzit ishin gjithmonë, vazhdimisht propozonin një  
25 konferencë, por që ju vetë ishit pak skeptik lidhur me atë që

1 mund të arrihej në këtë rast konkret.

2 PË. Është interesante që pas 25 vjetësh të këtyre komenteve  
3 që kam bërë, kam të njëjtin vlerësim lidhur me këto, apo të  
4 njëjtin mendim për këto konferenca, apo konferenca të tilla.

5 PY. Në rregull.

6 PË. Pra, për t'iu përgjigjur pyetjes tuaj, po.

7 PY. Dhe shiheni që menjëherë pas përgjigjes z. Shala ju bën:

8 "Një pyetje tjetër, që është, kush ishte në të vërtetë në  
9 fakt, kush i mbante kontaktet me UÇK-në në vjeshtë dhe dimër  
10 të 1999 ... Larry Rossin ishte pak a shumë përgjegjës për  
11 këtë?"

12 Mendohet kjo, pra, në vjeshtë të 1998, dhe jo në janar të  
13 1999.

14 PË. Po, data është e gabuar. Larry Rossin ishte në atë kohë  
15 Ndhmës Sekretari i shtetit. Larry ishte i ri në këto, me  
16 përvojë jo të madhe në këto çështje, pra, nuk e di nëse  
17 Blerimi e kishte këtë mendim.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen 12292.

20 PY. Z. Shala ju pyet:

21 "A e dinit në atë kohë kush ishte përgjegjës i UÇK-së?"

22 Pra, pas faqeve paraprake referohet nëntori, dhjetori  
23 1998, ndoshta, apo jo?

24 PË. Mendoj që po.

25 PY. Dhe në qoftë se kjo mund t'ju ndihmojë, mund të tregoj

1 deklaratën apo përmbledhjen e deklaratës tuaj që i keni dhënë  
2 Mbrojtjes së Thaçit, dhe do t'ju lexoj atë që është shënuar në  
3 paragrafin 53, ku lexon:

4 "... në vjeshtë dhe dimër të 1998, nuk ishte e mundur të  
5 identifikohesh për një person që ishte përgjegjës i UÇK-së."

6 A është, vazhdon kjo të jetë dëshmia juaj?

7 PË. Po. Kjo është arsyeja për të cilën u deshën muaj dhe muaj  
8 të tërë që të kemi ndonjë diskutim të vërtetë me njerëzit e  
9 UÇK-së dhe kjo është arsyeja e kompleksitetit, e vështirësisë,  
10 pra, për të bashkuar delegacionin, a për të krijuar një  
11 delegacion të shqiptarëve të Kosovës me njerëz dhe personazhe  
12 të ndryshme.

13 PY. Po. Dhe për të përfunduar lidhur me këtë temë, keni dhënë  
14 dëshmi lidhur me të në seancën përgatitore javën e kaluar, ku  
15 ju keni thënë, kjo është në paragrafin 33:

16 "... arsyeja për të cilën ata nuk mund të gjenin dikë një  
17 person që ishte përgjegjës i UÇK-së, ishte sepse nuk ishte  
18 askush përgjegjës. Fakti që ju keni vazhduar të kërkonit kaq  
19 për një kohë kaq të gjatë, sugjeron që nuk ishte, ky problem  
20 nuk ishte zgjidhur. Ata nuk e kishin zgjidhur këtë problem"

21 PË. Mendoj që kjo është 100 për qind e saktë. Ndonjëherë kur  
22 kërkonit, kur kërkohet diçka dhe nuk gjendet, arsyeja për këtë  
23 është sepse ajo gjë nuk ekziston.

24 PY. Faleminderit. Tani do të kalojmë tek një temë tjetër, që  
25 është 6 nëntori, takimi i 6 nëntorit 1998 në Dragobil që ju

1 keni bërë me z. Thaçi, z. Krasniqi --

2 PË. Po.

3 PY. -- dhe disa të tjerë. A ishte kjo hera e parë që u takuat  
4 me z. Krasniqi?

5 PË. Besoj që po.

6 PY. Besoj që ky takim ishte organizuar nga përfaqësuesit tanë  
7 të KDOM-it. Do të, i bie që të jetë Shaun Byrnes në atë kohë?

8 PË. E saktë.

9 PY. Tani, siç e thatë dje në transkript në faqen 54, që ju u  
10 përqendruat tërësisht në, për të parë atë që ata mendonin për  
11 planin tuaj të Kosovës. A është e saktë sa i takon qasjes që  
12 ju kishit për këtë mbledhje, për këtë takim.

13 PË. Po. Puna ime ishte që të vija, që të krijoja një plan për  
14 t'i dhënë fund konfliktit dhe, pra, mundësia për t'u takuar me  
15 njerëz që Shaun më tha që ishin në UÇK, ishte një mundësi e  
16 tillë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë, të shfaqim në  
18 ekran P01069.

19 Përpara që të bëjmë këtë, i nderuar Gjykatës, paraqes  
20 këto dy faqe të intervistës për t'u pranuar si prova, dy faqe  
21 që i tregova Ambasadorit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj që është 90, 91.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
25 se i lexova mbrapsht.



Dëshmitari: Christopher Hill (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 17

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
3 kundërshtim?

4 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12292 dhe  
6 DHT12291 pranohen.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund t'i shtohen provës materiale  
8 të Thaçit që mendoj është 423, 1D423?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ju lutem  
10 shtojini provës materiale 1D423.

11 Z. PACE: [Përkthim] A mund të sqarojmë a ishte 90, 91?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mendoj që ishin dy  
14 faqe. DHT12290 dhe 91.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12292  
17 është pranuar më parë.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar  
20 Gjykatës. Faqet përkatëse do t'i bashkëngjiten provës  
21 materiale 1D00423, me klasifikim publik.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull. Shkojmë në faqen 075334.

23 Paragrafi 19. Nuk është cilësia shumë e mirë.

24 PY. Arrini ta lexoni?

25 PË. Po, e lexoj.

1 PY. Ambasador, ky është një kabllogram i datës, ose pas, që  
2 është shkruar pas këtij takimi. Në të cilin thuhet, nëse mund  
3 ta lexoni:

4 "UÇK-ja, kishte nevojë për tri javë për të koordinuar  
5 përgjigjen për draftin e parë të 1 nëntorit të Ambasadorit  
6 Hill. Si rezultat, përgjigja e UÇK-së nuk shkoi në kohë tek  
7 Ambasadori Hill për t'u shqyrtuar për përfshirjen e  
8 rishikimeve në dokumentin e 1 nëntorit. Sigurisht, gjatë kësaj  
9 kohe pati shumë debate të brendshme politike mes udhëheqjes,  
10 ne presim që këto vështirësi në komunikim të sjellin vonesa".

11 Pra, a pati një vonesë prej tri javësh nga ana e UÇK-së  
12 që t'i përgjigjej propozimit tuaj?

13 PË. Po, pati shumë vonesa. Është e rëndësishme të kuptojmë  
14 pak kontekstin e kabllogramit, pse pati kabllogram nga  
15 Beogradi për këtë temë. Prezumo, supozoj, se kjo ka ardhur,  
16 ky ka ardhur drejtpërsëdrejti nga Shaun Byrnes, drejtuar  
17 Ambasadës në Beograd, ku është rishtypur dhe është dërguar si  
18 telegram nga Beogradi.

19 Duke -- është hera e parë që e shoh këtë dokument. Ose  
20 mbase e kam parë para 25 vitesh. Unë mendoj që ky dokument  
21 tregon se Shaun ka menduar se vonesat kanë qenë të natyrës  
22 teknike, dhe jo të personelit. Pra, ishin shkaktuar nga  
23 mungesa e pajisjeve përkatëse. Sidoqoftë, unë jam skeptik, nuk  
24 mendoj se problemet këtu ishin pajisjet, por mendoj se  
25 problematika ishte pikërisht për faktin se s'kishte një person

1 përgjegjës.

2 PY. Faleminderit, në rregull.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Dokumenti mund të hiqet nga ekrani,  
4 faleminderit.

5 PY. Ju bënë disa pyetje dhe në faqen 51 të transkriptit të  
6 djeshëm, lidhur me deklaratën që i keni dhënë në intervistë me  
7 Blerim Shalën, që -- "shumë nga diskutimet në këtë takim ishin  
8 fokusuar në faktin që Rugova ishte një person i tmerrshëm".  
9 Edhe kjo është diçka që e keni thënë edhe në seancën  
10 përgatitore javën e kaluar. Në paragrafin 15 ju thatë që:

11 "... ky ishte një person i tmerrshëm, në kuptimin që  
12 Rugova nuk ishte i gatshëm për këtë detyrë. Nuk ishte i duhuri  
13 për këtë detyrë."

14 PË. Po.

15 PY. Ju po ashtu thatë dhe që ka pasur një perceptim që ju  
16 mund të ishit shumë i afërt me krahun e Rugovës, edhe se ishte  
17 nevoja që të zgjeronit horizontin tuaj. Në këtë pikë kohore,  
18 në këto momente, ju po përpigeshit të kryenit negociata mes  
19 Milosheviqit në një anë dhe grupeve të ndryshëm shqiptare nga  
20 ana tjetër. Kjo ishte situata apo jo?

21 PË. Po. Dhe vështirësitë mes shqiptarëve apo mospajtimet mes  
22 shqiptarëve nuk ishin shqetësimi im. Shqetësimi im ishte të  
23 realizoja politikën amerikane, pra që të gjeja një mënyrë që  
24 Beogradi dhe grupet e ndryshme në Kosovë të gjenin një  
25 mirëkuptim, dhe të përfundonte konflikti.

- 1 PY. Në rregull. Një nga gjërat që deshën të bënin  
2 përfaqësuesit e UÇK-së është të siguroheshin që ishin pjesë e  
3 diskutimeve.
- 4 PË. Po. Ata donin me doemos të thonin po ashtu që Rugova nuk  
5 është personi i duhur për këtë detyrë. Por dua të shtoj  
6 gjithashtu se kur kam biseduar me Blerim Shalën për këtë, ka  
7 qenë një kontekst shumë informal, prandaj dhe shihni  
8 terminologji, zhargone, apo terma që janë përdorur, thonë ata  
9 "djemtë", terma të këtij lloji. Sigurisht, pas 25 viteve as në  
10 ëndërr nuk më kishte shkuar që do e shikoja dhe një herë këtë  
11 bisedë.
- 12 PY. Sidomos në një Gjykatë?
- 13 PË. Patjetër.
- 14 PY. Po ashtu, dje thatë që një nga gjërat që po përpiqeshit  
15 t'u tregonit personave është që qeveria duhet të ketë  
16 shërbime, "dhe nëse keni shërbimet e duhura dhe ju mund t'i  
17 ofroni këto shërbime dhe jo objektet, subjektet e huaja,  
18 atëherë mund të keni autonomi të plotë. Duhet të kenë  
19 struktura më të gjera që të jeni pjesë e Bashkimit Evropian,  
20 dhe mos u fokusoni më në sovranitetin, çështjet e sovranitetit  
21 të shekullit të 19-të", keni thënë.
- 22 A ju kujtohet që e thatë dje?
- 23 PË. Po, dhe i qëndroj edhe sot kësaj.
- 24 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran,  
25 shënimin përgatitor tuaj të javës së shkuar, DHT12557 deri në

1 DHT12559 [Sipas përkthimit]. Është në listën e prezantimeve të  
2 palës thirrëse, kështu që mund ta gjeni në listën e  
3 materialeve të Mbrojtjes së Thaçit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Shohim faqen 12568. Që  
6 të lexojmë paragrafin 38 dhe 39.

7 PY. Dua që t'i trajtojmë së bashku. Ju keni thënë që  
8 konkretisht nuk ju kujtohej ndonjë element i Planit, të  
9 ashtuquajtur, Hill, që lidhet me policimin lokal.

10 I qëndroni kësaj?

11 PË. Konkretisht, nuk më kujtohen elementë të kësaj  
12 marrëveshjeje. Në marrëveshjen e Dejtonit kishim një shtojcë  
13 më vete kushtuar çështjeve policore. Nuk më kujtohet sot, por  
14 ma merr mendja që ka qenë diçka që është diskutuar dhe si do  
15 të funksiononte policimi në atë kohë, në kontekstin e kësaj  
16 marrëveshjeje.

17 PY. Më pas keni dhënë dhe ju e dinit që zgjidhja më e mirë  
18 për Kosovën ishte qeverisja lokale, dhe policia lokale do të  
19 ishte pjesë e saj.

20 PË. Po. Po.

21 PY. Pjesërisht, se policia lokale ishte një prej shërbimeve  
22 që keni diskutuar ju, që mund të ofrohej në një Kosovë  
23 autonome prej shërbimeve kosovare, apo jo?

24 PË. Po. Policia lokale është diçka që konsiderohet në gjithë  
25 botën si shërbimi më i mirë për të zbatuar ligjin. Pra, të

1 kesh policinë afër komunitetit.

2 PY. Në seancën përgatitore më pas keni thënë se konkretisht:

3 "Nuk ju kujtohet ndonjë bisedë me UÇK-në lidhur me këtë  
4 pjesë të planit që trajtonte policimin lokal, përveç faktit që  
5 shqiptarët e Kosovës donin një shtet të bashkuar, dhe nuk  
6 donin një situatë ku një pjesë e popullatës së tyre t'i  
7 raportonte Beogradit, të mos u raportonte komandantëve  
8 shqiptarëve në Prishtinë. Pra ideja e policisë lokale ishte  
9 pak shqetësuese për shqiptarët e Kosovës nëse nënkuptonte që  
10 ata duhet t'u raportonin autoriteteve serbe".

11 PË. Mendoj që kjo është e vërtetë, me sa kam unë dijeni.

12 Mendoj se ekzistonte shqetësimi se mos kur flisnim për  
13 policinë lokale apo çdo shërbim lokal, ekzistonte pra  
14 shqetësimi që ky mund të ishte një plan për të mbajtur  
15 strukturën e përgjithshme në Beograd si ombrellë dhe prandaj  
16 kishte skepticizëm te kjo polici kur përdorej fjala "lokale".

17 Sidoqoftë, unë mendoj se nga ana e tyre, më shumë se nga  
18 ana ime, ekzistonte nocioni se kjo organizatë që do të  
19 kontrollojë policinë, atëherë rrjedhimisht do kontrollojë edhe  
20 Kosovën. Dhe thanë që për faktin që zbatimi i ligjit është një  
21 nga aspektet kryesore, shtyllat kryesore të kontrollit.

22 Unë parapëlqej të flas për grupime lokale, apo shërbime  
23 të tjera lokale, edhe duke pasur këto shërbime lokale, do të  
24 kishte autonomi. Megjithatë, u fokusuan më tepër seç duhet tek  
25 policia lokale, të paktën personat që mendonin se

1 problematikat fillojnë dhe mbarojnë me çështjet e sigurisë.

2 PY. Edhe ekzistonte shqetësimi sepse mund të kishte elementë  
3 në policinë lokale që do t'i raportonin Beogradit dhe  
4 Milosheviqit, apo jo?

5 PË. Po. Këta ishin persona në fakt që besonin në pavarësi të  
6 plotë dhe që mendonin se Kosova do të kishte pabarazi të  
7 plotë. Unë nuk mund ta theksoj këtë mjaftueshëm. Unë nuk  
8 përfaqësoja këtë grupim. Unë nuk përfaqësoja grupe të ndryshme  
9 të shqiptarëve të Kosovës. As nuk përfaqësoja aty Serbinë. Unë  
10 aty përfaqësoja Shtetet e Bashkuara dhe në bisedat e thelluara  
11 që kam pasur me Sekretaren e Shtetit Albright apo dhe me  
12 Ambasadorin Holbrooke, ne përpiqeshim të bënim një plan për  
13 autonomi, sepse sipas nesh, ky ishte plani që do ta  
14 përfundonte dhunën, dhe do të ndihmonte situatën në mënyrë që  
15 të vazhdonim më tej me detyrën tonë për ta bërë Ballkanin  
16 pjesë të Evropës.

17 PY. Dhe këto propozimet për policinë lokale në fakt nuk u  
18 materializuan asnjëherë, apo jo? Se më pas erdhi UNMIK-u apo  
19 jo, në vijim të Rambujesë?

20 PË. Saktë. Më duhet të shtoj për të dhënë kontekst, që kur  
21 realizuam Dejtonin për Bosnjën, ne e dinim se si do të ishte e  
22 ardhmja, dhe ishim në pozicion të trajtonim dhe çështjet e  
23 sigurisë, sepse kishim një shtojcë më vete për policinë.

24 Por ama, për Kosovën ishim në një nivel më bazik për  
25 ndalimin e dhunës, dhe të trajtonim disa nga shqetësimet

1 themelore, dhe nuk ishim në gjendje të krijonim në fakt një  
2 forcë policore.

3 PY. Në rregull. Shohim një dokument tjetër që mund të mos e  
4 keni parë më përpara.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] 1D00141.

6 PY. Mund të shikoni letrën me kokë, është një kabllogram i  
7 ambasadës austriake në Beograd, i datës 30 shtator 1998.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem, të shkojmë më poshtë në  
9 tekst.

10 PY. Dua të shohim këtë pjesën ku është bërë një takim me  
11 grupin e kontaktit të Ambasadorëve dhe Milosheviqin, dhe  
12 takimin e mëpasshëm me Rugovën. Ju keni qenë po ashtu pjesë e  
13 grupit të kontakteve, apo jo?

14 PË. Jo, jo më duket. Më duket se kjo -- është hera e parë që  
15 e shoh, sidoqoftë. Besoj që kjo i referohet ambasadorëve që  
16 kanë raportuar vendet e kontaktit në Beograd.

17 PY. Austria ka qenë pjesë e grupit të kontaktit?

18 PË. Jo, nuk ka qenë. Por me z. Petritsch, ambasadorin  
19 austriak në Beograd, që ishte i dërguari i posaçëm i Bashkimit  
20 Evropian, dyshoj, por nuk jam i sigurt, që për shkak se ka  
21 qenë i dërguari i posaçëm ka qenë i përfshirë.

22 PY. Pra, ai ka qenë i përfshirë nga Bashkimi Evropian, jo nga  
23 Austria?

24 PË. Kështu e kuptoj unë, po.

25 PY. Dua t'ju pyes atëherë për pikën e parafundit këtu, ka një



1 listë gjërash që i ka përcjellë Milosheviqi grupit të

2 Ambasadorëve. Thotë:

3 "Koordinatorët e sigurisë janë krijuar tashmë në 70  
4 fshatra është pjesën perëndimore të Kosovës (lista është marrë  
5 nga Ambasadori Hill më 29 shtator dhe do të transmetohet në  
6 një raport më vete)."

7 A ju kujtohet pra, kjo?

8 PË. Nuk më kujtohet ndonjë listë e këtij lloji, jo. Nuk më  
9 kujtohet.

10 PY. Pra, keni pas dijeni ju që Milosheviqi po krijonte njësi  
11 lokale në fshatra, sidomos në pjesën perëndimore të Kosovës?  
12 Njësi policore?

13 PË. Jo, por po të kisha qenë në dijeni të kësaj gjëje, do  
14 kisha thënë që është një ide e keqe. Jo çdo nismë e  
15 Presidentit Milosheviq na raportoj, apo me thënë të drejtën  
16 as seriozisht nuk i merrnim të gjitha.

17 PY. Do kaloj tani në një temë tjetër, faleminderit. Dua të  
18 flasim tani për shkëmbimin e të burgosurve të ushtrisë  
19 jugosllave në janar të 1999.

20 A është e vërtetë që negociatat në janar të 1999 kanë  
21 qenë në fakt shkëmbimi i vetëm që ka ndodhur mes UÇK-së dhe  
22 ushtarëve gjatë konfliktit?

23 PË. Me sa kam unë dijeni, po.

24 PY. Edhe duke qenë se ka qenë një çështje unike në këtë  
25 konflikt, mori dhe përmasa të mëdha politike asokohe, apo jo?

1 PË. Ishte një çështje madhore sepse nuk ishte bërë asnjëherë  
2 më parë diçka e tillë, edhe ekzistonte shumë skepticizëm nëse  
3 do të realizohej në fakt diçka e tillë.

4 PY. Besoj se ju i thatë Mbrojtjes së Thaçit dje se  
5 Milosheviqi tha se do të çelë portat e ferrit nëse nuk bëhet  
6 diçka, apo jo?

7 PË. Në fakt kjo është rresht nga një film që unë s'do ta  
8 kisha përdorur, por diçka në këtë formë. Pra, ai planifikonte  
9 të merrte masa ndëshkimore shumë të rrepta nëse nuk bëhej  
10 diçka.

11 PY. Faleminderit. Shohim pak një pjesë të librit tuaj ku keni  
12 folur për takimin që keni pasur me z. Krasniqi dhe me të  
13 tjerë. Libri ka faqen, faqja që do të shohim ne është  
14 DHT08787, 09214.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem, të shohim faqen 0809  
16 [Sipas përkthimit].

17 PY. Këtu keni thënë që z. Krasniqi "mori një pozicion shumë  
18 të ashpër, apo shumë të rreptë, për këtë vonesën dhjetëditore,  
19 dhe tha që kjo është shumë normale". Pra, është e vërtetë që  
20 z. Krasniqi ishte i mendimit që ky shkëmbim duhet të jetë  
21 simultan, i njëkohshëm?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe kur i thanë për këtë shkëmbimin me shkëputje, ai tha:

24 "Si mund t'i kemi unë besim Milosheviqit?"

25 A ka thënë kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ju i thatë Mbrojtjes së Thaçin në deklaratën tuaj, se  
3 sipas jush ai ishte i shqetësuar sepse Milosheviqi do të  
4 ndryshonte kushtet e marrëveshjes, apo jo?

5 PË. Po. Por, unë i thashë konkretisht: Ky nuk është problemi  
6 yt, ky është problemi im pastaj.

7 PY. Ju e keni shpjeguar dhe në librin tuaj dhe në intervistë  
8 me Mbrojtjen e Thaçit që ajo që i keni thënë z. Krasniqi ishte  
9 në thelb "A i besoni ju Amerikës?", i keni thënë.

10 PË. Po, unë e thashë në mënyrë retorike që të dilja në këtë  
11 pikë, por në fakt unë përpigësja të tregoja që ne prandaj jemi  
12 të përfshirë në këtë.

13 PY. Dhe në fakt çfarë keni bërë ju në thelb është, keni  
14 përdorur pra kartën e marrëdhënieve amerikane, apo jo?

15 PË. Po. E përdorëm dhe unë kisha mbështetje të mjaftueshme në  
16 Uashington për të thënë këtë që thashë, dhe e bëra dhe e  
17 thashë këtë sepse vonesa e, vonesës dhjetëditore ishte, kjo  
18 ishte ideja ime, pra, kjo ide mbështetej në Uashington sepse  
19 askush nuk e njihte më mirë se unë situatën.

20 PY. Dhe --

21 PË. Më lini t'jua bëj të qartë. Kanë qenë situata të  
22 vështira. Je në telefon me Uashingtonin dhe gjëja e fundit që  
23 duan të dëgjojnë personat është t'u thuash që tani në ka dalë  
24 një problem i ri në Kosovë. Kështu që, ndonjëherë, idetë e  
25 këqija mbështeteshin sepse idetë e tjera ishin dhe më të

1 këqija.

2 PY. Ma merr mendja se kur e bëtë këtë, kur e thatë këtë, kur  
3 dolët në këtë pikë, ju e dinit shumë mirë që UÇK-ja kishte  
4 nevojë për mbështetjen amerikane dhe ndërkombëtare.

5 PË. Absolutisht që më shkoi kjo në mendje.

6 PY. Dhe Jakup Krasniqi sikurse çdo tjetër, e dinte këtë gjë.

7 PË. Besoj se po.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim në ekran atëherë përmbledhjen  
9 e intervistës suaj me Mbrojtjen e Thaçit. DHT12160, deri në  
10 DHT12169.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Ndërkohë që gjejmë deklaratë më  
12 lejoni të them diçka. Unë e dija si funksiononte Uashingtoni,  
13 se kisha punuar me dhjetëra vite atje. Dhe po ashtu, e kuptoja  
14 se dhe në Uashington kishte pikëpamje të ndryshme. Por unë  
15 mendova se në një moment shqiptarët e Kosovës kishin shumë  
16 kontakte në Uashington, por ama herë të tjera e ekzagjeronin  
17 shkallën e kontakteve që kishin atje. Prandaj, për mua ishte e  
18 rëndësishme që të fokusoheshim tek fakti që unë komunikoja me  
19 Sekretaren Albright, dhe Ambasadorin Holbrooke, dhe unë isha  
20 personi që vërtet flisja me personat që kishin fuqi  
21 vendimmarrëse.

22 Z. ELLIS: [Përkthim]

23 PY. Faleminderit.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim paragrafin 32, ju lutem. Që  
25 përfundon te faqja 65, besoj.

1 PY. Mund ta lexoni paragrafin 32 nëse keni nevojë.

2 PË. Në rregull. Po, unë ia bëra të qartë pikëpamjen time atij  
3 në këtë takim. Ai nuk tha se e mbështeste, madje nuk më  
4 kujtohet çfarë përgjigje më ka dhënë. Por më kujtohet që  
5 përfundoi me atë që thashë unë. Por menjëherë pas kësaj, nuk  
6 mbaj mend se si mësova se ishte pranuar dhe se do të bëhej  
7 lirimi i ushtarëve shumë shpejt.

8 PY. Është e vërtetë, pra, siç është zbardhur në këtë  
9 përmbledhje, që ju nuk e dini se kush saktësisht në UÇK e  
10 miratoi lirin e ushtarëve jugosllavë?

11 PË. Saktë, dhe kjo ka qenë një problematikë e vazhdueshme me  
12 UÇK-në, sepse ne nuk e dinim kush ishte përgjegjës atje.

13 PY. Dhe ajo që mendonit ju, pra, që Krasniqi kishte marrë  
14 disa udhëzime, ishte pikërisht sepse ju nuk mendonit se z.  
15 Krasniqi ishte një nga figurat kryesore, apo jo?

16 PË. Po. Këto janë mendime të pabazuara, por në mungesë të  
17 informacioneve të tjera, atëherë po.

18 PY. Pra, kjo është përshtypja juaj, nga sa keni parë, që z.  
19 Krasniqi nuk ishte ndonjë person i rëndësishëm në UÇK apo jo?

20 PË. Po, kjo ishte përshtypja ime.

21 PY. Në rregull. Okej, tani vazhdojmë më tej, nuk do t'ju bëj  
22 pyetje për Rambujenë, por dua t'ju pyes për pozicionin më pas.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe tani do të shohim 1D00358, që  
24 mendoj se është në listën e materialeve të Thaçit.

25 PY. Është një dokument të cilin e kemi trajtuar edhe dje.

1           Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë më poshtë që të shihni  
2   paragrafin 1. Këtu bëhet, është periudha kur janë kthyer  
3   personat nga konferenca e Rambujesë.  
4   PY.   Ju vetë, u kthyet në Kosovë me delegacionin?  
5   PË.   Jo, nuk kam qenë me delegacionin. Me sa mbaj mend,  
6   Ambasadori Huntzinger, që ishte ambasadori francez në  
7   Maqedoni, kishte sjellë po ashtu delegacionin, kishin qëndruar  
8   bashkë, e kishin organizuar bashkë në Shkup, dhe erdhën në  
9   Rambuje. Nga kujtesa ime, mbaj mend që qeveria franceze ishte  
10   kujdesur edhe për kthimin e tyre.  
11   PY.   Shohim paragrafin e tretë [Sipas përkthimit] ku thuhet:  
12           "Delegacioni shqiptar në Rambuje u kthye në Kosovë pa  
13   problematika. Edhe nuk pati vështirësi nga autoritet serbe.  
14   KDOM-i francez shoqëroi ambasadorin shqiptar -- pra,  
15   delegacionin e UÇK-së, Jakup Krasniqi Ramë Bujën, Azem Sylën -  
16   nga aeroporti i Prishtinës në Sedllarë, që është rreth 30  
17   kilometra në jugperëndim, pa pengesa".  
18   PË.   Nuk më kujtohet, por besoj se është e saktë.  
19   PY.   Ju vetë nuk keni qenë pjesë, apo jo?  
20   PË.   Jo, nuk kam qenë.  
21   PY.   Pra, mund të ketë qenë Shaun Byrnes?  
22   PË.   Mund të ketë qenë dhe Shaun Byrnes. E di që janë kthyer  
23   me një avion francez.  
24   PY.   Pra, janë kthyer me një avion francez, por i ka ndihmuar  
25   SHBA-ja apo jo, për të shkuar në Sedllarë?

1 PË. Nga Prishtina. Por di që nuk ka pasur incidente. Për këtë  
2 kam dijeni. Për sa kohë nuk kishte problematika, atëherë nuk  
3 më nevojiteshin detajet e tjera.

4 PY. Por ekzistonte nevoja që t'i ndihmonte KDOM-i për të  
5 shkuar në Sedllarë, sepse nuk do të ishte e sigurt që  
6 delegacioni shqiptar të kalonte në pikat, në punktet serbe,  
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Po ashtu, në të njëjtin paragraf, tregon që ka pas një  
10 konflikt të madh brenda UÇK-së për Rambujenë, edhe antagonist  
11 kryesor i UÇK-së ishte përfaqësuesi politik Adem Demaçi. A ju  
12 kujtohet ju kjo gjë?

13 PË. Ne e dinim që Adem Demaçi ishte kundër çdo negociate me  
14 serbët, dhe ishte kundër çdo gjëje që nuk trajtonte çështjen e  
15 pavarësisë. Pra, kur ekzistonin problematika serioze, të  
16 rënda, ne supozonim që është Demaçi pas këtyre.

17 PY. Dhe ju prisnit, dhe ju mendonit -- që personat që ishin  
18 në favor të nënshkrimit do të duhet që "t'ia shisnin këtë  
19 marrëveshje", apo jo?

20 PË. Kështu e kuptonim ne.

21 PY. Sepse në këtë pikë, s'ekzistonte një person që ta  
22 nënshkruante marrëveshjen?

23 PË. Kjo ishte pikëpamja jonë, po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,  
25 duhet të bëjmë pushimin, përveç nëse keni, jeni duke

Dëshmitari: Christopher Hill (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 32

1 përfunduar dhe ju kanë ngelur 2-3 minuta.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, jam duke përfunduar, por kam  
3 nevojë për pesë minuta, nuk kam nevojë për 2-3 minuta.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

5 [Përkthim] Do të bëjmë dhjetë minuta pushim, Dëshmitar.

6 Të gjithë ne do të bëjmë dhjetë minuta pushim tani. Do të  
7 takohemi në sallën e gjyqit pas dhjetë minutash.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
10 do bëjmë dhjetë minuta pushim.

11 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

12 --- Seanca rifillon në orën 10.16

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
14 silleni dëshmitarin në sallë. Një çast përpara se ta sillni.

15 Përpara sesa të sillni dëshmitarin duhet t'ju them që  
16 sapo ju informova sa i takon pushimit për seancën e pasdites.  
17 E thashë gabim paradite dhe për këtë arsye dua ta theksoj dhe  
18 një herë tjetër. Do bëjmë seancën siç e kemi bërë gjithmonë  
19 domethënë do kemi pushimin e drekën nga ora 1.00 deri në 2.30  
20 dhe pastaj do vazhdojmë deri në orën 4.30. Ju kërkoj ndjesë po  
21 kështu ndodh kur ke një moshë të caktuar.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ambasadori  
24 Hill, do të vazhdojmë me pyetjet nga ekipet e Mbrojtjes. Më  
25 konkretisht do të vazhdojë pyetjet z. Ellis.



1           Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

2   PY.   Kam dhe pak pyetje për ju, Ambasador.

3           Z. ELLIS: [Përkthim] Së pari, ndërkohë që e kemi  
4 dokumentin në ekran do i kërkoja Sekretares që të kalojmë në  
5 paragrafin 6 në faqen e dytë.

6   PY.   Në të thuhet që:

7           "... Buja komentoi që Shtabi i Përgjithshëm do të takohet  
8 atë pasdite me Demaçin. Buja thotë që ai, Krasniqi dhe Sulja  
9 do të merrnin pjesë në të. Dhe kur u pyet lidhur me Demaçin,  
10 si Krasniqi dhe Buja thanë se ata 'do të kujdesen për të' dhe  
11 se kundërshtimi i tij për Rambujenë dhe për qeverinë e  
12 përkohshme që ishte propozuar nga Rugova, Qosja dhe Thaçi më  
13 24 shkurt, do të tejkalohet."

14          A jeni të informuar ju sa i takon proceseve të brendshme  
15 të UÇK-së lidhur me marrëveshjen e Rambujesë në Paris,  
16 Ambasador?

17   PË.   Nuk kam informacion sa i takon negociatave të brendshme.  
18 Ndërkohë unë kisha ndjesinë që ata kishin nevojat e tyre për  
19 sa i takon dhënies së pëlqimit për pikëpamjet e ndryshme  
20 brenda UÇK-së.

21   PË.   E keni fjalën për pikëpamjet e ndryshme brenda UÇK-së apo  
22 jo?

23   PË.   Po.

24          Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoj që të hiqet dokumenti nga  
25 ekрани dhe të paraqitet një tjetër dokument për të cilët juve

1 ju bëri pyetje Mbrojtja e Thaçit dje. Është dokumenti me numër  
2 1D00310.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Besoj që ky dokument  
4 është në listën e dokumenteve të Mbrojtjes së Thaçit, apo jo?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se po. Është faqja 2874, të  
6 njëjtën faqe e pamë dhe dje. Të kalojmë në fund të faqes së  
7 aspo treguar.

8 PY. Dje ju patë shënimin që kishte të bënte me datën 8 mars  
9 1999. Dhe ju thatë që data 8 mars është pak a shumë e saktë.  
10 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Ambasador, dje?

11 PË. Po. Megjithatë, e vetmja pyetje që kam unë është që besoj  
12 që do kem qenë me Holbrooke kështu që nuk e di sesi kam shkuar  
13 nga një takim në Prishtinë dhe pastaj në takimin me Holbrooke  
14 brenda një ditë. Domethënë, pak a shumë mund të them po, por  
15 nuk e di sesi mund të ishte realizuar kjo.

16 PY. A mund t'ju sugjeroj unë që mbase takimi me  
17 përfaqësuesit e UÇK-së nuk ka ndodhur në Prishtinë në atë  
18 kohë?

19 PË. Po, ndoshta ky është shpjegimi. Por nuk e kuptoj se si  
20 mund të funksiononte ndryshe në qoftë se takimi do të ketë  
21 qenë në Prishtinë.

22 PY. E kuptoj. Shprehja që ju përdorni për këtë takim, pra,  
23 shprehja që keni përdorur në seancën përgatitore është që  
24 donit të matnit temperaturën. A është kështu, apo jo,  
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, unë shkova tek ai vend. Nuk më kujtohet se ku ka qenë  
2 vendi saktësisht, por më kujtohet që kishte shumë gazetarë që  
3 na shoqëronin dhe situata ishte e tillë që ne donim që të  
4 matnin temperaturën e tyre dhe të siguroheshim që ata ishin në  
5 rrugën e duhur, dhe që ata do respektonin marrëveshjen e  
6 Rambujesë.

7 PY. Edhe pse ju menduat që nuk morët një mendim përfundimtar  
8 pozitiv, shenjat ishin pozitive, apo jo?

9 PË. Po, nuk -- unë me thënë të drejtën e kam hequr fare fjalë  
10 "përgjigje përfundimtare" nga fjalori im gjatë periudhës time  
11 atje, megjithatë pajtohem me atë çfarë thatë juve, që shenjat  
12 ishin pozitive.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje të  
14 tjera për ju.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Pace, e keni ju fjalën tani.

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Pace:

18 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit për fjalën. Përpara sesa  
19 të vijojmë më tej, kërktoj që të hiqet dokumenti që kemi në  
20 ekran.

21 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem James Pace. Jam  
22 Prokuror me Prokurorinë. Kam planifikuar pesë orë për pyetjet  
23 me juve, megjithatë shpresoj që të mbarojmë më herët sesa kaq.

24 PË. Edhe unë shpresoj të njëjtën gjë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Përpara sesa të fillojmë dua të them

1 që përpara sesa të kërkoj të shfaqen ekranet do them në qoftë  
2 se dokumentet duhet të shfaqen për publikun apo jo.

3 PY. Dëshmitar, ju dhatë dëshmi lidhur me takimin me Xhavit  
4 Halitin, Zekën në tiranë në qershor 1998. Ky ka qenë takimi i  
5 parë që keni pasur ju me UÇK-në apo jo?

6 PË. Mesa më kujtohet mua, po.

7 PY. Sikurse keni thënë në seancën përgatitore me Mbrojtjen  
8 kur e keni takuar Xhavit Halitin ju nuk e dinit se çfarë roli  
9 ose çfarë domethënie, çfarë rëndësie kishte ai në UÇK, apo jo?

10 PË. E saktë. Ca njerëz më kishin thënë që ishte në nivel  
11 shumë të lartë, dikush më kishte thënë që ishte shok me  
12 personat e rëndësishëm në UÇK. Nuk isha i sigurt se kush  
13 kishte të drejtë, por ishte -- ai përfaqësonte dëshirën për të  
14 ndjekur pistat e propozuara.

15 PY. Në takimin tjetër me UÇK-në ky ishte takimi ku keni qenë  
16 me Ambasadorin Holbrooke në Junik, apo jo?

17 PË. Nuk do thoja që ka qenë takim me UÇK-në po ishte një  
18 takim me bujqërit në Junik që kishin vuajtur ose kishin pësuar  
19 sulmet e serbëve. Ne kemi dëgjuar historitë e tyre, i kemi  
20 vizituar ata dhe deri në momentin kur një person i cili kishte  
21 një mjekër të madhe të zezë dhe që ishte i veshur me tesha  
22 ushtarake erdhi dhe përfitoi nga rasti për dalë në një  
23 fotografi me ne.

24 PY. Përpara rastit në Junik ju nuk keni pasur asnjëherë  
25 ndonjë kontakt të drejtpërdrejtë me anëtarë të UÇK-së apo jo,

1   Ambasador?

2   PË.   Jo, kontakt të drejtpërdrejtë, por disa persona nga  
3   ambasada të tjera përfshirë këtu dhe diplomatët tanë dhe  
4   anëtarë të shërbimeve inteligjente që kishin interes që të  
5   gjenin se kush ishte udhëheqja e UÇK-së kanë pasur takime dhe  
6   më kanë raportuar përmbajtjet ose bisedat që janë kryer në  
7   takime të tilla.

8   PY.   Ju sapo na thanë, dhe keni dëshmuar dhe dje në fakt,  
9   lidhur me praninë e këtij burri në takim. Ambasadori Holbrooke  
10   tha që -- në fakt kjo është një pyetje të cilën ju e keni  
11   diskutuar. E keni diskutuar në pyetjet që ju ka bërë Mbrojtja  
12   në korrik, dhe thatë që ky ishte një person i cili thoshte që  
13   i përkiste UÇK-së por nuk e mori askush seriozisht, apo jo?

14   PË.   Po, sepse sikurse e kam shpjeguar disa herë ai u bë pjesë  
15   e takimit pasi kishte filluar takimi, bëri një fotografi dhe  
16   pastaj u largua përpara sesa të mbaronte takimit. Kështu që në  
17   përgjigje të pyetjes tuaj, po, askush nuk e mori seriozisht  
18   këtë person, dhe ky nuk ishte një person me të cilën ne kryem  
19   një takim të qenësishëm.

20   PY.   As ju dhe as një person nga autoritetet e Shteteve të  
21   Bashkuara nuk kishte organizuar një takim dhe nuk është se  
22   kishit thirrur pjesëtarë të UÇK-së për të marrë pjesë në atë  
23   takim, apo jo?

24   PË.   Jo, nuk kishim organizuar një takim. Nuk i kishim kërkuar  
25   askujt nga UÇK-ja që të merrte pjesë në të. Megjithatë duhet

1 të them që fotografia e Holbrooke, i cili ishte i ulur ngjitur  
2 me këtë personin që unë e përshkrova më herët, u shfaq  
3 gjithandej dhe nga tjetër Milosheviqi në Beograd i kishte  
4 dërguar një njoftim Holbrooke duke i thënë që nuk do të  
5 takohet më me Holbrooke për shkak të takimit që ai kishte  
6 pasur me UÇK-në. Dhe në atë pikë Holbrooke më kërkoi mua që të  
7 shkoja në Beograd dhe të përpigësja që të qetësoja situatën.  
8 PY. Pra, edhe një herë, nuk është organizuar asnjë lloj  
9 takimi paraprakisht me anëtarë të UÇK-së në Junik, dhe nuk  
10 kishte asnjë arsye që ju të prisnit që të organizohet ndonjë  
11 takim i tillë. As juve dhe as Ambasadori Holbrooke, apo jo,  
12 Dëshmitar?

13 PË. Nuk do arrija në këtë përfundim, megjithatë nuk kishte  
14 shumë sekrete në atë pjesë të botës dhe jam i sigurt që  
15 njerëzit e dinin se për ku ishim nisur. Dhe kur shkuam atje  
16 kishte të paktën 10 ose 20 automjete me persona të shtypit të  
17 cilët e dinin çfarë destinacioni ishim nisur ne, dhe në çfarë  
18 pjese të Kosovës ishim.

19 PY. A ju kujtohet juve ose a ju kujtohet kur ju ose  
20 Ambasadori Holbrooke vendosi që të shkonte atje, domethënë ka  
21 qenë ditë, muaj, javë më përpara?

22 PË. Nuk më kujtohet. Besoj që të ketë qenë çështje ditësh.

23 PY. Kjo ishte një prej takime të para të Holbrooke dhe vetëm  
24 këto ishin disa prej vizitave të organizuara jashtë Prishtinës.  
25 Kur shkuat në Junik, ju u takuat besoj me kryetarin e bashkisë

1 -- pra, u takuat me kryetarin e komunës së Junikut në shtëpinë  
2 e tij. Kështu ka ndodhur apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Ishte një shtëpi. Ne të gjithë u ulëm në tokë aty.

4 PY. A i mësuat se cilat ishin emrat e personave të cilët u  
5 ulën afër Ambasadorit Holbrooke në këtë takim në Junik?

6 PË. Nuk më kujtohen emrat, nuk më kujtohet se kush më ka  
7 thënë se kush ka qenë aty, megjithatë më vonë kam dëgjuar që  
8 bëhej fjalë për shqiptarë etnikë të cilët jetonin diku në  
9 Evropën perëndimor, të cilët ishin kthyer në Kosovë.  
10 Megjithatë nuk më kujtohet konkretisht sesi quheshin këta apo  
11 kush ishin këta persona.

12 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja të paraqitej në ekran tani  
13 dokumenti SPOE00405207-00405218 [Sipas përkthimit], në faqen e  
14 parë. Mund ta transmetoni për publikun.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Thjesht për të ditur  
16 është dokument që është shënuar si konfidencial.

17 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka problem është thjesht emri i  
18 dëshmitarit që nuk është në këtë faqe, kështu që në qoftë se  
19 nuk të them ndryshe duhet që të paraqitet për publikun  
20 dokumenti përkatës.

21 PY. Dëshmitar, ky është një artikull që mban datën 6 shtator  
22 2021, që është me titullin "Ushtari në fotografi: Në kujtim të  
23 Richard Holbrooke".

24 Z. PACE: [Përkthim] Dhe tani të kalojmë te faqja tjetër.

25 PY. Besoj që në këtë fotografi ju e shikoni Ambasadorin

1 Holbrooke bashkë me këtë personin që e përshkruat pak më

2 herët. Kjo është fotografia apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Vazhdojmë më poshtë në të njëjtën faqe. Në të shkruhet si  
5 më poshtë:

6 "Pas masave të COVID-19 në Australi, në qershor këtë vit  
7 u takova me Ambasadorin e asaj kohe në Kosovë dhe Hajdin  
8 Abazin në një restorant për të diktuar dialogun vazhdues midis  
9 Serbisë dhe Kosovës.

10 "u habita që zbulova që Abazi ishte një person i cili  
11 vazhdonte që t'i referohej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si  
12 'të paidentifikuar' UÇK një ushtar nga një fotografi  
13 enigmatike që kishte dalë me ambasadorin Richard Holbrooke."

14 E shikoni këtë pjesë, Dëshmitar? Emri Hajredin Abazi, a  
15 ju duket i njohur, Dëshmitar?

16 PË. Jo.

17 PY. Le të vazhdojmë më tej:

18 "Gjatë luftës së Kosovë nga viti 1999 deri në 1999 ermi i  
19 këtij personi ka pasur domethënë emrin e luftës Lum Haxhiu."

20 A mendoni që ka përdorur këtë pseudonim, Dëshmitar?

21 PË. Nuk më kujton asgjë ky pseudonim. Nuk më kujtohet asgjë  
22 lidhur me këtë person, përveç asaj që kam thënë më përpara që  
23 ai u fut në takim, u ul afër Ambasadorit dhe pastaj u largua  
24 prej tij.

25 PY. Ai përmend Ramush Haradinaj tek kjo pjesa, në qoftë se e



1 keni lexuar. A ju kujtohet në qoftë se ai përmendi emrin e

2 Ramush Haradinajt gjatë takimit?

3 PË. Jo, nuk më kujtohet gjë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Le të kalojmë te faqja që përfundon  
5 me 215.

6 PY. Do lexoj nga paragrafi i dytë e më poshtë.

7 "Pasi Abazi hyri në shtëpi, Holbrooke u ul në të majtë të  
8 Hillit dhe pastaj Gani Shehu në të majtë të tij. Met Shala  
9 ndërhyri për të tretën dhe herën e fundit. Ai insistoi që  
10 Shehu duhet që të ulej dhe të bënte vend për Abazin që ishte  
11 pjesëtar i UÇK-së që ishte më i lartë në hierarki, aktualisht,  
12 dhe më pas Holbrooke, si një ambasador i vërtetë, diplomat i  
13 vërtetë u tërhoq në mënyrë të tillë që të bënte vend për të."

14 A ju kujtohet ky gjest, Ambasador?

15 PË. Jo, nuk më kujtohet e di që ai u ul, por nuk më kujtohet  
16 që Hilli të jetë tërhequr për të bërë vend për të.

17 PY. Vazhdohet më tej. Në artikull thuhet që:

18 "Holbrooke i pyeti i kërkoi gazetarëve që të largoheshin  
19 dhe i tha 'D oju lutesha që të na leni të bisedonim. Në një  
20 pikë ai iu kthye Abazit dhe e pyeti: A jeni ju shkrimtari me  
21 armë? Abazi u habit që Holbrooke dinte diçka lidhur me të  
22 shkuarën e tij. Ai thotë që Holbrooke kishte përdorur një  
23 rresht nga artikulli lidhur me të, mundësisht mund të ishte  
24 shkruar nga Schork dhe që ishte botuar në median perëndimore."

25 A ju kujtohet një gjë e tillë, Ambasador?

1 PË. Jo, nuk më kujtohet. Megjithatë, kjo referenca për Schork  
2 që keni këtu është Kurt Schork që është gazetar i cili është  
3 vrarë disa vite më pas në Afrikën e Perëndimit. Ka ndërruar  
4 jetë në vitin 1999, në mos gabohet, domethënë jo është vitin  
5 2000, por në vitin 1999. Më kujtohet se kam qenë në varrimin e  
6 tij në Uashington.

7 A mund t'ju pyes në çfarë kohe është shkuar ky artikull,  
8 mund të më thoni

9 PY. Botimi është bërë me 6 shtator 2021.

10 PË. Nuk më kujtohet asgjë.

11 PY. Ky është një artikull që përmend z. Abazi megjithatë nuk  
12 jepen specifika të tjera. Do të vazhdojmë me të njëjtin  
13 artikull.

14 Z. PACE: [Përkthim] Dhe do i kërkoj Sekretares për këtë  
15 që të kalojë tek faqja 00405210, paragrafi parafundit në këtë  
16 faqe. Kalojmë më poshtë në tekst.

17 PY. Këtu thuhet:

18 "Së bashku me aktivistë të tjerë shqiptarë të Kosovës,  
19 Abazi në vitet e 20-ta të tij ka qenë në burg nga viti 1979  
20 deri në 1983 për aktivizimin e tij politik. Çfarë krimi kishte  
21 kryer? Kishte bërë advokaci për Kosovë që të bëhej republikë  
22 brenda Jugosllavisë."

23 Dëshmitar, në intervistën që i keni dhënë Blerim Shalës,  
24 ju keni thënë që z. Abazi, për të cilin po flasim ishte një  
25 person "jo shumë frymëzues". Dhe kur keni takuar në qershor

1 1998, a keni qenë në dijeni të faktit që ai ka qenë kishte

2 qenë katër vite në burg për aktivizëm politik?

3 PË. Në kohën e takimit as unë as Holbrooke nuk e kishim fare

4 idenë se kush ishte ky person.

5 PY. Domethënë kjo do të thotë që ju nuk e dinit në kohën kur

6 e keni takuar që ky kishte qenë personi që kishte qenë pjesë e

7 byrosë ekzekutive të Lëvizje Popullore për Republikën e

8 Kosovës? Nuk e kishit fare idenë lidhur me këtë gjë?

9 PË. Nuk e kishim fare idenë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja tjetër që

11 përfundon me 211.

12 U kërkoj ndjesë përkthyesve.

13 PY. Do lexoj në paragrafin e funti. Isha shumë shpejt dhe për

14 këtë arsye kërkoj ndjesë.

15 Këtu thuhet:

16 "Në Junik Abazi - që ishte nëpunës për Moralin, Politikën

17 dhe Informacionin në Nënzonën e Junikut dhe Reka e Keqa me një

18 të ri shqiptar të Kosovës, Gani Shehu, komandant i shtabit të

19 UÇK-së për Junikun, ata bashkërisht ishin akuzuar -- ishin

20 ngarkuar, më falni, për marrëdhënie politike të UÇK-së."

21 Atëherë, bazuar në informacionin që na dhatë më përpara i

22 takon që ju nuk keni pasur informacion të mëparshëm lidhur me

23 faktin që ai ishte përgjegjës për moralin, politikën dhe

24 informacioni në Junik dhe në Reka e Keqe, apo jo, Dëshmitar?

25 PË. Duke lexuar ndryshimin e fundit, mund të them që ai erdhi

1 në dhomë ku ishim ne dhe neve na -- ishte një person sikurse e  
2 kam thënë disa herë deri tani që u ul afër Holbrooke dhe që  
3 ishte i interesuar që të bëhej fotografia bashkë me të. Në  
4 përgjigje të pyetjes së sapo më bëtë, jo, ne nuk e kishim  
5 idenë që ai ishte i përfshirë në marrëdhëniet me publikun në  
6 UÇK.

7 PY. A e mësuat juve më vonë gjatë luftës që ky person Hajdin  
8 Abazi ishte caktuar si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-  
9 së për sektorin e informimit publik pasi Kadri Veseli i kishte  
10 kërkuar atij që të punonte për këtë sektor ose të merrte në  
11 dorë drejtimin e këtij sektori?

12 PË. Përsëri dëshiroj që të theksoj që puna ime ishte që të  
13 punoja dhe të transmetoja pikëpamjet e Qeverisë Amerikane dhe  
14 të punoja bazuar në udhëzimet nga Uashingtoni për të arritur  
15 marrëveshjen për autonominë. Unë kam ndjekur të gjitha  
16 ndryshimet e personelit në UÇK. Interesi im në UÇK ka qenë  
17 vetëm që të gjeja, të konstatoja një grup njerëzisht që mund  
18 të flisnim me një grup më të gjerë në mënyrë të tillë që të  
19 mbështesnin marrëveshjen për autonominë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen 216.

21 PY. Ndërkohë në paragrafin 216 thuhet si më poshtë:

22 "Holbrooke i tha Abazit se një prej objektivave kryesore  
23 ishte që të promovohet armëpushimi ndërmjet UÇK-së dhe  
24 Jugosllavisë dhe ai pyeti në qoftë se grupi rebel do të  
25 lejonte forcat serbe të kishin qasje në një pjesë të caktuar

1 të territorit që ishte nën kontrollin e UÇK-së në Junik. Abazi  
2 u përgjigj duke thënë 'UÇK-ja dëshiron paqe, por kjo paqe  
3 duhet të vijë së bashku me lirinë'. Me fjalë të tjera  
4 armëpushimin pa garancinë për pavarësinë nuk do ishte  
5 zgjidhjet."

6 A ju kujtohet të jetë bërë një bisedë e tillë?

7 PË. Jo.

8 PY. A po thoni që armëpushimi do të duhej që të diskutohet me  
9 zinxhirin e UÇK-së apo jo?

10 PË. Mua të kujtohet se ai nuk mund të fliste për UÇK-në  
11 lirshëm, mbase e ka shprehur këtë për arsye të shkrimit të  
12 këtij artikulli këtë mendim, por nuk më kujtohet të ketë  
13 ndodhur të ketë ndodhur një gjë e tillë në takimin tim me të.

14 PY. Çfarë ju bëri të mendoni që ky personin nuk kishte lirinë  
15 të fliste në emër të UÇK-së?

16 PË. Sepse ai thjesht na dha slogane më shumë sesa analiza.

17 Z. PACE: [Përkthim] Po e dorëzojmë këtë artikull për  
18 pranim si provë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
20 kundërshtim?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] S'kam kundërshtime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
23 00405 [Sipas përkthimit] deri në 207 [Sipas përkthimit] deri  
24 në 004052190 [Sipas përkthimit] pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

1 Dokumenti do të marrë numrin e provës materiale P04492 që  
2 ishte numri që ishte caktuar më herët një dokumenti tjetër po  
3 që pastaj u hoq nga Trupi Gjykses sipas vendimit gojor të  
4 datës 2 tetor 2025.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Klasifikimi është  
7 konfidencial, aktualisht.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të  
10 klasifikohet si publik.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim  
13 dokumentin.

14 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet se jeni përpjekur të takoheni me  
15 pjesëtarë, anëtar të UÇK-së me 26 qershor 1998 kur keni shkuar  
16 me veturë në Kijevë në pikën e -- postbllokun e UÇK-së në  
17 Kijevë?

18 PË. Po, më kujtohet.

19 PY. Dhe siç e keni shkruar në memualet tuaj që i pamë dje,  
20 atje ju shpresonit të takonit UÇK-në dhe keni kërkuar atyre që  
21 të t'ju çojnë tek udhëheqësi i tyre, e saktë?

22 PË. E saktë.

23 PY. Dhe nuk kishit bërë ndonjë parapërgatitje, pra, për një  
24 takim të tillë. A është kështu?

25 PË. Kështu është. Dua të them që kjo ishte ideja e Holbrooke,

1 që ne duhet të shkonim atje dhe të shihnim nëse mund të gjenim  
2 dikë si pikë kontakti me UÇK-në. Unë isha skeptik për këtë gjë  
3 sepse kjo ishte pikë kontrolli postbllok dhe postblloqet janë  
4 diçka që shihe shpesh në konflikte të tilla. Për respekt -- si  
5 shenjë, si respekt ndaj Holbrooke thashë "në rregull do të  
6 shkoj atje dhe shohim se çfarë mund të bëjmë".

7 PY. Gjithashtu keni shkruar në memoarin tuaj duke përdorur  
8 një teknikë që keni mësuar në Shqipëri dhe keni arritur në  
9 përfundimin se personi më i lartë me të cilin mund të  
10 bisedohej në pikë, postbllok ishte personi me syzet më të  
11 shtrenjta. Syzet e diellit.

12 PË. Dua të theksoj se e kam shkruar këtë memoar për të dhënë  
13 një pikëpamje sa më të saktë të saj që kam parë në pjesë të  
14 ndryshme të konflikteve në botë, dhe po kjo ka qenë një koment  
15 jo shumë serioz, pra që të shikohen syzet e diellit që  
16 njerëzit mbanin për të përcakton gradën e tyre. Ishte më shumë  
17 një koment që e kisha parë diku tjetër, bazuar në atë që kisha  
18 parë diku tjetër ku kisha parë persona pra, -- personat e  
19 veshur me rroba më të mira zakonisht ishin më lart në gradë.  
20 Jam pak skeptik që të marrim këtë koment në memoar dhe ta  
21 bëjmë këtë si një lloj këtë narrative që bazohet si provë,  
22 pra.

23 PY. Gjatë seancës përgatitore javën e kaluar keni thënë se  
24 postblloku nuk kishte -- se në postbllok nuk kishte plani me  
25 syzet e diellit por një person tjetër që kishte -- nuk ishte

1 personi me syzet e diellit por një person tjetër që kishte  
2 autoritet, një lloj autoriteti.

3 PË. E saktë, edhe pse kjo është një shpjegim pak i thjeshtë,  
4 teknika pra, që duke u mbështetur tek syzet e diellit dukej se  
5 aty nuk funksiononte.

6 PË. Dhe ju pyetët një ushtar aty në postblok që t'ju tregonte  
7 udhëheqjen -- t'ju thonte udhëheqësve të tyre se Shtetet e  
8 Bashkuara donin të ndihmonin popullin e Kosovës porse  
9 postblloqet dhe perspektiva e konfliktit nuk ndihmonin për  
10 këto përpjekje të tilla, pra, që po bëheshin.

11 PË. E saktë.

12 PY. Dhe pas një ore, pak a shumë, një luftëtar ju afrua dhe  
13 ju shpjegoi që ishte një njësi që ishte pjesë e komandës së  
14 Drenicës, pra, pjesë s UÇK-së në komandën e Drenicës dhe që --  
15 dhe kaq kishte -- ishte i autorizuar t'ju thoshte juve, jo më  
16 shumë.

17 PË. E saktë.

18 PY. Ky person ju tha juve se nuk mund të largoheshit por --  
19 se ju mund të largoheshit por jo shoferi.

20 PË. E saktë

21 PY. Shoferi juaj ishte serb, e saktë?

22 PË. E saktë, ai punonte për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara  
23 në Beograd dhe makina kishte ardhur nga Ambasada e Shteteve në  
24 Bashkuara në Beograd.

25 PË. Pjesëtarë të UÇK-së në postbllok morën dhe dokumentet e



1 shoferit tuaj?

2 PË. E saktë.

3 PY. Pjesëtarë të UÇK-së në postbllok më vonë me hezitim ju  
4 dhanë juve dokumentet e shoferit, jua kthyen kur ju kërkuat, i  
5 kërkuat ato?

6 PË. E saktë.

7 PY. Dhe me aq sa dini ju, keni shkruar në memoarin tuaj kjo  
8 ishte pak pakujdesi që të merrej shoferi në një pikë kontrolli  
9 në përpjekje për të gjetur një partner negociatash në këtë  
10 mënyrë?

11 PË. Unë e kam bërë këtë sepse z. Holbrooke më sugjeroi që  
12 duhej të përpiqesha, tani duke lexuar memoarin më vonë, mendoj  
13 që Holbrooke nuk kishte marrë parasysh tërësisht potencialin e  
14 rrezikut që përfshin -- rrezikun potencial që përfshinte e  
15 gjitha kjo, veçanërisht duke patur parasysh faktin që shoferi  
16 ishte serb.

17 PË. Ju keni dëshmuar se makina -- ndaj makinës tuaj u gjuajt  
18 me armë zjarri në Shtime, me kjo ndodhi me 28 korrik 1998,  
19 saktë?

20 PË. Nuk është që u qëllua kundër makinës. Disa plumba kanë  
21 prekur makinën që janë plumba të shtënë nga luftëtarë dhe  
22 ishte e vijë e policisë serbe prapa të cilët makina jonë  
23 arriti. Dhe një distancë të largët ishin pemë, drunj të lartë  
24 dhe nga aty kishte persona që qëllonin nga policisë serbe.

25 Kur u kthyer në atë cep, në atë vend menjëherë pas

1 qytetit të Shtimes, dhe u kthyem në anën e djathë më kujtohet  
2 kjo, një prej policëve serbë lëvizi në drejtim, na bëri shenjë  
3 neve që të largoheshim nga aty që mendoj ishin rrethanat -- në  
4 rrethana të tilla ishte këshillë e mirë dhe shoferi jonë i  
5 kthyer. Makina mesa duket në atë moment u prek nga plumba në  
6 pjesën e parakolpit se e zbuluam më vonë pastaj kur u kthyer  
7 në një vend të sigurt.

8 PY. E kuptoj. A ju kujtohet a ka ndodhur me 28 korrik 1998?

9 PË. Nuk më kujtohet data po jam i sigurt që kjo është pyetje  
10 që ka të bëjë me të dhëna konkrete dhe duhet ta shkojmë këtë  
11 gjë.

12 PY. Dhe ju dhe personat e tjerë me ju në këtë rast ishin në  
13 një udhëtim tjetër po përpiqeshit që të gjenit UÇK-në, apo jo?

14 PË. Ishte pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të gjetur  
15 dikë me të cilin mund të flisnim si pjesë, si përfaqësues i  
16 një grupi më të gjerë të UÇK-së.

17 PË. Dhe një herë këtu po ju pyes, nuk kishit planifikuar  
18 takime me pjesëtarë të UÇK-së paraprakisht përpara këtij  
19 udhëtimi?

20 PË. Mesa me kujtohet mua është se UÇK-ja në Likovc na priste  
21 neve atje dhe për rrjedhojë u organizua një takim. Ne nuk kemi  
22 pritur që aty të ndodhte kjo betejë apo shtim me armë zjarri  
23 se përndryshe do të ishim kthyer mbrapsht.

24 PË. Dhe në memoarin tuaj ju pranoni se ky udhëtim për të  
25 gjetur UÇK-në mund të ketë qenë ide e keqe. Pse mund të jetë

1 kështu?

2 PË. Mendoj çdo kohë në një moment kur ju vozisni dhe kur ecet  
3 me makinë në një drejtim të një vendi ku ka luftë, dhe je i  
4 paarmatosur si diplomat duke u përpjekur që të punosh në --  
5 për të arritur një marrëveshje autonomie për një popull,  
6 ndoshta je në vendin e gabuar. Kjo është ajo që do ta  
7 përshkuar si ide të gabuar sepse rruga e sigurt, dhe e kuptuam  
8 kur kaluam përmes qytetit dhe askush nuk ishte aty, kuptuam  
9 sidomos kur filluan të shtënat. Të shtënat që në fakt prekën  
10 dhe makinën tonë.

11 PY. Dhe Blerim Shala ishte me ju në këtë rast?

12 PË. Po, ai ishte me neve, në rastin -- së bashku me Fehmi  
13 Aganin i cili ishte zëvendës kryetari i LDK-së.

14 PY. A ju kujtohet Mehmet Hajrizi, individi që diskutuat dje?  
15 A ka qenë edhe ky me juve në atë rast?

16 PË. Jo, nuk më kujtohet të ketë qenë i pranishëm. Ne kishim  
17 Tina Kaidanow dhe Phil Reeker dhe një vend të tretë me  
18 fuoristradën Chevy suburban. Kishim Blerimin, mendoj, dhe në  
19 karrigen përpara nuk kishte personel të sigurisë. Ishte Veton  
20 Surroi.

21 PY. Ju po shkonit drejt Kleçkës kur ndodhi incidenti në  
22 Shtime, apo jo?

23 PË. Nuk më kujtohet Kleçka. Mendoj se po shkonim drejt  
24 Likovcit.

25 PY. Ju kujtohet që aty ku po shkonit sepse ishte Shtabi i

1 Përgjithshëm i UÇK-së në atë kohë?

2 PË. Ne po përpiqeshim të gjenim njerëz të UÇK-së në Drenicë.  
3 Dhe neve na ishte thënë që kjo ishte mënyra më e mirë për të  
4 bërë, rruga për të shkuar, pra. Pastaj vendosëm që nuk ishte  
5 kështu. Kur bëmë një udhëtim tjetër atje, morëm rrugën më në  
6 veri, por duhet të shikoj hartën që ta përcaktoj saktësisht.  
7 Edhe një herë dua të theksoj se kjo ka ndodhur para 26, 27  
8 vitesh dhe po përpiqem që të kujtoj gjërat sa më mirë sa i  
9 përket gjeografisë.

10 PË. Në rregull.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran DHT12206-  
12 DHT12372 dhe kalojmë në faqen 12274. Besoj që kjo faqja është  
13 pranuar si pjesë e dokumenteve të paraqitur për provë nga  
14 Mbrojtja.

15 PY. Do të lexoj nga tre rreshtat e fundit. Dhe për t'ju  
16 orientuar është intervista me Blerim Shalën që ju është  
17 treguar disa herë.

18 Dhe këtu thuhet që:

19 "... ne u drejtuan, u nisëm në drejtim të jugut. Dhe kur  
20 arritëm në fund të Shtimes shkuan në drejtim të perëndimit."

21 A ju kujtohet kjo?

22 PË. Më kujtohet që të kemi qenë në Malishevë, por nuk më  
23 kujtohet që ky ishte qëllimi apo destinacioni ku ne donim të  
24 shkonim në udhëtimin tonë lidhje-perëndim nga Prishtina që na  
25 çoi ne përmes Shtimes. Nuk më kujtohet Malisheva. Më kujtohet

1   që ka në një pikë, që kam qenë aty në një moment të caktuar,  
2   sigurisht që e kam parë shkatërrimin që ishte bërë nga forca e  
3   sigurisë serbe kundrës shtëpive, fshatrave në afërsi, por nuk  
4   më kujtohet që ka qenë e njëjta ditë.

5       Z. PACE: [Përkthim] E heqim këtë dokument. Dhe kërkoj të  
6   shfaqim në ekran dokumentin SPOE00058041-0058445. Dhe kalojmë  
7   faqen që përfundon me 8041 -- ose më mirë aty, kjo është faqja  
8   kryesore.

9   PË. Që t'ju orientojmë, Dëshmitar, ky është një libër tjetër  
10   i shkruar nga Blerim Shala, jo ajo ku ishte intervista juaj.  
11   Kjo është në shqip.

12       Z. PACE: [Përkthim] tani kalojmë në këtë version në faqen  
13   që përfundon 153. Dhe afër tij shfaqim në ekran përkthimin  
14   përkatës në anglisht. Pra, përkthimi në anglisht është  
15   SPOE00058153 deri në SPOE0058155-ET. Dhe këtu në anglisht  
16   mbesim në këtë faqe dhe do të lexoj nga rreshti i parë në  
17   tekstin kryesor për tani.

18   PY. "Të nesërmen, pra të martën, më 28 korrik, do t'ja  
19   mësyjmë Kleçkës ku ishte vendosur Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-  
20   së. Me Ambasadorin Hill ishin Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni,  
21   Veton Surroi dhe unë. Por, me të dalë prej Shtimes tek punkti  
22   i policisë serbe do të ballafaqohemi me të shtëna. Një plumb  
23   madje qëlloi karrocerinë e xhipit të blinduar amerikan. Kështu  
24   u detyruam të ktheheshim në Prishtinë pa kryer punë. Luftime  
25   kishte në të gjitha rrugët që çonin për në viset që

1 kontrollonte UÇK-ja.”

2 Z. PACE: [Përkthim] Do të lexoj tani nga paragrafi i dytë  
3 i faqes në vijim:

4 “Takimi me zyrtarët e UÇK-së në Likovc. Atë të mërkurë ne  
5 bëmë udhëtimin e dytë për t'u takuar me përfaqësues të Shtabit  
6 të Përgjithshëm.”

7 Blerim Shala, pra, se drejtimi drejt ku po shkonit ju  
8 ishte në drejtim për të shkuar tek UÇK-ja ishte drejt Kleçkës  
9 ku gjendej, ishte i vendosur Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.  
10 Dhe pastaj në pjesën e dytë që lexova i referohet ditës në  
11 vijim si tentativë e dytë për t'u takuar me përfaqësues të  
12 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

13 A jua freskon kujtesën kjo lidhur me synimin apo qëllimin  
14 e këtij udhëtimi?

15 PË. Më kujtohet që kemi bërë një përpjekje të dytë nga një  
16 rrugë tjetër. Nuk më kujtohet emri Kleçka. Mendoja që ishte  
17 Likoci, po dhe këtu ja le Blerimit, pra, Blerim Shalës që të  
18 vendosë për këtë çështje. Mospërputhja tjetër e vogël që shoh,  
19 është që kur ne u takuam, u përballëm me këtë luftim ku  
20 përfundam në mënyrë të paqëllimshme, më kujtohet që Fehmi  
21 Agani tha se ky është provokim serb. Që do të thotë pra që  
22 forcat serbe filluan të qëllonin me armë në përpjekje për të  
23 parandaluar neve që të shkonim në atë drejtim, pra, për të na  
24 bindur që të ktheheshim mbrapsht, si përpjekje që të mos  
25 takoheshim me UÇK-në. Unë i thashë atij që mund të ketë qenë

1 provokim, por ishte i suksesshëm sepse ne u kthyem mbrapsht.

2 Si koment i përgjithshëm do të doja të shtoja këtu se kjo  
3 përpjekje për të shkuar në vende si Kijev dhe vende si Shtime  
4 dhe në vende të tjera, ishin përpjekje për të gjetur për të  
5 kontaktuar njerëz të UÇK-së, sepse në atë periudhë kohore ne  
6 nuk e dinim kush fliste në emër të UÇK-së. Kjo ishte fustrim i  
7 vazhdueshëm kur dëgjonim njerëzit kur thonin kush ishte  
8 përgjegjësi i gjërave dhe pastaj më vonë dëgjonim njerëz të  
9 tjerë që thonin, jo, nuk është ky, është dikush tjetër. Pra,  
10 ishte një situatë është të cilën ne nuk mund të mbështeteshim  
11 tek të tjerët, duhet të shkonim të shihnim vetë.

12 Ne po shkonim, pra, në zona lufte me synimin për t'u  
13 përpjekur për të gjetur për kontaktuar personat apo një letër  
14 për të shikuar për të shqyrtuar një letër ku merrej -- ku  
15 paraqitej autonomia. Dhe më duket që kjo ide tani me kalimin e  
16 kohës ka qenë e rrezikshme.

17 PY. Dhe e siç e dëgjuat dhe më parë që e lexova këtu, Blerim  
18 Shala përmend se Mehmet Hajrizi ishte me juve në këtë rast kur  
19 shkua në Shtime. A jua freskon kujtesën?

20 PË. nuk më kujtohet kjo.

21 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, paraqes faqet që  
22 u treguan lidhur me këtë material që përfundoi 58041 në  
23 versionin shqip vetëm, dhe faqet që përfundojnë 58153 deri në  
24 58154 të dyja në shqip dhe në anglisht.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

1 kundërshtim.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim. Jam thjesht i  
3 ngatërruar pak. Nuk e kuptoj për çfarë po paraqiten për pranim  
4 në prova këto.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Sepse ai ofroi dy versioni në  
7 shqip.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
9 [Përkthim] A mund ta sqaroni pak më ngadalë z. Thaçi [Sipas  
10 përkthimit]?

11 Z. PACE: [Përkthim] Natyrisht. Pra, dokumenti që  
12 paraqitëm për pranim si prova, dokumenti SPOE00058041-  
13 00058445, paraqesim faqen e parë për pranim, faqja kryesore që  
14 përfundon me 58041; pastaj faqet 58153 deri në 58154 që  
15 mbulojnë pjesët që lexova, që tregova. Kjo është në shqip.

16 Ndërsa në anglisht kemi faqen kryesore të përdhryer, dhe  
17 dorëzoj dy faqet që u treguan. Dhe ato janë SPOE00058153-  
18 SPOE00058155, pra vetëm dy faqet e para të kësaj.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. MISETIC: [Përkthim] E qartë tani. Nuk kam kundërshtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE0005815 -  
22 - 58041 deri në 0058445, plus faqja kryesore 58153 deri në  
23 58154 në shqip, dhe përkthimi në anglisht që është 000--  
24 shpresoj të mos e kem ngatërruar, z. Pace, 58153 deri në  
25 0005858155.



1           Z. PACE: [Përkthim] Për pjesën në anglisht vetëm dy faqet  
2 e para të materialit. Pra është e saktë. 58153.

3           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto tre faqe në shqip  
4 dhe dy faqet në përkthimin në anglisht do marrin numrin e  
5 provës materiale, P04507. Klasifikimi është publik.

6           Z. PACE: [Përkthim] Shoh orën, I nderuar Gjykatës.  
7 Ndoshta mund të bëjmë pushimin tani.

8           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani kemi  
9 pushimin gjysmë orësh të planifikuar. Pushoni dhe shihemi pas  
10 gjysmë ore, në orën 11.30. mund të largoheni nga salla e  
11 gjyqit.

12                               [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca  
14 ndërpritet deri në 11.30.

15                               --- Seanca ndërpritet në orën 11.01

16                               --- Seanca rifillon në orën 11.31

17           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
18 sillni dëshmitarin në sallë.

19                               [Dëshmitari vijon dëshminë]

20           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
21 vazhdojmë me pyetjet nga z. Pace që është përfaqësuesi i  
22 Prokurorisë.

23           Z. Pace, fjala është për ju.

24           Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund t'i mbajmë  
25 dokumentet në ekran.

1 PY. Dëshmitar, takimi për të cilin keni dhënë dëshmi, pra,  
2 takimi me anëtarët e UÇK-së në Likovc ka qenë një ditë pas  
3 incidentit të Shtimes, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Pra, pajtoheni me mua?

6 PË. Me sa kam dijeni, po.

7 PY. Sikurse i thatë Blerim Shalës gjatë intervistës me të dhe  
8 sikurse e konfirmuat dje gjatë dëshmisë suaj, gjatë rrugës për  
9 në Likovc atë ditë ju patët një eskortë të UÇK-së që ju  
10 shoqëroi për në zyrat qendrore të UÇK-së në Likovc, apo jo?

11 PË. Nuk më kujtohet tamam, por në fakt ka kuptim sepse nuk  
12 patëm eskortë një ditë më përpara kur shkuam në Shtime. Kështu  
13 që besoj se po, duhet të kishim një eskortë shoqërues. Por  
14 gjithashtu keni parasysh, mbani parasysh që kanë qenë 27 vite  
15 më përpara dhe nuk më kujtohet konkretisht të kemi pasur  
16 eskortë.

17 PY. Siç thoni në memoarin tuaj, anëtarët e UÇK-së me të cilët  
18 biseduat në Likovc kishin uniforma lara-lara me shenjën e UÇK-  
19 së, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dje thatë se në këtë takim në Likovc ka qenë Rexhep  
22 Selimi. Rexhep Selimi ju mirëpriti në këtë takim, apo jo?

23 PË. Më kujtohet që ishte i pranishëm dhe e mbaj mend që ishte  
24 personi që na priti, po nuk mbaj mend konkretisht ndonjë  
25 mirëpritje.

1 PY. Gjatë këtij takimi, Rexhep Selimi iu tha se në parim  
2 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ishte i mendimit se ishte koha  
3 të krijohej qeveria e re e Kosovës. Ju kujtohet kjo?

4 PË. Më kujtohet që ai dhe të tjerë ishin përpjekur që t'i  
5 fokusonin interesat tona në çështjen e përbërjes së një  
6 qeverie për Kosovën. Gjithashtu më kujtohet se ne, sidomos  
7 unë, ishim më pak të interesuar në këtë temë, po ne ishim të  
8 interesuar të merrnim vesh kush do merrte pjesë në negociatat  
9 lidhur me autonominë e Kosovës, rikthimin e autonomisë së  
10 Kosovës.

11 Pra, me një fjalë, kush do të merrte pjesë në qeverinë e  
12 Kosovës ishte me shumë rëndësi për palën shqiptare por nuk  
13 kishte të njëjtën rëndësi për ne që përfaqësonim Qeverinë e  
14 SHBA-së.

15 PY. A ju kujtohet nëse në këtë takim Rexhep Selimi tha se  
16 UÇK-ja nuk i njihte zgjedhjet e 22 marsit dhe presidentin --

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më falni, përpara se të japë  
18 përgjigje dëshmitari dua të kundërshtoj pistën e këtyre  
19 pyetjeve, dhe veçanërisht këtë dua ta bëj pa praninë e  
20 dëshmitarit. Sidoqoftë mund të vendosni ju. Unë besoj se ka  
21 dalë jashtë fushëveprimit të asaj që i lejohet apo jo  
22 Prokurorisë. Kjo është një nga çështjet që e kemi diskutuar në  
23 dosjen paraprake.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshironi të  
25 bëni parashtim?

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, dua të bëj një parashtrim.

2 Shkurtimisht. Po kjo lidhet me një litigim të mëparshëm që  
3 kemi pasur ne me këtë pikë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,  
5 ne kemi për të bërë disa parashtrime pa praninë tuaj, kështu  
6 që do të duhet të largoheni nga salla e gjyqit për një çast.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. E di që nuk kemi  
10 shumë kohë, kështu që do kursej kohë.

11 Sikurse e dini, ne përpara se të fillonim paraqitjen e  
12 provave tona kishim shqetësim se mos Prokuroria do përpiqej të  
13 nxirrte prova të reja që ne mendojmë se nuk është momenti  
14 sepse Prokuroria i mbylli provat e veta.

15 I vetmi pretendim lidhur me z. Selimi në këtë takim është  
16 në paragrafin 270 të dosjes së Prokurorisë, ku thuhet se:

17 "Gjatë periudhës së aktakuzës, Likovc, në Likovc janë  
18 mbajtur takime mes anëtarëve të UÇK-së dhe ndërkombëtarëve  
19 sikurse kanë qenë të pranishëm z. Thaçi, z. Krasniqi, z.  
20 Selimi dhe Sylejman Selimi."

21 Pra, nuk po diskutojmë a është bërë apo jo një takim, por  
22 formulimi apo se çfarë ka thënë z. Selimi në atë takim dhe se  
23 çfarë beson ky dëshmitar lidhur me atë që ka nënkuptuar z.  
24 Selimi duhet të ishte specifikuar konkretisht nga Prokuroria  
25 në dosjen e tyre gjyqësore.

1 Po në rast se duan të mbështeten në atë se çfarë ka thënë  
2 apo jo z. Selimi, duhet ta kishin trajtuar këtë pjesë në  
3 dosjen gjyqësore të cilën nuk e bënë dhe nuk është ky momenti  
4 që ata të nxjerrin dëshmi të reja.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ky është një takim që e përmendi  
6 dëshmitari dje dhe foli gjatë e gjerë dhe foli se ka  
7 komunikuar me Rexhep Selimin gjatë këtij takimi konkret në  
8 Likovc. Që do të thotë është tërësisht në fushëveprimin e  
9 kundërpyetjeve të Prokurorisë dhe, dëshiroj t'ju rikujtoj, se  
10 është e drejta jonë të bëjmë pyetje që janë po ashtu përtej  
11 fushëveprimit po që vërtetojnë argumentet tona.

12 Pra, vetë avokati i z. Selimi tha që ne e kemi në dosjen  
13 gjyqësore që pikërisht këtë takim. Nuk di që të ketë ndonjë  
14 jurisprudencë të mbështesë pretendimet që ne nuk duhet të  
15 nxjerrim dëshmi të këtij lloji.

16 Dhe gjithashtu e lëmë mënjanë relevancën e dosjes tonë,  
17 vetë dëshmitari ka dhënë dëshmi dje lidhur me këtë, domethënë,  
18 është e drejta jonë që ne të eksplorojmë më tej çfarë është  
19 diskutuar në këtë takim me këtë dëshmitar. Nuk e kuptoj çfarë  
20 dëmi i bën kjo Mbrojtjes. Ne kemi të drejtën tonë të zbulojmë  
21 informacione të reja. Nëse ky informacion është në dëmin e  
22 tyre, atëherë Avokati i z. Selimi mund të na thotë se cili  
23 është ky dëm që ju shkakton. Ne thjesht po ju verifikojmë me  
24 dëshmitarin çfarë mban e çfarë nuk mban mend në lidhje me këtë  
25 takim.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
3 kundërshtimi. Do të vazhdojmë me pyetjet.

4 Atëherë mund të vazhdoni me pistën tuaj të pyetjeve.

5 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.  
8 Pace.

9 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Dëshmitar, gjatë takimit që diskutuam, pra, takimi në  
11 Likovc në 1999 në korrik, ju dhatë dëshmi dhe thatë se ka qenë  
12 i pranishëm z. Selimi, Rexhep Selimi. A ju kujtohet nëse atë  
13 takim z. Rexhep Selimi iu tha se UÇK-ja nuk i njeh zgjedhjet e  
14 22 marsit dhe presidentin e kuvendin e zgjedhur në këto  
15 zgjedhje?

16 PË. Nuk më kujtohet kjo. Por më duhet të shtoj se janë  
17 përmendur po nuk ishin relevante për punën time, por kjo ishte  
18 një provë e mëtutjeshme që UÇK-ja donte të ishte pjesë e kësaj  
19 qeverie. Qeverie në Kosovë që në fakt nuk e njihte pjesa  
20 tjetër e botës.

21 PY. Do shohim dhe një material që është një fakt në ekran se  
22 është materiali që pamë para pushimit. Dhe një herë t'ju  
23 kujtojmë se është libri i Blerim Shalës. Nuk është intervista  
24 juaj, është një libër tjetër i Blerim Shalës.

25 Z. PACE: [Përkthim] Jemi në faqen 154. Shkojmë në fundin

1 e faqes. Do t'ju lexoj katër rreshtat e fundit në anglisht.

2 Duhet të jetë e njëjta gjë dhe në shqip.

3 PY. Blerim Shala këtu flet për takimin e 29 korrikut 1998 në  
4 shtabin e UÇK-së në Likovc. Blerim Shala shkruan si në vijim -  
5 -

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për cilën  
7 faqe e keni fjalën?

8 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është një faqe që është pranuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nuk  
10 përkojnë numrat.

11 Z. PACE: [Përkthim] Po 154 është. Mbase duhet të shkojmë  
12 pak më poshtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po thotë 122.

14 Z. PACE: [Përkthim] Po 122 është faqja e librit. Numri i  
15 provës është 154, pra, është pranuar si provë gjyqësore.

16 Atëherë po lexoj.

17 PY. Pra, Blerim Shala thotë kështu:

18 "Pas fjalëve të mirëseardhjes me të cilat na përshëndeti  
19 Rexhep Selimi, foli Ambasadori Hill. Hill në paraqitjen e tij  
20 pos të tjerash theksoi se çështja e Kosovës tash ka arritur  
21 majat e interesimit të administratës amerikane dhe të krejt  
22 perëndimit dhe si pasojë e rezistencës së UÇK-së."

23 Pra, përputhet kjo me kujtesën tuaj, Dëshmitar?

24 PË. Jo.

25 PY. Pse nuk përputhet kjo me kujtesën tuaj?

1 PË. Nuk mbaj mend të kem thënë që "si rezultat i rezistencës  
2 së UÇK-së". Nuk ka kuptim, nuk ka sens ta kem thënë unë këtë  
3 gjë. Gjithashtu mbase Blerim Shala shkruan për luftën e  
4 Kosovës dhe e krahason me Luftën e Peloponezit këtu më duket.  
5 Unë s'jam gati ta pranoj të njëjtën rëndësi luftërash,  
6 vazhdoni.

7 PY. S'po hyj me Luftën e Peloponezit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është mirë të  
9 mos japim të tilla detaje për pyetjet e tua, përgjigjet e  
10 tua - më falni.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. Po nuk më vjen mirë që  
12 të shikoj që të jem cituar për diçka që nuk e kam thënë.

13 Z. PACE: [Përkthim]

14 PY. Që të kuptohemi, ai i referohet që asaj që i keni thënë  
15 ju, por kjo nuk është intervista juaj, besoj që ju këtë e keni  
16 të qartë.

17 Z. PACE: [Përkthim] shkojmë në faqen tjetër atëherë në të  
18 dyja versionet.

19 PY. Do lexoj paragrafin e tretë këtu, pra, vazhdon libri i  
20 Blerim Shalës:

21 "'Nuk i njihnim zgjedhjet e 22 marsit'. Në përgjigje  
22 Rexhep Selimi tha ndër të tjera se, në parim, Shtabi i  
23 Përgjithshëm i UÇK-së ishte po ashtu i opinionit se tani ishte  
24 koha për krijimin e qeverisë së re të Kosovës. Megjithatë,  
25 Selimi ishte i drejtpërdrejtë për sa i përket raportit të UÇK-



1 së ndaj strukturave të dala nga zgjedhjet e 22 marsit: 'Ne nuk  
2 i njohim zgjedhjet e 22 marsit, ne nuk e njohim presidentin  
3 dhe kuvendin e dalë prej këtyre zgjedhjeve', theksoi Selimi.  
4 Po ashtu, sipas tij, në qeverinë e re nuk duhet të kishte vend  
5 për politikanë të kompromentuar kosovarë edhe pse ky nuk  
6 specifikonte për kë e kishte fjalën. Së mbrami, Rexhep Selimi  
7 tha se propozimi i Mehmet Hajrizit do të marrët në shqyrtim  
8 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe se brenda një jave do  
9 të gatitet përgjigja për këtë ofertë."

10 Po kjo përputhet me kujtesën tuaj për këtë takim?  
11 PË. Nuk më kujtohet kjo pjesë. Besoj se ka qenë çështje e  
12 politikës së tyre të brendshme kjo. Po ma merr mendja që  
13 zgjedhjet e 22 marsit ishin zgjedhje të drejtuara nga LDK-ja  
14 edhe rezultuan me rizgjedhjen e Rugovës si president, por e  
15 theksoj dhe një herë, e theksoj dhe një herë nuk ishte kjo  
16 puna ime. Puna ime ishte të krijoja një plan autonomie dhe  
17 doja që UÇK-ja të ishte pjesë e dialogut për autonominë e  
18 Kosovës.

19 PY. Ajo që shkruan Blerim Shala këtu në fjalinë e fundit që  
20 Rexhep Selimi ka thënë se Shtabi i Përgjithshëm do ta merrte  
21 parasysh propozimin dhe do t'u kthente përgjigje për një javë,  
22 përputhet me dëshminë sepse e përmendët dje, apo jo?

23 PË. Kjo po. Po kjo ka lidhje me planin e autonomisë. Po.

24 PY. Dhe tani thatë se nuk ju kujtohet fare kjo problematikë  
25 dhe thatë që:

1 "E mora këtë si një problematikë të brendshme."

2 PË. Flas për zgjedhjet e 22 marsit.

3 PY. A ju kujtohet të keni diskutuar me anëtarë të UÇK-së këto  
4 zgjedhje në ndonjë moment?

5 PË. Aktualisht nuk më kujtohen këto zgjedhje që t'i kemi  
6 diskutuar ndonjëherë së bashku, por më kujtohet që personat që  
7 nuk ishin pjesë e LDK-së e, rrjedhimisht, ishin pjesë të UÇK-  
8 së nuk i njohën zgjedhjet, sepse menduan se u përjashtuan nga  
9 zgjedhjet edhe ishin kryesisht monopol i LDK-së.

10 Z. PACE: [Përkthim] Kjo faqja pararendëse është pranuar  
11 si provë gjyqësore me numër P04507. Kërkojmë pranimin e kësaj  
12 faqeje që t'i bashkëngjitet provës që sapo citova.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] E kundërshtojmë për arsyet që unë  
14 i parashtrova më herët në mungesë të dëshmitarit. Kjo lidhet  
15 me një pretendim kundër z. Selimi që nuk është në dosjen  
16 gjyqësore dhe rrjedhimisht nuk është pjesë e provave të  
17 Prokurorisë mesa kemi ne dijeni.

18 Gjithashtu, përgjigjet e dëshmitarit kanë qenë shumë të  
19 qarta dhe tha nuk kam dijeni për këtë. Nuk mund të ishte më i  
20 qartë se kaq. Pra, Prokuroria u përpoq në disa forma të  
21 nxirrte dëshmi të reja për të thënë a përputhet kjo me  
22 dëshminë tuaj, i lexoj të gjithë paragrafin por dëshmitari tha  
23 që nuk i kujtohet gjithçka që u lexua në këtë paragraf.

24 Z. PACE: [Përkthim] Dua të kundërpërgjigjem.

25 Mendoj se duhet të pranohet sepse përputhet me vendim të

1 mëhershëm që keni dhënë ju me provat e Mbrojtjes së Thaçi se  
2 për mënyrën sesi duhen pranuar provat e Prokurorisë kur bëjnë  
3 kundërpjetet e tyre. Ky material lidhet me një aspekt që  
4 dëshmitari e ka trajtuar në pyetjet nga pala thirrëse. Ai ka  
5 dijeni për disa gjëra që janë diskutuar në këtë fragment.

6 Dhe, mbi të gjitha, ajo që kujton dhe nuk kujton  
7 dëshmitari për një takim të caktuar është relevante për peshën  
8 që do t'i japi Trupi Gjykses dëshmisë së dëshmitarit. Sikurse  
9 dhe me rastet e mëparshme që i keni kundërshtuar, i keni  
10 rrëzuar kundërshtime të tilla. Atëherë nuk është kjo arsyeje  
11 për të kundërshtuar pranimin, për të mos pranuar, pra,  
12 materialin.

13 Dhe gjithashtu sa i takon dëmit që pretendon Mbrojtja e  
14 Selimit, ata mund t'i bëjnë kundërpjetje më tej dëshmitarit  
15 apo të bëjnë pyetje të mëtutjeshme në mënyrë që të marrin  
16 përgjigjet e tyre.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
18 kundërshtimi, pranohet prova.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dua të shtoj diçka. Dua të sqaroj  
20 nëse pranohet për vërtetësinë e përmbajtjes atëherë apo po  
21 pranohet për pikën e fundit që ngriti Prokuroria? Besoj se do  
22 ta lexoj pak besueshmërinë e dëshmitarit apo kujtesën e  
23 dëshmitarit, sepse unë mendoj që mund të pranohet për pikën e  
24 fundit. Po nuk mund të pranohet dhe të merret për bazë për  
25 vërtetësinë e përmbajtjes së z. Shala, jo të dëshmitarit.

1           Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj të pranohet si për çdo  
2 material tjetër për vërtetësinë e përmbajtjes përfshirë dhe  
3 besueshmërinë. Ne nuk do shpikim rrotën këtu. Edhe kemi të  
4 drejtën tonë të kërkojmë të pranohen materialet. Ju keni  
5 vendosur dhe më parë në raste të ngjashme, pra, të pranohet  
6 për të gjitha qëllimet e mundshme.

7           Dhe avokati nuk po na thotë ndonjë burim ligjor, ndonjë  
8 jurisprudencë që të mbështesë parashtrimet e veta. Edhe  
9 përveçse ka thënë që nuk është përmendur specifikisht në  
10 dosjen gjyqësore.

11           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet për  
12 të gjitha qëllimet.

13           Vazhdoni.

14           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja SPOE0058155 do  
15 të pranohet dhe do t'i bashkëngjitet provës me numër material  
16 P04507. Dhe klasifikimi është publik. Faleminderit.

17           Z. PACE: [Përkthim] Mund t'i heqim nga ekrani materialet.  
18 PY. Dëshmitar, ju dhatë dëshmi lidhur me takimin në Likovc ku  
19 ka qenë dhe Rexhep Selimi dhe që ju u mërzitët që takuat një  
20 person që nuk mund të thoshte asgjë. Dhe në intervistën me  
21 Mbrojtjen e Thaçit, ju thatë që dikush do t'ju kishte thënë,  
22 juve ju dikush ju kishte thënë që duhet të flisni me Rexhep  
23 Selimin apo jo?

24           PË. Po.

25           PY. Pra, para se të shkonit në këtë takim, dikush ju ka thënë

1 diçka të ngjashme që ai ishte personi me të cilin duhet të  
2 flisnit?

3 PË. Po. Ne, Qeveria e SHBA-së, ishim të interesuar të  
4 takoheshim me UÇK-në në mënyrë që t'i bënim pjesë të  
5 diskutimeve, të negociatave për autonominë e Kosovës dhe na  
6 thanë që mund të merrnim përgjigje të qarta për këtë nga z.  
7 Selimi, nëse shkonim ne në shtabin e tyre.

8 PY. Ju kujtohet kush ua ka dhënë këtë informacion?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet.

10 PY. Siç i thatë edhe Mbrojtjes së Thaçit gjatë seancës  
11 përgatitore javën e kaluar, ju dhe të tjerët kishit dëgjuar që  
12 Rexhep Selimi kishte pozicion të lartë, apo jo?

13 PË. Nuk mbaj mend të ketë thënë që kishte ndonjë pozicion të  
14 lartë, por kishte opinione të vlefshme.

15 PY. Shohim shënimin përgatitor edhe e trajtojmë së bashku atë  
16 që është thënë.

17 Z. PACE: [Përkthim] DHT12557-DHT12569. Faleminderit. Dhe  
18 shohim paragrafin 8, është faqja e tretë.

19 PY. Dëshmitar, ky është shënimi përgatitor në vijim të  
20 takimit që keni pasur me Mbrojtjen e z. Thaçi. Besoj se e keni  
21 pas të mërkurën dhe të shtunën javën e kaluar. Do të lexojmë  
22 paragrafin 8 që thotë si në vijim:

23 "Sa i takon takimit në Likovc në verën e 1998-s, që  
24 përmendet në paragrafin 18", pra, paragrafi 18 i intervistës  
25 suaj në korrik, "Dëshmitari 1DW-008", që jeni ju, "rikujtoi se

1 kishin dëgjuar se Rexhep Selimi ishte shumë i lartë në detyrë,  
2 por dëshmitari doli në përfundimin se ai ishte më shumë një  
3 person i zonës nga grupi i Drenicës.”

4 Pra, a ju kujtohet çfarë i keni thënë Mbrojtjes së Thaçit  
5 javën e kaluar apo jo?

6 PË. Do më duhet ta shoh. Po ne e kuptuam, ne e kishim kuptuar  
7 se Selimi do të ishte në pozicion të na jepte përgjigje por në  
8 fakt ishte nga grupi i Drenicës.

9 PY. A është e saktë kjo që thuhet këtu që ju dolët në  
10 përfundimin që ai ishte thjesht një person i zonës aty nga  
11 grupi i Drenicës?

12 PË. Po në situatën kur nuk morëm përgjigje, atëherë ne  
13 menduam se ai thjesht po përfaqësonte disa opinione të grupit  
14 të Drenicës.

15 PY. Në rregull.

16 Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin.

17 PY. Në intervistën tuaj të korrikut të këtij viti me  
18 Mbrojtjen e Thaçit, ju keni thënë se para takimit me z. Selimi  
19 në korrik ne Likovc ju nuk kishit dijeni për Shtabin e  
20 Përgjithshëm të UÇK-së dhe kush ishte pjesë e këtij shtabi,  
21 kështu?

22 PË. Po e kam thënë. Dhe këtë besoj.

23 PY. Keni dëshmuar se Tina Kaidanow, Veton Surroi, Blerim  
24 Shala, Phillip Reeker kanë qenë në këtë takim me ju. A ju  
25 kujtohet komandanti i zonës së Drenicës Sylejman Selimi nëse

1 ka qenë i pranishëm?

2 PË. I njëjti Selimi është ky?

3 PY. Jo, e kuptoj pse u ngatërruat. Ne po flisnim për Rexhep

4 Selimin që është një nga të akuzuarit në këtë lëndë gjyqësore.

5 Por po ju pyes, a ka qenë dhe Sylejman Selimi në këtë takim ku

6 ka qenë Rexhep Selimi - me të njëjtin mbiemër - ka qenë

7 komandant i zonës së Drenicës?

8 PË. Jo, nuk më kujtohet ta kem takuar.

9 PY. A ju kujtohet nëse në të njëjtin takim ka qenë

10 zëvendëskomandanti i zonës së Drenicës Sami Lushtaku?

11 PË. Nuk më kujtohet.

12 PY. A ju kujtohet Bislim Zyrapi?

13 PË. Nuk më kujtohet në këtë takim.

14 PY. A e keni dëgjuar ndonjëherë emrin Bislim Zyrapi në 1998

15 dhe 1999?

16 PË. Thatë Zyrapi?

17 PY. Bislim Zyrapi.

18 PË. Nuk më kujtohen këta emra. Më vjen keq.

19 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë shohim në ekran provën me

20 numër P01264 përbri provës P01264-ET. Dhe në të dyja versionet

21 të shohim faqet që përfundon me numër 128674.

22 PY. Është ballina në ekran për kontekst është një libër nga

23 personi Nuhi Bytyqi dhe do shikojmë një fragment të këtij

24 libri.

25 Z. PACE: [Përkthim] Është faqja që përfundon me 128674

1 dhe duhet të shohim konkretisht paragrafin e dytë.

2 PY. Po lexoj paragrafin e dytë, ku thuhet: "Më 29 korrik 1998  
3 ..."

4 Ose më dëgjoni ose ndiqni në ekran.

5 "Unë më 29 korrik 1998 kam qëlluar në Drenicë, në Likovc.  
6 Mora vesh se aty po vinte diplomati amerikan Christopher Hill  
7 për të biseduar me një pjesë të Shtabit të Përgjithshëm të  
8 UÇK-së. Ky ishte takimi i parë i një diplomati të lartë  
9 amerikan brenda në Kosovë me përfaqësuesit e Shtabit të  
10 Përgjithshëm të UÇK-së."

11 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër në të dy  
12 versionet ju lutem.

13 PY. Po lexoj nga fillimi, flasim për të njëjtin takim:

14 "Takimi u mbajt në Likovc në shtabin e Zonës Operative të  
15 Drenicës. Ambasadori amerikan në Shkup, Christopher Hill, i  
16 shoqëruar nga përfaqësuesit e zyrës së SHBA-së në Kosovë, Tina  
17 Kaidanow, mori pjesë si në vijim në Shtabin e Përgjithshëm,  
18 Rexhep Selimi, drejtori i drejtorisë operative të UÇK-së,  
19 Sylejman Selimi, komandanti i Zonës Operative të Drenicës,  
20 Bislum Zyrapi, zëvendësshefi i drejtorisë operative të UÇK-së,  
21 Sami Lushtaku, zëvendëskomandant i Zonës Operative të Drenicës  
22 dhe Shaban Shala, anëtar i shtabit të Zonës Operative të  
23 Drenicës. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi nuk kanë qenë të  
24 pranishëm aty. Me ambasadorin Hill nga Prishtina kishin ardhur  
25 dhe Mehmet Hajrizi, Hydayet Hyseni, Blerim Shala dhe Veton



1 Surroi."

2 Dëshmitar, a ndihmon kjo me kujtesën sa u takon  
3 pjesëmarrësve në këtë takim?

4 PË. Nuk më kujtohen këta pjesëmarrës, përveç Rexhep Selimit.  
5 Por mund të shtoj që Tina Kaidanow punonte për mua, nuk ka  
6 qenë përfaqësuese e zyrës së SHBA-së në Kosovë.

7 PY. Me sa ju kujtohet ju, a ka qenë vetëm Rexhep Selimi  
8 personi që përfaqësonte UÇK-në apo ka pas dhe persona të tjerë  
9 në anën e tij të tryezës?

10 PË. Ka pasur dhe persona të tjerë, por nuk më kujtohet të jem  
11 prezantuar me ta apo të kem folur.

12 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

13 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që të jeni kthyer që të  
14 takoheshit me anëtarë të UÇK-së në Likovc ditët pasuese pas  
15 këtij takimi dhe në këtë rast a ju kujtohet që të jeni takuar  
16 dhe një herë tjetër me Rexhep Selimi, po kësaj here Rexhep  
17 Selimi ishte bashkë me Hashim Thaçin?

18 PË. Jo, ju kërkoj ndjesë. Nuk më kujtohet një gjë e tillë.

19 PY. Pra, mesa ju kujtohet juve, hera e parë që jeni takuar me  
20 Hashim Thaçi ka qenë disa muaj më pas në Dragobil në nëntor të  
21 1998, a është kështu, Dëshmitar?

22 PË. Sikurse e thashë dhe më herët sot, nuk më kujtohen takime  
23 të tjera të mëparshme përveç këtij.

24 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.

25 PY. Të përqendrohemi te takimi i Dragobilit në nëntor të

- 1 1998. Ju thatë që nuk ju kujtohet ta keni takuar Hashim Thaçi  
2 më përpara. A ju kujtohet në qoftë se keni pasur ndonjë  
3 kontakt të ndonjë lloji me të përpara nëntorit të 1998?  
4 PË. Nuk më kujtohet të kem pasur ndonjë kontakt të  
5 drejtpërdrejtë me të. Por më kujtohet që njerëzit e përmendnin  
6 emrin e tij si dikush me të cilin unë duhet të takohesha.  
7 Përsëri dua të theksoj që interesi im ishte që të flisja me  
8 persona të cilët do mbështesnin dokumentin tonë, qëndrimin  
9 tonë.
- 10 PY. Në përmbledhjen e intervistës me Mbrojtjen në korrik sa i  
11 takon takimit të Dragobilit në 1998 thotë që në takim ka qenë  
12 një person i cili kishte reputacion që ishte i përfshirë në të  
13 shtëna me armë. Pyetja ime është kjo: A është ky i njëjti  
14 person sepse ju i thatë Blerim Shalës që ishte ky personi i  
15 cili donte që të sillte me vete, të merrte me vete armën në  
16 takim, a bëhej fjalë për të njëjtin person apo jo, Dëshmitar?  
17 PË. Personi i cili donte që të hynte në takim së bashku me  
18 armën, nuk dukej se ishte një person i nivelit të lartë në  
19 hierarki, por mund ta shihja që ai nuk është se ishte vetëm  
20 thjesht një bodigard, një roje, por nuk kishte askush tjetër  
21 armë brenda shtëpisë.
- 22 PY. A ju kujtohet t'i keni thënë Mbrojtjes së Thaçit në  
23 korrik që ky person kishte një reputacion ose njihej që  
24 shtinte me armë, a ju kujtohet një gjë e tillë?  
25 PË. Në qoftë se ata kanë thënë këtë, mund ta kenë thënë, por

1 nga ana tjetër nuk më kujtohet ta kem thënë që ky person  
2 njihej për gjeste të tilla. Me thënë të drejtën nuk jam shumë  
3 i qartë lidhur me këtë citim.  
4 PY. Në rregull. Për të qenë më i drejtë me juve, do lexoj nga  
5 paragrafi 26. Ju këtu flisni për takimin e nëntorit të 1998 në  
6 fjalinë e fundit thuhet që:

7 "Ishte një fotografi e Hill dhe Thaçit në të njëjtën  
8 shtëpi."

9 PË. Po.

10 PY. Pastaj ju thoni që:

11 "Ishte dhe një person tjetër që ishte i pranishëm aty që  
12 kishte një reputacion ose njihej që shtinte vazhdimisht. Kur  
13 ju u takuat me Thaçin, a keni pasur këtë lloj ndjesie ju që  
14 ishte një person që prania e të cilit dukej më shumë si një  
15 vrasës nëse mund të shprehem kështu."

16 PË. E kujtoj që e kam thënë që mua mu krijua ndjesia që bëhej  
17 fjalë për një person prania e të cilit ishte pak a shumë një  
18 vrasës, megjithatë nuk kujtohet që të kem bërë një koment  
19 rreth dikujt të cilin unë nuk e njihja, kaq kam për thënë,  
20 thjesht mund të them që ky person kishte armë edhe ne i  
21 kërkuam personit që të dilte nga dhoma përderisa ishte i  
22 armatosur dhe ishte i vetmi person me armë.

23 PY. Në rregull.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoj që të paraqitet në ekran  
25 prova P01086, është një video. Dua që të paraqitet gjithashtu

1 dhe përkthimi në anglisht. Për procesverbal bëhet fjalë për  
2 një përkthim që është pranuar dhe Trupi Gjykues ka pranuar  
3 versionin e rishikuar. Është dokumenti 06427-03-TR E  
4 Rishikuar-ET.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Dëshiroj që të bëhet një sqarim në  
6 faqen 67 në rreshtin 8.

7 Z. PACE: [Përkthim] E di për çfarë e keni fjalën.

8 PY. Në transkript thuhet si më pas:

9 "Kur ju jeni takuar me Thaçin, ju ... nuk ishit ndjerë në  
10 praninë e një vrasësi."

11 Ndërkohë që më pas ju keni thënë që:

12 "Keni qenë në praninë e një vrasësi."

13 PË. Ma sqaro dhe një herë se nuk e kuptova çfarë thatë?

14 PY. Përgjigja ishte që juve u ndjetë që ishit në praninë e  
15 një vrasësi apo që nuk ishit në praninë e një vrasësi?

16 PË. Jo. Kam thënë që nuk isha. Është negative përgjigja

17 PY. Në rregull. Dëshmitar, do shikojmë këtë video. Përkthimi  
18 është dhënë në të djathtë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Megjithatë, për momentin, thjesht do  
20 shohim videon, domethënë, pjesën e pamjes dhe nuk do ketë zë.  
21 Dua që të fillojmë nga minuta 00:00 dhe do i kërkoja  
22 Sekretares që të përfundojë në minutën 00:23.

23 [Luhet videoincizimi]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është prova  
25 materiale 1264, apo jo?

1 Z. PACE: [Përkthim] Jo. Është prova materiale P01086.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë sepse kemi kaluar  
4 tek videoja tani. Nuk isha unë i qartë. Kështu që ndjesë edhe  
5 një herë nga ana ime.

6 PY. Dëshmitar, në këtë video që sapo patë a e njihni vendin  
7 ku është xhiruar kjo video?

8 PË. Jo. Duket sikur është në Kosovë, po nuk mund ta them  
9 ekzaktësisht se në çfarë vendi në Kosovë.

10 PY. Personi që ka një armë, a është ky personi që keni parë  
11 më përpara?

12 PË. Jo. E pash Hashim Thaçin pak më përpara në video, por nuk  
13 shoh persona të tjerë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Të vazhdojmë dhe ta paraqesim më tej  
15 videon, por përsëri pa zë deri në sekondën 00:30.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Atëherë këtu kemi një person i cili ka një armë, siç e  
19 sheh tek kjo pjesa e ngrirë e videos. A ju kujtohet ky?

20 PË. Unë vetë kam qenë brenda godinës, brenda ndërtesës. Nuk i  
21 kam takuar jashtë. Nuk më kujtohet.

22 Z. PACE: [Përkthim] Le të vazhdojmë më tej me videon  
23 përsëri pa zë.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. PACE: [Përkthim] Të ndalojmë këtu.

1 PY. Po personin që ka veshur këmishë këtu, a e njihni?

2 PË. Po.

3 PY. Kush është ky?

4 PË. Nuk më kujtohet sesi e ka emrin, por është një person që  
5 punonte për Shtetet e Bashkuara, Qeverinë e Shteteve të  
6 Bashkuara.

7 Z. PACE: [Përkthim] Le të vazhdojmë dhe të ndalojmë në  
8 sekondën e 00:40.

9 [Luhet videoincizimi]

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Sapo pash edhe Shaun Byrnes  
11 gjithashtu.

12 Z. PACE: [Përkthim] Të ndalojmë këtu.

13 PY. A është Shaun Byrnes personi që keni në ekran?

14 PË. Po.

15 PY. Po vendin a e njihni, e keni parë më përpara?

16 PË. Jo. Mendoj që ky është takimi ku kam qenë dhe unë vetë.  
17 Unë jam futur menjëherë në godinë. Nuk i kam pritur jashtë  
18 njerëzit e tjerë kështu që nuk di çfarë ka ndodhur jashtë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Le të vazhdojmë deri në sekondën e  
20 43, domethënë, tre sekonda të tjera më tej.

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. PACE: [Përkthim] Ndalojeni këtu videon.

23 PY. A jeni këtu, Dëshmitar dhe në qoftë se po, më thoni kush  
24 është në të majtën tuaj?

25 PË. Në të majtën time është Jonathan Levitsky, që është

1 jurist që asokohe ishte një prej hartuesve kryesorë,  
2 përpiluesve kryesorë të dokumentit të autonomisë. Ai punonte  
3 për çështjet e politikave, fabrikimit të politikave në  
4 Departamentin e Shtetit.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të vazhdojmë më tej deri në sekondën  
6 e 00:47.

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. PACE: [Përkthim]

9 PY. Këta dy personi i njihni, Dëshmitar?

10 PË. Mendoj që njëri prej tyre është Jakup Krasniqi, personi  
11 që është në mes. Personin tjetër, personin në të djathtë të  
12 Krasniqit nuk e di sesi quhej, nuk më kujtohet. Ndërkohë që  
13 personi tjetër, në mos gabohem, është Thaçi.

14 PY. Në rregull.

15 Z. PACE: [Përkthim] Ta shikojmë pak më tej dhe le të  
16 ndalojmë videon në sekondën e 00:52.

17 [Luhet videoincizimi]

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 PY. Hashim Thaçi është ky, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 Z. PACE: [Përkthim] Të vazhdojmë me videon deri në  
22 sekondën 00:57.

23 [Luhet videoincizimi]

24 Z. PACE: [Përkthim]

25 PY. Një prej personave në të majtë e thatë se kush ishte. Po

1 personi në mes kush është dhe pastaj personi në fund fare?

2 PË. Personi në mes e kam njohur. Mendoj se ishte dikush nga  
3 zyra jonë në Prishtinë. Në qoftë se dikush do më përmend emrin  
4 e tij besoj që do jem në gjendje ta konfirmoj por për momentin  
5 nuk më kujtohet. Dhe më pas kemi Tina Kaidanow.

6 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua që të kalojmë tek videoja  
7 dhe ta transmetojmë atë nga 00:50 dhe më pas deri në 00:58 po  
8 kësaj here me zë. Gjithashtu dua që të tregohet transkripti në  
9 anglisht. Pra, transkripti në shqip nuk ekziston. Megjithatë  
10 fjalët thuhet në anglisht dhe transkripti është aty. Kështu do  
11 i kërkoja Sekretares që ta paraqesë së bashku me zë.

12 [Luhet videoincizimi]

13 Z. PACE: [Përkthim] Mendoj që ta paraqesim pak më  
14 përpara.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të më thoni i kujt është  
16 zëri, a mund të më thoni?

17 Z. PACE: [Përkthim] Nuk jam unë personi që duhet të jap  
18 dëshmi, megjithatë mund ta dëgjojmë dhe një herë.

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që ta transmetojë.

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Nuk jam i sigurtë në qoftë se e dëgjuat apo jo, por u tha  
24 si më poshtë:

25 "Ky është komandanti Çeliku."



1 Edhe ti thua: "Kush është komandanti Çeliku?"

2 Dhe një person i paidentifikuar thotë që:

3 "Është personi i cili është tek dera."

4 Dhe ju thoni: "Okej. Në rregull."

5 A ju kujtohet që është prezantuar komandanti Çeliku në  
6 këtë takim?

7 PË. Nuk më kujtohet, po mendoj që zëri që sapo dëgjuaam është  
8 zëri i Shaun Byrnes.

9 Z. PACE: [Përkthim] Nga e njëjta video, të shohim të  
10 gjithë së bashku nga sekonda e 00:57 deri në minutën 01:25 dhe  
11 së bashku me zërin, figura dhe zëri duhen të paraqiten së  
12 bashku.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. PACE: [Përkthim] Mund të lexoni gjithashtu dhe  
15 transkriptin në anglisht në fund të faqes.

16 Ju lutem ndalojeni këtu videon.

17 PY. Ju thoni këtu:

18 "Z. Krasniqi, ke dalë shpesh në televizion."

19 A mund të na thoni, Dëshmitar, se çfarë ka bërë, çfarë  
20 kishte bërë z. Krasniqi kur ka dalë në televizion shpesh?

21 PË. Ai përshkruhej si zëdhënësi i UÇK-së dhe kishte dhënë një  
22 intervistë të gjatë dhe të gjerë me gazetarin e CCN Christiane  
23 Amanpour.

24 PY. Përpara kësaj interviste me CCN -- atëherë përpara se të  
25 kaloj tek kjo pyetje, a mund të më thoni se kur ka ndodhur

1 intervista me CCN-in?

2 PË. Jo, nuk më kujtohet. Por ka qenë në 1998 dhe është  
3 zhvilluar në kontekstin e identifikimit të një personi që mund  
4 të fliste në emër të UÇK-së

5 PY. Në përmbledhjen e intervistës tuaj me Mbrojtjen e Thaçit  
6 në korrik, thuhet që ju i keni thënë Mbrojtjes që:

7 "Amanpour e CCN-it e ka intervistuar z. Krasniqi pas  
8 emërimit të tij pas ditës pas emërimit të tij si zëdhënësi i  
9 UÇK-së."

10 A ju kujtohet kështu, Dëshmitar, që kjo intervistë është  
11 organizuar disa ditë përpara 6 nëntorit 1998 kur e keni takuar  
12 ju së bashku me z. Hill në Dragobil?

13 PË. Nuk më kujtohen. Nuk e di sesa ditë mund të kenë kaluar,  
14 por ka qenë pa diskutim përpara 6 nëntorit.

15 PY. Në memorien tuaj dhe këtë e thoni në kontekstin kur keni  
16 diskutuar takimin e janarit të 1999 lidhur me shkëmbimin e të  
17 burgosurve, ju thoni:

18 "Në Likoc, ne u ulëm përballë në tavolinë me  
19 përfaqësuesit e UÇK-së, me zëdhënësin e UÇK-së, a ju kujtohet  
20 ta keni thënë këtë në memorien tuaj, Dëshmitar?

21 PË. E kam thënë, më kujtohet, por nuk më kujtohet qartë në  
22 qoftë se ka pasur -- nuk e di në qoftë se ka ndodhur takimi i  
23 tij, intervista e tij me Christian Amanpour disa ditë më  
24 përpara apo jo. Kështu që i takon që ajo çfarë kam pasqyruar  
25 në memoarin tim është e pasaktë.

1 PY. Mesa dini ju, Jakup Krasniqi a vepronte zyrtarisht si  
2 zëdhënës i UÇK-së në verën e 1998?

3 PË. Nuk e di në qoftë se kishte rolin zyrtar apo jo të  
4 caktuar apo jo si zëdhënës, megjithatë me siguri unë mund  
5 t'jua them që në intervistën që ka dhënë me Christiane  
6 Amanpour, ai e ka përshkruar veten si zëdhënës të UÇK-së.

7 PY. Në 1998 ose në 1999, Dëshmitar, a e dinit ju që Hashim  
8 Thaçi ishte anëtar i drejtorisë politike të UÇK-së, a e kishit  
9 këtë informacion?

10 PË. Në një pikë të caktuar ai përshkruhej si anëtar i  
11 drejtorisë politike. Nuk jam në gjendje t'ju them se kur është  
12 identifikuar kjo, kur është thënë kjo gjë, por ka qenë dikur  
13 përpara Rambujesë. Më shumë hollësi nuk ju jap dot.

14 PY. A e dini ju nëse Hashim Thaçi ka qenë një prej  
15 themeluesve të UÇK-së?

16 PË. Nuk e di. Nuk e di nëse ai ka qenë një prej personave  
17 themelues të UÇK-së dhe fakti që unë nuk e kam hasur emrin e  
18 tij deri më vonë gjatë vitit më sugjeron që ai nuk ka qenë,  
19 megjithatë nuk jam në pozitë për ta konfirmuar ose jo një gjë  
20 të tillë.

21 PY. E kuptojmë. Gjatë takimit në Dragobil të 6 nëntorit 1998  
22 që e kemi diskutuar në thellësi sot dhe që pamë gjithashtu  
23 edhe videon, ju parashtruat marrëveshjen e propozuar të  
24 përkohshme, por Hashim Thaçi nuk u përfshi në negociata sepse  
25 ai nuk kishte angazhim të plotë për pavarësinë, apo jo?

1 PË. Unë nuk e di arsyen, nuk mund t'ua them dot këtë gjë, por  
2 nuk e di në qoftë se arsyeja ishte që ata kërkonin pavarësi të  
3 plotë. Nuk e di në qoftë se ka patur arsye të tjera apo jo.  
4 Nuk jam unë personi që mund t'ju them se cilat kanë qenë  
5 arsyet që ai nuk u prefshi me dokumentin tonë plotësisht, nuk  
6 di t'ju them.

7 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të  
8 paraqesë një përmbledhje të intervistës së dëshmitarit me  
9 Mbrojtjen në korrik që ka numrin DHT12160 deri në DHT12169.

10 PY. Dëshmitar, tani edhe një herë do lexoj një pjesë të  
11 përmbledhjes tuaj të dëshmisë që keni pasur me Mbrojtjen në  
12 korrik dhe pastaj do ju bëj një pyetje lidhur me atë çfarë  
13 citohet, të jetë thënë prej jush.

14 Z. PACE: [Përkthim] Është në faqen DHT12123, paragrafi  
15 26.

16 PY. Ju thoni që:

17 "Në atë kohë, shtypi ishte në ankth se mos ndodhte një  
18 Bosnjë e dytë. Christiane Amanpour i CCN-it intervistoi Jakup  
19 Krasniqin si zëdhënësi i UÇK-së. Disa ditë më pas në nëntor të  
20 1998, Hill u takua me të në Dragobil, në Drenicë, në Luginën e  
21 Drenicës edhe ai ishte me Hashim Thaçin. Hill tha që ju dha  
22 atyre marrëveshjen e propozuar të përkohshme. Thaçi nuk u  
23 përfshi në negociata sepse nuk kishte -- pra, ishte por  
24 angazhimit për pavarësi ..."

25 A ju kujtohet ta keni thënë një gjë të tillë, Dëshmitar?

1 PË. Mendoj që arsyeja e z. Thaçi ka qenë që donte, që ishte  
2 pro pavarësisë së plotë. Megjithatë nuk e di se çfarë arsye  
3 mund të ketë pasur. Ndoshta nuk ka pas autorizim, nuk ka pas  
4 kompetencë që të përfshihej me ne. Megjithatë, mua kjo më  
5 duket si një arsye e justifikuar ose bindëse për arsyen sepse  
6 nuk u angazhua apo nuk u përfshi me ne sepse ky ishte  
7 shqetësimi kryesor i tyre.

8 Z. PACE: [Përkthim] Le ta heqim dokumentin nga ekrani.

9 PY. Në këtë koment anëtarët e UÇK-së, në këtë takim që patët  
10 ju, anëtarët e UÇK-së ju thanë që do t'ua jepnin komentet e  
11 tyre sa i takon marrëveshjes së përkohshme në të ardhmen, apo  
12 jo?

13 PË. Po. Nëse më lejoni dua të shtoj se ata kërkonin pranimin  
14 tonë si bashkëveprues, si bashkëbisedues dhe ne ua vumë të  
15 qartë atyre që në qoftë se UÇK-ja do ishte pjesë e procesit  
16 duhej që të angazhoheshin me këtë marrëveshje, me këtë  
17 dokument.

18 PY. Pas takimit në Dragobil, Shtabi i Përgjithshëm në UÇK-së  
19 e rrëzoi, e refuzoi zgjedhjen e përkohshme për Kosovën, apo  
20 jo?

21 PË. besoj se është e saktë megjithatë më duhet ta shoh edhe  
22 një herë, duhet ta kontrolloj. Më lejoni të theksoj se ne nuk  
23 kishim shumë fat për sa i takon gjetjes së një bashkëbiseduesi  
24 të UÇK-së që do përfshihej më gjerë dhe që të jepte një  
25 kontribut më të përnjëmend.

1 PY. Sikurse e keni thënë në intervistën me Blerim Shalën,  
2 kontaktet tuaja me Xhavit Halitin dhe kontaktet e Rossin me  
3 Bardhyl Mahmutin, puna e Shaun Byrnes në terren dhe fakti që  
4 Bill Walker dhe Byrnes asnjëherë nuk kishin folur me njëri-  
5 tjetrin, ju bën juve që të merreshit me shumë çështje  
6 njëkohësisht, apo jo, domethënë, kishit shumë gjëra përpara të  
7 trajtuar, apo jo?

8 PË. Mund të thosha, po.

9 PY. Juve thatë më herët që ekzistonte perceptimi që ju ishin  
10 i ngushtë, i afërt me Rugovën. Pyetja ime është kjo: Ky  
11 perceptim ekzistonte dhe brenda UÇK-së, apo jo?

12 PË. Ky ishte një perceptim që kishin personat që ishin jo pro  
13 Rugovës dhe po ashtu ishte një perceptim që e kishin dhe disa  
14 bashkëpatriotë të mi, pra, disa amerikanë të tjerë.

15 PY. Do kalojmë në një temë tjetër tani. Do të kalojmë tek  
16 takimi i janarit të 1999 që ka të bëjë me shkëmbimin e të  
17 burgosurve. Është një temë e cila u trajtua gjithashtu  
18 shkurtimisht edhe nga Avokati i z. Krasniqi.

19 Dhatë dëshmi lidhur me këtë takim. Ju thatë qenë këtë  
20 takim ishte i pranishëm dhe Jakup Krasniqi. Po kishte dhe  
21 persona të tjerë në këtë takim apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Po, kishte dhe të tjerë, nuk e di se kush ishte  
23 ekzaktësisht. Megjithatë më duhet të shtoj që unë isha i  
24 befasuar që po bisedoja me të sepse me sa dija unë ai ishte  
25 zëdhënësi. Kështu përshkruhej ai.

- 1 PY. A ju kujtohet që takimi i parë për shkëmbimin e të  
2 burgosurve ka ndodhur më datë 11 janar 1999 në Drenovc?
- 3 PË. Përpara takimit me Krasniqin?
- 4 PY. Jo, e kam fjalën për të njëjtin takim.
- 5 PË. Po, më kujtohet ky takim.
- 6 PY. A ju kujtohet që ka ndodhur në Drenovc, në Drenovc të  
7 Malishevës?
- 8 PË. Nuk më kujtohet se ku ka qenë, por më kujtohet që  
9 mbërrita në vendin e takimit pa u hasur me problemet që kisha  
10 hasur më përpara.
- 11 PY. A ju kujtohet që ka qenë Wolfgang Petritsch aty i  
12 pranishëm.
- 13 PË. Jo, nuk më kujtohet. Më kujtohet që ka qenë Tina  
14 Kaidanow, Bill Walker, Dana Atkins që ka qenë përfaqësues i  
15 Gjeneralit Clark.
- 16 Z. PACE: [Përkthim] Të paraqesim në ekran dokumentin  
17 P01091-ET dhe P01091-AT. Shohim faqen e parë.
- 18 PY. Sikurse mund ta shikoni dokumenti në të djathtë është një  
19 anglisht.
- 20 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në fillim të  
21 faqes.
- 22 PY. Besoj që e lexoni që në fillim fare shkruhet "Dr. Jakup  
23 Krasniqi, Libër që është në proces përgatitje", ndërkohë që  
24 titulli është, "UÇK-ja në Konferencën Ndërkombëtare të  
25 Rambujesë për Kosovën dhe bombardimet e NATO-s".

1           Z. PACE: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares tani të  
2   kalojë në faqen që përfundon 1062. Do lexoj nga fjalia e  
3   fundit dhe pastaj do të vazhdoj me faqen pasardhëse.

4           DËSHMITARI: [Përkthim] Ndërkohë që po presim, "përpunim"  
5   do të thotë "*in progress*" në anglisht?

6           Z. PACE: [Përkthim] Po, ky është përkthimi që i kemi bërë  
7   ne. Megjithatë ju jeni ekspert më shumë sesa ne.

8           Do lexoj në këtë faqe në fjalinë e fundin dhe pastaj do  
9   vazhdoj tek faqja tjetër.

10          PY. Edhe njëherë, do lexoj dhe do ju bëj disa pyetje.

11          "Në këtë kohë jo vetëm që ishim në lidhje të vazhdueshme"  
12   - vijojmë në faqen tjetër - "me zonat operative të UÇK-së por  
13   edhe takimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishin më të  
14   shpeshta për arsyet se rëndësia ishte shumë e madhe. Dhe ne  
15   kemi monitoruar gjithashtu edhe moralin ushtarak që ishte në  
16   nivel të lartë, përcillnin furnizim me armë (ku kishim shumë  
17   vështirësi) e ushqime si dhe gatishmërinë operative në radhët  
18   e UÇK-së, e cila vazhdonte të ishte në nivel të lartë. Në këto  
19   mbledhje është biseduar gjerë e gjatë dhe me përgjegjësi  
20   problemi i ushtarëve serbë të zënë rob dhe cila duhet të ishte  
21   kundërpërgjigja jonë. Pas shumë bisedimeve, me argumente e  
22   kundërarargumente, kemi vendosur për këmbimin e tetë ushtarëve  
23   serbë të kërkojmë nëntë ushtarët e kapur nga forcat armike në  
24   zonën kufitare në mesin e dhjetorit 1999. Kështu hartuam  
25   kërkesën tonë para se të shkonim në takim që veç ishte



1 paralajmëruar të mbahej më 11 janar 1999 në odën e Sadik  
2 (Jahe) Morinës, të cilit më vonë snajperistët serbë i vranë  
3 gruan. Në takim nga pala ndërkombëtare do të merrnin pjesë  
4 Ambasadori i SHBA në Shkup, z. Christopher Hill dhe Ambasadori  
5 austriak Petritsch, i cili përfaqësonte BE-në menjë numër të  
6 madh bashkëpunëtorësh. Në ekipin e Hill atëherë ishte dhe  
7 shefja e zyrës asokohe amerikane në Prishtinë Tina Kaidanow,  
8 atëherë ishte dhe shefja e zyrës amerikane në Prishtinë 2006-  
9 2007, e cila pas pavarësisë ishte ambasadore. Takimi ka  
10 zgjatur më tepër se pesë orë. Gjatë gjithë kohës kemi qenë në  
11 kontakt me shefin e drejtorisë politike dhe anëtarët e tjerë  
12 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

13 Po ashtu në takim ishin diplomatët e përmendur, kurse  
14 Shtabi i Përgjithshëm përfaqësohej nga Jakup Krasniqi, Sokol  
15 Bashota, Ramë Buja dhe Adem Grabovci."

16 Dëshmitar, a ju kujtohen personat e tjerë që kanë qenë të  
17 pranishëm në këtë takim?

18 PË. Wolfgang Petritsch nuk më kujtohet që ka qenë i pranishëm  
19 në takim. Por në të majtën time ishte Bill Walker sepse  
20 mendohej se ky ishte një shkëmbim që ishte ndërmjetësuar nga  
21 OSBE-ja dhe synimi ishte që të rritej roli i OSBE-së dhe  
22 Walker në atë kohë ishte përgjegjës i OSBE-së si përfaqësues i  
23 Misionit Verifikues të Kosovës. Petritsch nuk më kujtohet se  
24 ka qenë i pranishëm në këtë takim. Në qoftë se do ketë qenë,  
25 do ketë qenë në të djathtën time, po nuk më kujtohet.

1 Po ashtu Dana Atkins dhe Tina Kaidanow më kujtohen, jam i  
2 sigurtë që ka pasur dhe persona të tjerë po këta më kujtohen.  
3 PY. Do shohim disa fotografi së bashku dhe pastaj mbase mund  
4 ta sqarojmë se kush ka qenë në këtë takim.

5 PË. Po, patjetër.

6 PY. Tani do të përqendrohemi në diçka tjetër që ka shkruar z.  
7 Krasniqi. Z. Krasniqi thotë që ky takim ka zgjatur më shumë se  
8 pesë orë. Unë mund t'jua bëj ndryshe pyetjen, a ju kujtohet që  
9 ky ka qenë takim i gjatë, Dëshmitar?

10 PË. Kam organizuar shumë takime në gjithë botën në fakt, jo  
11 vetëm atje. Po nuk më kujtohet që takimet të kenë zgjatur kaq  
12 gjatë që të kenë qenë pesë orë. Nuk më kujtohet një gjë e  
13 tillë. Më kujtohet që ka qenë një takim relativisht i gjatë.  
14 Po nuk mund të them që ka qenë pesë orë, s'më kujtohet.

15 PY. Z. Krasniqi thotë që gjatë këtij takimi ai dhe të tjerët  
16 kanë qenë në kontakt me drejtorinë politike të UÇK-së dhe me  
17 anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm. A ju kujtohet që  
18 në këtë pikë, domethënë, janar të 1999 ju e dinit se kush ka  
19 qenë shefi i drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm të  
20 UÇK-së?

21 PË. Nuk më kujtohet nëse e ka thënë këtë gjë apo jo dhe nuk  
22 më kujtohet në qoftë se ai ka sugjeruar që ai ka qenë në  
23 kontakt me z. Thaçi. Nuk më kujtohet fare kjo gjë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument nga  
25 ekrani. Në vend të këtij dokumenti dëshiroj që të paraqitet

1 një tjetër dokument me numër SPOE00130696 deri në

2 SPOE00130696.

3 PY. Siç ju thashë më parë, këtu kemi një fotografi, data në  
4 fotografi është 11 janar 1999. Njihni ndonjë person këtu në  
5 fotografi?

6 PË. Natyrisht. Këtu afër meje është Wolfgang Petritsch. Ky  
7 duket si vendi i mëparshëm ku u takova me Hashim Thaçin, me z.  
8 Thaçi. Ky duket si, në mes, si Krasniqi. Nuk i njoh dy  
9 individët në të majtë të tij.

10 PY. E njihni personin përballë, në pjesën e parë të imazhit?

11 PË. Jo. Duket si amerikan që punonte për qeverinë amerikane.

12 PY. Dhe ju thatë që kjo duket si vendi ku jeni takuar më parë  
13 me Thaçin. Duhet të jetë Dragobil takimi i nëntorit për të  
14 cilin po flisnim?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe ju kujtohet se Wolfgang Petritsch ka qenë në Dragobil  
17 me juve?

18 PË. Besoj fotografinë, por nuk më kujtohet.

19 PY. Ajo që shohim nga fotografia, siç e përmendët vetë, është  
20 Wolfgang Petritsch, Jakup Krasniqi dhe disa të tjerë, datë  
21 është 11 janar 1999. Ju kujtohet nëse ky ka qenë rasti ku ju  
22 keni diskutuar lirimin apo shkëmbimin e ushtarëve?

23 PË. Jo, ka qenë një dhomë tjetër. Ka qenë një vend më një  
24 takim më formal dhomë e madhe me një tavolinë të madhe mes  
25 nesh. Nuk ka qenë ky takim fare.

1 PY. A ju kujtohet nëse pas këtij takimi fillestar lidhur me  
2 shkëmbimin u ra dakord që të bëhej një takim pas dy ditësh më  
3 13 janar në Likovc?

4 PË. Nuk më kujtohet.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument, këtë  
6 fotografi. Dhe në vend, tani kthejmë në ekran dokumentin që po  
7 shihnim më herët, që është P01091-ET, P01091.

8 PY. Dëshmitar, kjo është një pjesë tjetër e nxjerrë nga libri  
9 i Krasniqit në përparim.

10 PË. Në rregull.

11 Z. PACE: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen SPOE00231064 në  
12 dy gjuhët.

13 PY. Në anglisht lexoj nga fillimi i faqes nga aty ku fillon  
14 "Pas diskutimeve të gjatë ..." Këtu është:

15 "Pas diskutimeve të gjata në të cilat Walker do të merrte  
16 pjesë edhe ai që u mbajtën në Likovc në zonën e Drenicës, në  
17 ndërtesën e shtabit të zonës operative, më 13 janar 1999.

18 Zgjedhja e Likovcit përmbante dhe një element simbolik.

19 Drenica mbante barrën më të madhe të luftës dhe kushtet atje  
20 ishin më të mira për të mbajtur bisedime të këtij niveli në  
21 siguri të plotë. Bisedimet kërkonin siguri të plotë dhe duhet  
22 të mbaheshin në një vend të sigurtë."

23 Z. PACE: [Përkthim] Do vazhdoj më tej.

24 PY. "Dy delegacionet me një numër të madh gazetarësh kishin  
25 ardhur në Likovc në orarin e paracaktuar. Nga pjesa e

1 ndërkombëtarëve ishin të pranishëm për OSBE-në, William Walker  
2 me një numër të madh kolegësh, ana amerikane përfaqësohej nga  
3 Christopher Hill me një koleg, ndërsa për BE, Wolfgang  
4 Petritsch dhe kolegët dhe ambasadori i Francës në Shkup.  
5 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së përfaqësohej nga Jakup  
6 Krasniqi, Sokol Bashota, ramë Buja dhe Shaban Shala nga Zona  
7 Operative e Drenicës.”

8 A ju kujtohet takimi me këta pjesëmarrës pak kohë pas  
9 takimit të parë?

10 PË. Jo, nuk më kujtohet.

11 PY. Ta provojmë me fotografi edhe këtu.

12 Z. PACE: [Përkthim] Edhe për këtë do të shfaqim në ekran  
13 dokumentin SPOE00130702 deri në 00130702.

14 Do të përpiqem.

15 PY. Dëshmitar, të shohim një fotografi tjetër. Data këtu në  
16 fotografi është 13 janar 1999. A mund të na thoni a njihni  
17 dikë këtu?

18 PË. Po. Së pari, nuk e njoh dhomën. Nuk besoj t’i kem mbajtur  
19 këtu bisedimet me z. Krasniqi. Afër meje duket Wolfgang nga  
20 koka, nga pjesa e pasme e kokës Wolfgang Petritsch. Pastaj  
21 përballë tij Bill Walker. Aty është Shaun Byrnes që është në  
22 këmbë. Nuk e njoh këtë personin tjetër. Duket i veshur shumë  
23 mirë. Dha aty pastaj jam unë me sytë e mbyllur.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do të shfaqim tani në ekran një  
25 fotografi tjetër. SPOE00130703 deri në 00130703.

1 PY. Besoj që pajtoheni me mua që ky është i njëjti takim nga  
2 e njëjta ngjarje, po nga një kënd tjetër. Është dikush tjetër  
3 këtu që mund ta identifikosh?

4 PË. Jo. Në anën time të majtë është Tina. Në të majtën e saj  
5 është Phil Reeker. Personi i veshur mirë nuk e njoh. Pastaj  
6 Shaun, Wolfgang i ulur aty. Dhe personi i ulur pas tij nuk e  
7 njoh. Ah edhe ky është Bill Walker, natyrisht.

8 PY. Faleminderit. Autoritetet serbe kishin këmbëngulur që  
9 pengjet serbe të liroheshin dhjetë ditë përpara atyre  
10 shqiptare, ushtarëve të UÇK-së?

11 PË. E saktë.

12 PY. Më herët besoj që ju dëshmuat se Jakup Krasniqi kishte  
13 një qasje të ashpër dhe radikale dhe këmbëngulte që shkëmbimi  
14 të jetë i njëkohshëm?

15 PË. E saktë.

16 PY. William Walker ishte i zemëruar me z. Krasniqi dhe  
17 pothuajse u largua nga mbledhja?

18 PË. E saktë.

19 PY. Përmbledhja e deklaratës tuaj - mund ta heqim fotografinë  
20 - thotë se juve nuk ju kujtohet që Jakup Krasniqi ka përdorur  
21 telefon në atë kohë. Kjo është në kontekstin e takimit lidhur  
22 me shkëmbimin e pengjeve. A ju kuptoj saktë që nuk ju kujtohet  
23 diçka e tillë lidhur me shkëmbimin e pengjeve?

24 PË. Është e saktë. Nuk më kujtohet ai të ketë përdorur  
25 telefona në praninë time.

1 PY. Dhe në përmbledhjen e deklaratës së tuaj raportohet, që i  
2 keni dhënë Mbrojtjes së Thaçit në korrik të këtij viti, gjatë  
3 takimit apo takimeve me Jakup Krasniqin, pra, gjatë takimit  
4 apo takimeve Jakup Krasniqi zhdukej, ikte për një periudhë të  
5 shkurtër kohore dhe pastaj kthehej në mbledhje në dhomën ku po  
6 bëhej takimi. Edhe në këtë rast takimi kishte të bënte me  
7 shkëmbimin e pengjeve, apo jo?

8 PË. Ai largohej dhe kthehej. Këtu e keni pyetjen?

9 PY. Po.

10 PË. I thashë Mbrojtjes së Thaçit, që unë i kam thënë  
11 Mbrojtjes së Thaçit, a është kështu si po thoni?

12 PY. Po.

13 PË. Nuk kam asgjë për ta kundërshtuar një gjë të tillë.

14 PY. Që të jemi tërësisht të qartë do ju lexoj paragrafin.

15 Është nga paragrafi 32.

16 PË. Në rregull.

17 PY. Nuk ka nevojë ta shfaqim në ekran. Dhe po lexoj, citoj:

18 "Hill nuk e di saktësisht kush në UÇK ka miratuar lirimin  
19 e ushtarëve të UÇK-së. Nuk mendon që ka qenë Krasniqi.  
20 Krasniqi largohej për një kohë pastaj kthehej prapë. Kishte  
21 marrë disa udhëzime lidhur me këtë pikë sepse ai nuk mendonte  
22 se ishte çështje kaq e madhe. Nuk kishte arsye të mendonte apo  
23 të besonte që do të merrte një vendim kaq të madh. Hill nuk i  
24 kujtohet që Krasniqi të ketë përdorur telefon në atë kohë."

25 Pjesë e kësaj ju është lexuar më herët juve. A pasqyron

1 kjo atë që keni thënë në korrik?

2 PË. Po. Do të thoja se telefonat celular ishin të rrallë në  
3 atë kohë dhe nuk e di çfarë ka bërë. Nuk më kujtohet nga fundi  
4 i takimit por -- më kujtohet që në fund të takimit akoma nuk  
5 kishim arritur marrëveshje.

6 PY. Në memoarin tuaj e përshkruani Wolfgang Petritsch si një  
7 person i lexuar, i ditur, inteligjent, diplomat shumë i mirë.

8 PË. Po.

9 PY. Që njihte Ballkanin mirë, pra, a është e saktë?

10 PË. Po.

11 PY. E dini nëse Wolfgang Petritsch ishte në kontakt me Hashim  
12 Thaçin lidhur me shkëmbimin e pengjeve?

13 PË. Duhet ta pyes atë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Le të shfaqim në ekran një dokument  
15 tjetër.

16 PY. Dhe siç e shohim këtu.

17 Z. PACE: [Përkthim] Është dhe versioni gjermanisht. Mund  
18 të shohim në versionin në gjuhën angleze. Është përkthimi i  
19 intervistës me Dr. Wolfgang Petritsch. Kalojmë në faqen 3940,  
20 faqja e fundit. Në anglisht mjafton aty ku është tani. Në  
21 qoftë se shkojmë në fund kemi një referencë që është 5 janar  
22 2018 në Vjenë.

23 Kthehemi në faqen DHT03926-ET, në anglisht, ku do lexoj  
24 përgjigjen e parë, duke filluar nga përgjigja e parë.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të pyes, çfarë po shoh



1 këtua? Është një intervistë e dhënë shtypit?

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 PY. Po. Siç e pamë në faqen e parë, kjo është intervistë me  
4 Dr. Wolfgang Petritsch. Dhe përshkrimi i dokumentit, ky është  
5 dokument që na është dhënë neve nga Mbrojtja e z. Thaçi dhe i  
6 referohet një libri të shkruar nga Faruk Ajeti. Përpigem ta  
7 shqiptoj emrin e librit në gjermanisht siç duhet. Dhe aty që  
8 përmban intervistën e bërë me Dr. Wolfgang Petritsch. Dhe data  
9 e librit siç e dhamë është 2022.

10 Pra, intervista me z. Petritsch është bërë më 2018.

11 PË. Në rregull.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të përsërisni  
13 numrin ERN, ju lutem, të faqes?

14 Z. PACE: [Përkthim] Po, është e saktë. 3926. Aty jemi.  
15 Dhe do të lexoj në anglisht nga pyetja dhe përgjigja e parë në  
16 këtë faqe:

17 "Dr. Petritsch: Ne kemi identifikuar Thaçin si një prej  
18 udhëheqësve politikë të UÇK-së relativisht shpejt gjatë vitit  
19 1998. Gjithashtu më kujtohet se rreth datës 10 janar 1999,  
20 gjatë bisedimeve mbi shkëmbimin e ushtarëve jugosllavë të  
21 cilët ishin marrë rob nga UÇK-ja kam marrë miratimin për  
22 propozimin sesi duhej bëhej dhe këtë e mora nga Thaçi përmes  
23 telefonit. Kam patur avantazhin krahasuar me Chris Hill,  
24 ndërmjetësuesin amerikan dhe shefin e OSBE-së të Misionit  
25 Verifikues në Kosovë, William Walker, sepse unë mund të flisja

1 gjermanisht me z. Thaçi, anglishtja e tij ishte e dobët në atë  
2 kohë. Thaçi më dha gjithashtu provën se ai kishte diçka për të  
3 thënë në UÇK që ishte e rëndësishme për përgatitjet për  
4 procesin e negociatave.”

5 A ishit ju në dijeni se z. Thaçi i dha z. Petritsch  
6 miratimin për propozimin sesi duhej të bëhej shkëmbimi i  
7 pengjeve?

8 PË. Nuk më kujtohet që të kem qenë në dijeni. Më kujtohet  
9 thjesht që ata donin, që z. Krasniqi donte që kjo të bëhej mbi  
10 një bazë të reciprocitetit të mirëfilltë. Nuk më kujtohet që  
11 të ketë pasur një kontakt të tillë përpara.

12 PY. Dhe ju dëshmuat më herët që ju nuk mendoni, nuk besoni të  
13 ketë qenë Jakup Krasniqi i cili ka biseduar me juve  
14 personalisht, i cili bisedoi me ju personalisht por ju nuk  
15 bisedonit që ishte ai që mori atë vendim?

16 PË. Ai duket të ketë qenë aty në rolin e tij si zëdhënës  
17 sepse nuk mora ndonjë përshtypje tjetër aty, por nuk po  
18 sugjeroj se unë e dija se kush i merrte në fakt vendimet.

19 PY. Ne pamë këtu Dr. Petritsch raportohet të ketë thënë ku  
20 citojmë:

21 “Identifikuar Thaçin si një prej udhëheqësve politik të  
22 UÇK-së relativisht shpejt gjatë vitit 1998.”

23 Ishit në dijeni për këtë?

24 PË. Nuk jam në dijeni për këtë. Nuk e di a është Ajeti  
25 gjerman apo ndonjë revistë? Nuk e di çfarë është kjo.

1 PY. Siç e thashë, kjo është marrë nga një libër i shkruar nga  
2 Faruk Ajeti.

3 PË. E kuptoj. Në rregull.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dorëzoj këto  
5 faqe për pranim si prova dhe këto janë DHT03918 të dyja në  
6 gjermanisht dhe -ET, përkthimi i saj në anglisht dhe pastaj  
7 DHT03940 në anglisht dhe shqip. Kjo ishte faqja e fundit dhe  
8 në fund faqja që sapo lexuam DHT03926-ET.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do të kundërshtoja por  
10 do të më duhet pak kohë për këtë dhe do ta bëja jashtë pranisë  
11 së dëshmitarit dhe dua të bëhet në seancë private, kështu që  
12 propozoj që ta bëjmë këtë pesë minuta përpara orës 13.00 që të  
13 mos ndërpres marrjen në pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
15 [Përkthim] Jepini një numër provizor këtyre.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Faqet me  
17 ERN DHT03918 anglisht dhe gjermanisht, DHT03940 anglisht dhe  
18 gjermanisht dhe DHT03926 anglisht dhe gjermanisht do t'ju  
19 jepet numri provizor P04508. Dhe klasifikimi është  
20 konfidencial.

21 Z. PACE: [Përkthim] Klasifikimi mund të jetë publik.

22 Mund t'i heqim dokumentet për momentin.

23 PY. Tani do të ndërroj pak temë, Dëshmitar dhe do të doja që  
24 të përqendroheshit në pjesën, në periudhën pak përpara,  
25 menjëherë përpara Konferencës së Rambujesë.

- 1 Pak përpara konferencës, Jakup Krasniqi publikisht  
2 deklaroi se në Rambuje UÇK-ja do të propozonte një referendum  
3 për pavarësinë e Kosovës pas një skadimi të një periudhe të  
4 përkohshme. Ju kujtohet kjo?
- 5 PË. Nuk më kujtohet, por më duket normale të ketë thënë një  
6 gjë të tillë, ka kuptim.
- 7 PY. Dhe menjëherë pak përpara Konferencës së Rambujesë, Jakup  
8 Krasniqi deklaroi publikisht se në Rambuje përfaqësuesit e  
9 UÇK-së do të udhëhiqnin delegacionin e shqiptarëve të Kosovës,  
10 është kështu?
- 11 PË. Nuk më kujtohet kjo. S'kam dyshim që kjo ishte pikëpamja  
12 e atyre, por ne nuk e shihnim kështu këtë gjë.
- 13 PY. Dhe në fillim të konferencës në Rambuje, juve deklaruat  
14 publikisht se shqiptarët duhet të mos flisnin më për pavarësi,  
15 duhet të mos flisnin më për pavarësinë.
- 16 PË. Nuk më kujtohet të kem dhënë një deklaratë të tillë  
17 përveçse kam thënë që ata duhet të angazhoheshin mbi bazën e  
18 dokumenteve që ishin temë e konferencës dhe jo në disa të  
19 tjerë që disa persona shpresonin të kishin si rezultat.
- 20 Z. PACE: [Përkthim] Mund të thërrasim, mund të paraqesim  
21 në ekran dokumentin 065781-065786. Këtu shohim që i referohet  
22 AP, Agjencia e Shtypit. Dhe përmban titullin "Francë:  
23 Kryesuesi i bisedimeve të paqes, protestohet kundër tij nga  
24 persona të caktuar."
- 25 Tani kalojmë në faqen "Mbështetës të UÇK-së protestojnë

1 kundër kryesuesit të bisedimeve të pages.”

2 Në faqen në vijim i referohet konferencës së Rambujesë,  
3 pra, në Francë, 6 shkurt 1999.

4 Dhe pastaj kalojmë në faqen 065784 dhe kalojmë, zbresim  
5 pak më poshtë këtu.

6 PY. Në krye të faqes tonë lexon:

7 “Kryenegociatori i konferencës është Christopher Hill,  
8 ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Maqedoni, i cili ka qenë  
9 në shkëmbimet e vazhdueshme për muaj të tërë midis palëve.

10 “Ai tha që priste që të dy palët të bëjnë kompromise.”

11 Dhe pastaj tha.

12 “Shqiptarët duhet të mos flasin më për pavarësi dhe  
13 serbët duhet mos flasin më për *status quo* dhe duhet të gjejnë  
14 një zgjidhje të mesme, diku në mes. Mendoj që ky është një  
15 motivim i fuqishëm që të arrihej kjo gjë, situata kërkon një  
16 zgjidhje politike. Njerëzit po vriten dhe situata duhet të  
17 ndryshojë dhe kjo do të ndodhë shpejt.”

18 Dhe pastaj më tej thotë:

19 “Christopher Hill, kryenegociator.”

20 PË. Nuk më kujtohet kjo deklaratë konkrete, por sigurisht që  
21 pasqyron mendimin, pikëpamjen time dhe atë të qeverisë time se  
22 palët duhej të fillonin të kërkonin rrugë apo mënyra për të  
23 biseduar me njëri-tjetrin në vend që të jepnin, thjesht të  
24 deklararin qëndrimet e tyre. Në këtë deklaratë, mesa duhet,  
25 kanë përshkruar faktin se serbët thjesht donin *status quo* dhe

1 pala e shqiptarëve të Kosovës donin pavarësinë dhe kjo  
2 qartësisht ishte diçka që duhej të lëvizte dhe të bëjë që  
3 palët duhet të takoheshin diku në mes. Dhe kjo do ishte  
4 kuptimplotë.

5 Z. PACE: [Përkthim] E dorëzoj këtë dokument si provë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. PACE: [Përkthim] E dorëzoj dokumentin, të nderuar,  
8 065781 deri në 065786. Mund të jetë publik.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 05781 deri në  
11 05786 pranohet.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do marrë  
13 numrin e provës materiale P04509. Dhe klasifikimi është  
14 publik.

15 Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin.

16 PY. Dëshmitar, pjesëtarë të UÇK-së, përfshirë Hashim Thaçin  
17 kishin shprehur qartë qëndrimin e tyre lidhur me pavarësinë  
18 muaj përpara 1999, e saktë?

19 PË. E saktë.

20 PY. Ju kujtohet që në tetor 1998, mediat ndërkombëtare cituan  
21 Hashim Thaçin si përfaqësues i UÇK-së ku thonin se UÇK-ja do  
22 të ndëshkonte çdo individë apo grup që guxonte të nënshkruante  
23 një marrëveshje në kundërshtim me vullnetin e popullit të  
24 shprehur në referendumin e 1991?

25 PË. Nuk më kujtohet.

1 PY. A ju kujtohet informacioni se Hashim Thaçi dhe kolegët e  
2 tij nuk do të mbështesnin në asnjë mënyrë dhe asnjëherë një  
3 zgjidhje politike pa referencë të shprehur qartë për pavarësi  
4 në dokumentin përfundimtar dhe kjo është thënë përpara  
5 nëntorit 1998?

6 PË. Nuk më kujtohet kjo, por nuk më habit.

7 PY. Afër fundit të Konferencës së Rambujesë, pra, konkretisht  
8 18 shkurt 1999, ju pranuat publikisht se UÇK-ja do të duhej të  
9 merrte vendime të vështira, a është e saktë?

10 PË. E saktë.

11 PY. Dhe ju deklaruat se ishte sigurisht jo e lehtë për  
12 njerëzit e UÇK-së të cilët kishin qëndruar në pyje, në male  
13 duke luftuar për pavarësi dhe që ata nuk do ta merrnin këtë  
14 pavarësi në Rambuje, në Marrëveshjen e Rambujesë, kjo do të  
15 ishte e vështirë?

16 PË. Po. Dhe kjo ka qenë në kontekstin -- është konteksti i  
17 zakonshëm kur dikush vjen në negociata, gjithmonë e vështirë  
18 të arrihet në një përfundim që nuk është ai që është  
19 përfundimi që kanë pasur ata në mendje për përpara.

20 PY. Gjatë takimit të 20 shkurtit 1999, Hashim Thaçi ju tha  
21 juve se, Sekretares Albright se populli i Kosovës duhej të  
22 ishte në gjendje të shprehte gjykimin e vet lidhur me statusin  
23 pas skadimit të periudhës së përkohshme tre vjeçare, e saktë?

24 PË. Ai tha diçka të tillë si kjo që po thoni ju. Ne kishim  
25 përfshirë në draft dhe në dokumentin paraprak vullnetin që të

1 dhe gatishmërinë që të bëhej një referendum mbi statusin  
2 përfundimtar. Pra, ai po pasqyronte atë që po përmbante drafti  
3 tashmë.

4 PY. Në këtë takim Sekretarja Albright i tha Hashim Thaçit se  
5 draft-dokumenti nuk ndalonte, nuk parandalonte këtë të drejtë  
6 dhe se ju, z. Dëshmitar, ishit i gatshëm të bënit, të nxirrnit  
7 një letër publike në të cilën konfirmohej e drejta e popullit  
8 të Kosovës për të mbajtur, për të organizuar një referendum  
9 pas tre vitesh. A ju kujtohet kjo?

10 PË. Nuk më kujtohet kjo sepse drafti e përfshinte atë tashmë  
11 dhe ideja e të krijuarit apo të nxjerrjes, së lëshimit të një  
12 letre tjetër anash saj për të rideklaruar një pjesë që  
13 përmbahej tashmë në draft, nuk më kujtohet një gjë e tillë.  
14 Mund të shtoj se letrat shoqëruese janë tipike në këto lloj  
15 rrethanash, por thjesht nuk më kujtohet si sugjerim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është koha që  
17 të bëjmë pushimin e drekës, z. Pace.

18 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Koha për  
20 drekë. Kthehemi këtu në orën 2.30. Ju bëftë mirë. Mund të  
21 largoheni.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.  
24 Misetic.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Bazuar në kërkesën e



1 siguruesit të informacionit, do të kërkoja të kalojmë në  
2 seancë private.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
4 Kalojmë në seancë private ju lutem.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Seanca ndërpritet.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.06

18 --- Seanca rifillon në orën 14.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Mund të kalojmë në  
21 seancë publike, ju lutem?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
23 seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Do nxjerrim një vendim lidhur me këtë diskutim nesër paradite.

23 Z. Pace, do të bëjmë pushim në 3.30, kështu që kijeni

24 parasysh. A keni ndonjë ide dhe sa kohë do ju nevojitet për

25 sot.

1 Z. PACE: [Përkthim] Do përpigem të përfundojë deri në  
2 4.30, por nuk mund t'ju garantojë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse ju ndihmon për planifikimin,  
5 ne nuk mendojmë se do të kemi pyetje plotësuese për momentin.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati të  
8 vijojmë me pyetjet e Prokurorisë. Ju lutem dëgjojini me  
9 vëmendje.

10 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Dhe mirëdita, z. Dëshmitar. Më 6 mars 1999, Senatori Dole  
12 dhe ju vetë morët pjesë në një konferencë për shtyp në  
13 ambasadën e SHBA-së në Londër, ku diskutuat nënshkrimin e  
14 mundshëm të Marrëveshjes së Rambujesë, kështu?

15 PË. Po, më kujtohet kjo konferencë për shtyp. Po.

16 PY. Gjatë kësaj konference ju theksuar se problematika ishte  
17 se do të jepte leje Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për  
18 nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë, kështu?

19 PË. Do më duhet ta shihja. Mbaj mend që kam thënë që duhet të  
20 kemi mbështetjen e SHBA-së për këto bisedime.

21 Z. PACE: [Përkthim] Më mirë shohim në ekran materialin me  
22 numër P04259. Dhe shkojmë në faqen 1D00-0696. Shohim pjesën  
23 poshtë majtas.

24 PY. Për t'ju orientuar, Dëshmitar, ky material është pjesë e  
25 një libri të Mark Weller që mund ta njihni si emër, mund t'ju

1 thotë diçka emri.

2 Po presim që të dali materiali. Të presim një çast.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem mund të jepni  
4 faqen në PDF, ju lutem.

5 Z. PACE: [Përkthim] Është faqja 0696. Në PDF konkretisht  
6 nuk mund t'ju ndihmoj. Shohim pjesën poshtë në majtë ju lutem.

7 PY. Tek pika 3, "I dërguari i SHBA-së Senatori Dole dhe  
8 ambasadori Hill, Konferenca për Shtyp, Ambasada Amerikane në  
9 Londër, 6 mars 1999."

10 Z. PACE: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen tjetër ku dua  
11 të zmadhoni mesin e kolonës në të majtë, faqen në mes në të  
12 majtë. Do lexoj nga pyetja: "A po thoni se Hashim Thaçi nuk  
13 ishte ..." Ju lutem shkojmë dhe më poshtë.

14 PY. "Pyetje: A po thoni që Hashim Thaçi nuk ishte pjesë e  
15 delegacionit që takuat dje?

16 "Senatori Dole: Nuk ishte atje dje. Nuk mund ta gjenim.  
17 Kemi tre ditë që përpiqemi ta gjejmë. Mesa kuptoj unë bazuar  
18 nga bisedat me të tjerët është se vendimi do të merret nesër  
19 dhe shpresojmë që të përfundojë procesi i nënshkrimit.

20 "Pyetje: A mund të keni ju një marrëveshje pa nënshkrimin  
21 e z. Thaçi?

22 "Senatori Dole: Jo, ai do të jetë pjesë e tij.

23 "Pyetje: Si mund të keni besim ju atëherë në një proces  
24 ku personi nuk duket fare në horizont?

25 "Senatori Dole: Unë nuk e di a është ai personi kryesor

1 apo jo, e di që është drejtuesi, po.

2 "Ambasadori Hill: Senator Dole po kemi pasur një diskutim  
3 shumë të mirë me Jakup Krasniqi dje dhe çështja është nëse  
4 Shtabi i Përgjithshëm të japi urdhër që ta nënshkruajë dikush  
5 nga UÇK-ja. Qartazi, nënshkrimi në dokument do të bëhet nga  
6 dikush që është i UÇK-së. Unë nuk e di a do të jetë z. Thaçi  
7 apo z. Krasniqi apo dikush tjetër, por çështja është që Shtabi  
8 i Përgjithshëm do të japë leje."

9 A përputhet kjo me kujtesën tuaj?

10 PË. Nuk është në mospërputhje. Thaçi dhe Krasniqi kanë qenë  
11 pjesëmarrës në Rambuje prandaj ishte e rëndësishme për ne që  
12 të nënshkruhej nga një prej tyre. Nuk e di çfarë kam dashur të  
13 them kur kam thënë dhe "dikush tjetër".

14 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim materialin nga ekrani.

15 PY. Ju dëshmuat për një takim më 8 mars të 1999 apo  
16 për afërsisht në këtë datë se nuk e mbanit mend me saktësi  
17 datën. Në atë takim, a është e vërtetë që jeni takuar me Jakup  
18 Krasniqin, Sokol Bashotën dhe Ramë Bujën dhe keni diskutuar  
19 nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë?

20 PË. Po. A e keni fjalën për atë takim që pamë fotografinë  
21 më herët?

22 PË. Jo, jo, ai ishte i janarit.

23 Për t'ju orientuar, kur ju bëmë pyetje më herët ishte një  
24 dokument që ua paraqiti Mbrojtja dhe kishte një kronologji të  
25 ngjarjeve edhe ju përmendi datën e 8 marsit 1999. Dhe ju po

1 mendonit sesi mund të keni qenë ju në atë datë sepse duhet të  
2 ketë qenë në Prishtinë. Dhe për këtë ju pyeti Avokati i z.  
3 Krasniqi.

4 PË. Po, isha i paqartë sepse datat ishin shumë afër njëra-  
5 tjetrës.

6 PY. Sot ju thatë edhe pse nuk u finalizua, nuk morët ndonjë  
7 përfundim konkret nga marsi i 1999 shenjat ishin të favorshme  
8 ndonëse ju nuk dolët me një nënshkrim nga ky takim?

9 PË. E saktë.

10 PY. A e mbani mend që u vendos pas këtij takimi, në këtë  
11 takim që do të kishte një takim tjetër?

12 PË. Nuk më kujtohet, po është thjesht e logjikshme.

13 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Shohim materialin  
14 SPOE00233179-SPOE00233179-ET. Përbri të nxjerrim dhe shqipen  
15 që është SPOE00232874-00233387. Dhe faqja në shqip është  
16 njësoj si anglishtja, pra, SPOE0033179.

17 PY. Mund të fillojmë diskutimin ndërkohë që presim shqipen.  
18 Kemi anglishten në ekran. Ky është një artikull me titull  
19 "Pavarësisht dilemave të gjithë prej nesh donin një PO, ishim  
20 në favor të një PO." Mund të shihnim që është nga Jakup  
21 Krasniqi. Këtu është data 17 shkurt 2000 dhe është një  
22 artikull në gazetën Zëri. Presim një çast që të shfaqet dhe  
23 shqipja në ekran.

24 Ose për hir të kohës po filloj të lexoj nga anglishtja,  
25 po ju lexoj nga paragrafi i parë, poshtë aty ku thotë "Nga

1 Jakup Krasniqi". Shohim:

2 "Më 5 mars në fshatin Terstenik në Drenicë u mbajt një  
3 takim mes Wolfgang Petritsch dhe Christian Pauls - i pari  
4 ishte ndërmjetës i BE-së dhe i dyti Shef Kabineti në  
5 Ministrinë e Punëve të Jashtme Gjermane për Bosnjën dhe  
6 Kosovën - dhe nga Shtabi i Përgjithshëm përfaqësuesit ishin  
7 Sulejman Selimi, Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Fatmir Limaj dhe  
8 Rexhep Selimi."

9 Më 5 mars 1999 keni pasur dijeni për këtë takim?  
10 PË. Nuk më kujtohet.

11 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër tek anglishtja ju  
12 lutem. Do ju lexoj nga mesi i faqes. Gjithashtu dua të theksoj  
13 që shqipja nuk u shfaq në ekran. Por sidoqoftë është thjesht  
14 një faqe.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Ta kuptoj qartë, ky është një  
16 artikull tek gazeta Zëri?

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Po. Është një artikull tek gazeta Zëri dhe data e botimit  
19 është 17 shkurt 2000. Pra, që i bie një vit më pas.

20 PË. Në këtë kohë unë kam qenë ambasador në Varshavë, në  
21 Poloni. Dhe nuk po i ndiqja artikujt në shtypin në Kosovë.

22 PY. E kuptoj. Ky në fakt, ky takim që përmendet në këtë  
23 artikull në 5 mars, do ta shohim dhe më vonë, e kam fjalën për  
24 takimin e 5 marsit 1999.

25 PË. Në rregull.



1 PY. Shohim anglishten nga mesi i faqes. Më poshtë ju lutem,  
2 ku thotë, "Based on ..." Fillojmë te i njëjti artikull:

3 "Bazuar në atë çka kishim mësuar nga shtypi, masmedia dhe  
4 informacioni që kishim marrë nga terreni, zërat në favor të  
5 nënshkrimit të dokumentit përfundimtar të Marrëveshjes së  
6 Rambujesë në Kosovë po rriteshin gjithnjë e më shumë. Pas një  
7 udhëtimi të gjatë e të lodhshëm, Hashim Thaçi erdhi në zyrën e  
8 Shtabit të Përgjithshëm një a dy ditë përpara se të niseshin  
9 për në Paris. Duhet të bënin përgatitjet përfundimtare ose si  
10 ta themi ndryshe, do kishim diskutimet përfundimtare për të  
11 vendosur nëse do të shkonim apo jo në Paris.

12 "E vërteta është që diskutuam gjatë e gjerë nëse duhet ta  
13 prananim apo ta refuzonim dokumentin në fjalë."

14 Dëshmitar, a jeni në dijeni ju që Hashim Thaçi shkoi në  
15 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së një dy ditë përpara se Jakup  
16 Krasniqi e të tjerët të niseshin për në Paris?

17 PË. Jo, nuk kam qenë në dijeni.

18 PY. Shkojmë në fagen e tretë në përkthimin e anglishtes dhe  
19 këtu do të lexoj nga paragrafi i parë.

20 "Dilemat lidhur me pranimin apo refuzimin e  
21 marrëveshjes":

22 "Në shumë nga bisedat dhe debatet që kemi pasur në  
23 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, qofshin këto në grupe të  
24 vogla apo të madha, diskutimet ishin të singerta, me pikëpamje  
25 politike, të cilat përshtateshin me nivel detyrave dhe

1   përgjegjësive që kishte gjithsecili në hierarkinë ushtarake.  
2   Mbase për herë të parë dëshmovë sesi gjithsecili atje mernte  
3   fjalën dhe diskutonte me përgjegjshmëri për një çështje kaq  
4   serioze.

5           "Hashim Thaçi e filloi mitin duke na informuar për  
6   bisedimet që ka pasur në Shqipëri me të gjithë krerët e  
7   shtetit dhe angazhimin e shtetit shqiptar për të na mbështetur  
8   në vendimet tona. Por ai gjithashtu foli për qarqet politike  
9   dhe sociale shqiptare 'për' dokumentin e Rambujesë. Po ashtu  
10   na informoi për vështirësitë që kishte ndeshur gjatë udhëtimit  
11   nga Shqipëria drejt Bjeshkëve të Berishës. Më tej, ai  
12   falënderoi Shtabin e Përgjithshëm që e kishin besuar të bëhej  
13   kryeministri në Qeverinë e Unitetit Kombëtar të Kosovës.

14           "Më pas ai foli për punimet e Konferencës së Rambujesë  
15   dhe takimet e ndryshme që kemi pasur atje. Sa i takon  
16   konkretisht përgjigjes 'Po' apo 'Jo' për marrëveshjen e  
17   Rambujesë ai tha: 'Të dalim në një përfundim bazuar në pikat  
18   tona të forta dhe aftësitë tona, ne duhet të dimë çfarë  
19   mendojnë ata. Nuk mund ta lejojmë veten të dalim në gjykim  
20   bazuar në ndjenja por duhet të bazohemi në arsyetim.'

21           Dëshmitar, a keni pasur ju dijeni që Hashim Thaçi ka  
22   pasur takime me krerët e shtetit në Shqipëri mes Rambujesë dhe  
23   Parisit?

24   PË.   Nuk kam qenë në dijeni asokohe.

25   PY.   Po e mësuat ndonjëherë këtë?

1 PË. Më vonë kam mësuar që ka shkuar në Shqipëri. Po unë nuk  
2 mund t'ju them se kur ka ndodhur. Unë e di që SHBA-ja, ne  
3 ishim në kontakt me autoritetet shtetërore shqiptare dhe e  
4 dinim që Shqipëria e mbështeste procesin e Rambujesë.

5 PY. Shohim fagen e fundit në përkthim, do të lexoj nga  
6 paragrafi i dytë ku thotë "*Following ...*", "Pas ..."

7 "Pas analizave të shumta lidhur me rezultatet e mundshme  
8 të përgjigjes 'Po' ose 'Jo', të gjithë anëtarët e Shtabit të  
9 Përgjithshëm dolën në përfundimin, pavarësisht se nuk ishte  
10 përfundim i thjeshtë, se përgjigja përfundimtare duhet të  
11 ishte 'Po'. Komandantët e zonave që dukej se nuk kishin pasur  
12 shansin ta diskutonin çështjen në hollësi ishin ende nëse do  
13 të jepnin 'Po' apo 'Jo' por pas një analize të detajuar ata po  
14 ashtu favorizuan një 'Po'. Ata që kishin dilema të tilla ishin  
15 komandantët e Drenicës e të Llapit, konkretisht Sami Lushtaku  
16 dhe Rrustem Mustafa. I kuptoj tërësisht por isha i bindur siç  
17 jam dhe tani se mundësitë për të punuar me UÇK-në nuk do të  
18 zvogëloheshin, përkundrazi do të rriteshin, gjithçka varej nga  
19 vullneti ynë.

20 "Në fund të takimit të gjithë dhanë pëlqimin për 'Po' dhe  
21 nënshkruam procesverbalin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

22 "E vërteta është se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk  
23 tha 'Po' vetëm për arsyet që përmenda më herët që ishin të një  
24 karakteri të brendshëm. Po thanë 'Po' sepse shokët dhe aleatët  
25 tanë në shumë takime, përfshirë ata në nivele të larta, na

1    thanë: 'Kosova nuk do jetë më kurrë nën Serbinë dhe  
2    Jugosllavinë.'"

3           Dëshmitar, Jakup Krasniqi, autor i këtij artikulli thotë  
4    se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së tha po dhe kjo përputhet dhe  
5    me atë që i keni thënë ju shtypit në Londër më 6 mars 1999,  
6    pra, pikërisht çështja që duhet të jepte lejen Shtabi i  
7    Përgjithshëm për nënshkrimin, a pajtoheni me mua?  
8    PË.   Po, kjo është e logjikshme.

9           Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e këtij dokumenti.  
10   Për sqarim, anglishtja është me numër SPOE00233179 deri në  
11   SPOE00233179-ET, ndërsa shqipja me të njëjtët numra  
12   SPOE00232874-00233387, faqja 00233179. Dhe mund të jetë  
13   publik.

14           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

15           Z. ELLIS: [Përkthim] Do luteshim për një verifikim të  
16   përkthimit sepse z. Pace përmendi komandantët Sylejman Selimi  
17   aty, Jakup Krasniqi, Ramë Buja e të tjerë. E kemi shqetësimin  
18   tek fjala "komandant", dhe më pas janë emrat e tjerë. Kërkojmë  
19   të verifikohet përkthimi.

20           Z. PACE: [Përkthim] Po mungon në fakt shumësi  
21   "komandantët". Po sigurisht që ne mund ta verifikojmë  
22   përkthimin.

23           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
24   Bëni kërkesën përkatëse përmes procedurave tona për rishikim  
25   të përkthimit.

1           Materiali që u citua nga Prokuroria, 0023179-ET, 00233179  
2   në shqip pranohet.

3           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Faqja do  
4   të marri numrin P04510. Klasifikimi aktual është konfidencial  
5   por Prokurori tha që mund të riklasifikohet si publik.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thatë që  
7   është publik?

8           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është konfidencial.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
10   Ndryshoni klasifikimin.

11          Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Hiqeni dokumentin nga  
12   ekrani.

13   PY.   Dëshmitar, në Rambuje, James Rubin, siç e keni shkruar në  
14   librin tuaj, rekomandoi, domethënë, kaq larg shkoi në  
15   diskutimet e veta sa rekomandoi edhe kostumin edhe kravatën që  
16   duhet të mbante z. Hashim Thaçi?

17   PË.   E kam reflektuar në librin tim. Ky është në përputhje me  
18   mendimin tim që ai ishte në favor të z. Thaçi që të bëhej  
19   udhëheqësi i Kosovë, po.

20   PY.   Siç e keni shkruar në memoarin tuaj për Rambujenë keni  
21   thënë që Ibrahim Rugova ishte shumë i njohur, kishte shumë  
22   popullaritet edhe nëse e merrte udhëheqjen UÇK-ja nuk mund të  
23   ishte shumë mirë për ju, kështu?

24   PË.   Çfarë kam thënë unë, nuk më shërbente mua?

25   PY.   Mbase e keni pasur për autoritetet amerikane po më mirë

1 të shohim pjesën përkatëse të librit tuaj që ta kuptojmë çfarë  
2 keni thënë. Në rregull. Shohim dokumentin tuaj në ekran.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen DHT09825. Do ta  
4 lexoj nga paragrafi i fundit.

5 PY. "... nuk kisha problem që të përqendrohesha tek Thaçi, në  
6 veçanti nevojën për ta bërë atë pjesë të procesit, por duke  
7 marrë parasysh aleatët evropianë, unë besova që duhet që të  
8 luanim lojë të drejtë edhe me të tjerët po ashtu dhe të mos e  
9 përfshinin veten në politikën e brendshme të Kosovës duke  
10 favorizuar ata të cilët merrnin pjesë në rezistencë të  
11 dhunshme ndaj personave të tjerë që kishin dhënë kontributin e  
12 tyre për dekada me radhë. Unë e dija që Rugova kishte  
13 popullaritet shumë të madh dhe që eventualisht do të ishte  
14 presidenti i zgjedhur në Kosovën e lirë dhe gjithashtu e dija  
15 se çfarë përshtypje kishte UÇK-ja lidhur me të, në veçanti ne  
16 dinim shumë pak lidhur me Thaçin në atë kohë, nuk e dinim në  
17 qoftë se ai ishte lider ose në qoftë se ishte thjesht përçues  
18 i mesazheve të dikujt tjetër."

19 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po. Ne jemi takuar me tre fraksione të ndryshme në  
21 Rambuje nga ana e Kosovës, me LDK-në, me UÇK-në dhe me të  
22 ashtuquajturit intelektualët e pavarur. Për ne ishte shumë e  
23 rëndësishme që të tri këto fraksione ose këto grupe në  
24 Kosovë të ishin në mbështetje të propozimeve tona. Atëherë dua  
25 të them këtu, sikurse kam thënë dhe në dëshmi të tjera dhe në

1 herë të tjera, që unë nuk isha i interesuar që të merrja anë  
2 ose të mbështetja një grupim ndaj grupimeve të tjera në  
3 çështjet e brendshme në Kosovë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Do ndryshojmë pak temë.  
5 PY. Ju keni dhënë dëshmi që nuk ju krijua përshtypja që  
6 Hashim Thaçi ishte komandant ushtarak. Gjithashtu ju dëshmuat  
7 që sipas mendimit tuaj, Hashim Thaçi nuk ishte as luftëtar.  
8 Gjatë konfliktit, jo kur ishit në Rambuje ose në Paris, a ju  
9 kujtohen kontakte me Hashim Thaçin në një takim në Dragobil në  
10 nëntor të 1998 dhe ju keni thënë që përveç këtij takimi e keni  
11 takuar dhe një herë tjetër në verën e 1999, a është e saktë  
12 kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, është e saktë. Dhe i qëndroj kësaj dëshmie që kam  
14 dhënë. Sigurisht që fotografia që ju treguat tregonte që i  
15 kishte këmbët e hedhura njëra mbi tjetrën, kishte shumë libra  
16 në prehrin e vet, kështu që nuk është se mua apo ndonjë  
17 personi tjetër ndërmjet diplomatëve amerikanë nuk na dha  
18 përshtypjen që ai ishte luftëtar në luftë.

19 PY. A mund të na thoni se për kë fotografi e keni fjalën?

20 PË. Për fotografinë ku ne të gjithë ishim të mbledhur me  
21 njëri-tjetrin në takimin e dhjetorit, në mos gabohem.

22 PY. Bëhet fjalë për videon në Dragobil në 1998 ku ai ishte i  
23 ulur në të djathtën tuaj dhe ku merrte pjesë dhe Jakup  
24 Krasniqi?

25 PË. Po. Dhe kishte dhe disa libra në prehër. Dhe unë mund

1 t'ju them që nuk më kujtohet që kam pasur kontakte të tjera  
2 dhe në përgjithësi përshtypja ime dhe përshtypja e amerikanëve  
3 të tjerë ishte që ai nuk ishte luftëtar në luftë.

4 PY. Atëherë të përqendrohemi tek pyetja që sapo ju bëra.

5 Përveç Rambujesë, Parisit, në Dragobil në nëntor të 1998 dhe

6 takimit të verës të 1999, përveç këtyre takimeve ballë

7 përballë që keni pasur me të, a keni pasur ndonjë lloj tjetër

8 kontakti me Hashim Thaçin, apo vetëm këto ishin kontaktet me

9 të?

10 PË. Me aq sa më kujtohen mua, këto kanë qenë kontaktet e

11 vetme të drejtpërdrejta me të. Megjithatë, personat e tjerë që

12 më raportonin mua kanë pasur kontakte me të.

13 PY. A e dini në qoftë se në 1997 Hashim Thaçi ka dërguar armë

14 në Kosovë?

15 PË. Nuk jam në dijeni të kësaj dhe përsëri 1997 është përpara

16 se të jem përfshirë në çështjen e Kosovës.

17 PY. A e dini në qoftë se gjatë konfliktit Hashim Thaçi ka

18 vizituar trupat e UÇK-së në terren?

19 PË. Jo, nuk e di drejtpërdrejti, jo.

20 PY. A e dini në qoftë se gjatë konfliktit Hashim Thaçi ka

21 qenë në pararojë të forcave luftarake të UÇK-së ndërkohë që

22 UÇK-ja ka qenë në beteja duke luftuar kundër serbëve?

23 PË. Doni të thoni në beteja? Nuk e di. Nuk kam informacion

24 lidhur me këtë.

25 Z. PACE: [Përkthim] Le të shohim dokumentin DHT12206 deri



1 në DHT12372.

2 PY. Është intervista që i keni dhënë Blerim Shalës.

3 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë më konkretisht do i kërkoja

4 Sekretares që të paraqesë në ekran faqen DHT12258. Do filloj

5 me këtë faqe dhe do të vazhdojë dhe me faqen vijuese më pas.

6 Këtu do të lexoj nga pyetja e tretë që ju ka bërë z. Shala dhe

7 do të vazhdoj me faqen tjetër sikurse e thashë.

8 PY. Sa për t'ju orientuar, këtu Blerim Shala i referohet

9 takimit midis Milosheviqit dhe Rugovës që ju sikurse e

10 përcaktuam ka ndodhur në vitin 1998, më 5 maj.

11 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë do të filloj me "Shalën: Një

12 javë pas këtij takimi ...

13 PY. Shala thotë kështu:

14 "Shala: Një javë pas këtij takimi ne kemi pasur seancën e

15 parë dhe të fundit të negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet

16 udhëheqësve të Kosovës dhe ata serbë në Prishtinë që është

17 zhvilluar në selinë e LDK-së. Ju keni qenë aty, sikurse e

18 dimë, por ... ju keni qëndruar i ulur në zyrën e Rugovës ..."

19 "Hill ... po kjo është e vërtetë. Kam qenë në zyrën e

20 Rugovës dhe Veton Surroi vinte dhe më thoshte se si shkonin

21 gjërat. Nga aty sa mund të tregoja unë gjërat ishin shumë

22 pozitive. Më kujtohet që jam kthyer mbrapsht në Shkup të

23 premtën në darkë me ndjesinë që kishim arritur një lloj

24 suksesi. Dhe ata po flisnin lidhur me rregullat e ndryshme

25 sesi do të vazhdonin negociatat.

1 "Shala: Po ne e dimë se çfarë ndodhi më pas. Unë mendoj  
2 që filloi ofensiva në Deçan gjatë ose një ditë pas takimit  
3 ndërmjet Clinton dhe ...

4 "Hill: Në fakt filloi një ditë përpara, kur kam qenë në  
5 Uashington. Pjesërisht, luftimet kanë qenë një përpjekje për  
6 të minuar Rugovën dhe sigurisht për të minuar procesin e paqes  
7 dhe kjo është një gjë klasike ku radikalët zakonisht mundohen  
8 që të cenojnë ose të minojnë procesin e paqes. Megjithatë, ne  
9 e dimë se çfarë ndodhi. Në thelb faktet e rastit janë që  
10 njerëzit ende nuk pajtoheshin me këtë, por mendojnë që ishte e  
11 qartë që UÇK-ja erdhi në Deçan dhe ndërpreu rrugën. Në këtë  
12 proces serbët u larguan dhe policia serbe u kthye me armë më  
13 të forta. Dhe në përgjigje forcat serbe shkatërruan lagje të  
14 tëra duke i vënë flakën shtëpive dhe duke shtënë me armët e  
15 tyre drejt shtëpive shqiptare. Dhe UÇK-ja e ndërpreu rrugën,  
16 ndërkohë që serbët thjesht reaguesh me shumë seç duhet në  
17 mënyra të tilla që u duk sikur lufta ose beteja u fillua prej  
18 tyre."

19 A është e saktë kjo?

20 PË. Dua të them që formulimi nuk është i imi këtu. Besoj që  
21 duhet të pyesni autorin e kësaj pjese dhe se nuk është kjo  
22 mënyra sesi shprehem unë, nuk është formulimi im gjuhësor.

23 Megjithatë, tema e përgjithshme ose ideja e përgjithshme  
24 ishte që UÇK-ja fillonte diçka pastaj serbët reagonin më shumë  
25 seç duhej, por kjo si gjë është mendim i imi.

1 Megjithatë kam shqetësime me faktin, sikurse e thashë më  
2 përpara, që formulimi nuk është i imi. Domethënë, thjesht  
3 është marrë diçka që unë kam thënë dhe pastaj është formuluar  
4 ndryshe nga autori.

5 PY. A e keni lexuar më përpara këtë libër, përpara sesa t'i  
6 jepni përgjigje pyetjes së Mbrojtjes së z. Thaçi, e keni  
7 lexuar librin e Blerim Shalës?

8 PË. Jo.

9 PY. Ju në raportet tuaja, sikurse është thënë dhe në këtë  
10 pjesë të librit, thoni se kjo ishte një situatë klasike,  
11 ndërkohë UÇK-ja ndërpriste rrugën dhe serbët mbivepronin. A  
12 është formulimi juaj ky?

13 PË. Po.

14 PY. Këtu thotë që:

15 "Pjesërisht, luftimet ishin përpjekje për minimin e  
16 procesit të pages edhe Rugovën ..."

17 A është në pajtim me atë çfarë ju kujtohet juve lidhur me  
18 zhvillimet e asaj kohe, Dëshmitar?

19 PË. Po, është në pajtim me atë çfarë mendoj.

20 PY. A jeni në dijeni, Dëshmitar, në qoftë se ka pasur anëtarë  
21 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Deçan, në betejën në  
22 Deçan?

23 PË. Nuk e kam idenë fare.

24 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që këto  
25 dy dokumente të pranohen. Pjesë të tjera të këtij libri janë

1 pranuar në prova materiale dhe për të qenë më i saktë faqen që  
2 u treguan janë DHT12258 dhe faqja tjetër që është faqja që e  
3 kemi aktualisht në ekran që është 12259.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
5 kundërshtime?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim. Dhe do  
7 sugjeroja që të shtoheshin në provat ekzistuese.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT122 -- e  
9 thua dhe një herë, Prokuror?

10 Atëherë dokumenti DHT12258 deri në 12259, të dyja  
11 pranohen dhe duhet të shtohen tek provat ekzistuese.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar  
13 Gjykatës. Do të shtohen në provën ekzistuese 1D00423.  
14 Klasifikimi është publik.

15 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta hiqni  
16 dokumentin nga ekrani.

17 PY. Dëshmitar, e vetmja herë që juve ju kujtohet që ta keni  
18 takuar, ta keni parë Rexhep Selimin ka qenë në Likovc në 1998.  
19 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Gjatë seancës për përgatitjen e dëshmitarit me Mbrojtjen  
22 e z. Thaçi përpara një jave, ju përshkruat Rexhep Selimin dhe  
23 Jakup Krasniqin si "persona me iniciativë". Çfarë keni dashur  
24 të thoni me këtë?

25 PË. Ishin persona shumë të dedikuar për pavarësinë e Kosovës

1 dhe UÇK-ja ishte forca shtytëse.

2 PY. Juve nuk ju kujtohet një emër Kadri Veseli si emër ju  
3 kujtohet apo jo?

4 PË. E kam dëgjuar emrin, por ti më bën një pyetje tani për  
5 emra që mund të kem dëgjuar ose jo 27 vite më përpara. Nuk e  
6 di në qoftë se këtë emër e kam dëgjuar atëherë apo më vonë.

7 PY. Ju nuk keni njohuri lidhur me raportimin e brendshëm,  
8 sistemin e raportimit të brendshëm brenda UÇK-së, apo jo?

9 PË. Jo, nuk kam informacion lidhur me sistemin e raportimit  
10 brenda UÇK-së. Sigurisht, Shtete e Bashkuara kishin mundësi  
11 ose aftësi që të gjenin strukturat e UÇK-së, unë personalisht  
12 nuk kam informacion sa i takon sistemit të brendshëm të  
13 funksionimit të UÇK-së.

14 PY. Ju nuk keni informacion për sisteme të zbulim  
15 kundërzbulimit ose të inteligjencës së UÇK-së, apo jo?

16 PË. Mendoj që duhet të kenë pasur një sistem të tillë, po nuk  
17 kam ide, nuk e kam këtë informacion.

18 PY. Më herët juve thatë që persona të caktuar ju kanë  
19 kontaktuar për të dhënë dëshmi për këtë lëndë gjyqësore. A  
20 mund të na thoni kush ju ka kontaktuar?

21 PË. Për kërkoj lëndë e keni fjalën?

22 PË. Për këtë lëndë. A mund të na thoni kush ishte personi që  
23 ju ka kontaktuar?

24 PË. Mendoj që Avokatët Mbrojtës të z. Thaçi më kanë pyetur në  
25 qoftë se mund të jepja dëshmi.

1 PY. Kur ka qenë kontakti juaj i fundit me Blerim Shalën?

2 PË. Disa vite më përpara -- jo, prisni një çast, ai ka ardhur  
3 në Beograd kur kam qenë ambasador. Nuk kam folur me të lidhur  
4 me këtë lëndë gjyqësore, por kam folur për çështje të tjera në  
5 përgjithësi për marrëdhëniet e tensionuara ndërmjet Prishtinës  
6 dhe Beogradit.

7 PY. Më 13 tetor të këtij viti, përpara një muaji, domethënë,  
8 Mbrojtja e z. Thaçi na informoi ne, domethënë, informoi ZPS-në  
9 që ju nuk doni që të jepnit intervistë për ne, për ZPS-në. A  
10 mund të ma shpjegoni se pse është ky pozicion i juaji?

11 PË. E keni fjalën për kohën kur kam qenë ambasador në Poloni?

12 PY. Jo, jo. E kam fjalën për datën 9 tetor ku zyra ime, zyra  
13 e Prokurorisë së Specializuar të kësaj Gjykate i ka dërguar  
14 një mesazh përmes postës elektronike Mbrojtjes së Hashim Thaçi  
15 për t'ju pyetur juve në qoftë se jeni i gatshëm të jepni  
16 intervistë për ne.

17 PË. Përpara një muaji? Nuk më kujtohet, nuk e di. Nuk mendoj  
18 kështu. Mua më ka kërkuar Mbrojtja e Thaçit, më ka pyetur në  
19 qoftë se mund të jap dëshmi dhe për të diskutuar në qoftë se  
20 isha i gatshëm për të dhënë informacionin që di në këtë gjyq.

21 PY. Atëherë për të qenë i qartë, juve Mbrojtja nuk ju ka  
22 thënë asgjë, duke filluar nga data 9 tetor që ne ishim të  
23 interesuar t'ju merrnim ju në intervistë, këtë po thoni,  
24 Dëshmitar?

25 PË. Edhe një herë se më janë përzier shumë datat dhe nuk di

1 t'ju them, por unë nuk më kujtohet të më jetë bërë një pyetje  
2 e tillë që sigurisht që isha i përgatitur që t'i jepja  
3 përgjigje intervistës ose pyetjeve që mund të kishin.

4 PY. Sikurse ju e thoni në librin tuaj, gjatë takimit të 1999,  
5 në korrik të 1999 me pjesëtarë të UÇK-së në Likovc, ju mësuat  
6 që jeni takuar me njësi të UÇK-së që ishte "kundër Rugovës dhe  
7 shumë dyshues për shërbimin e zbulim kundërzbulimit të  
8 Prishtinës", a është e saktë kjo?

9 PË. Po.

10 PY. Veton Surroi ju kishte shoqëruar atje në korrik të 1998  
11 në Likovc, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Në librin tuaj ju thoni që Veton Surroi nuk u lejua që të  
14 merrte pjesë në takim, apo jo?

15 PË. Dua ta sqaroj këtë gjë. Kështu më kujtohet mua, këtë gjë  
16 kam unë në mendje. Megjithatë e kam pyetur lidhur me këtë gjë  
17 në takimin me të në Beograd përpara një viti a dy vitesh dhe  
18 ai më ka thënë të kundërtën.

19 Sigurisht, që në vitet më përpara kam qenë i përfshirë me  
20 Poloninë, me Korenë, me Irakun dhe ndoshta ekziston mundësia  
21 që të mos e kem kujtuar siç duhet në mënyrë të saktë këtë  
22 pjesë. Besoj dhe, sigurisht, domethënë, në kohën që kam  
23 shkruar librin përshtypja ime ka qenë që ai nuk u lejua që të  
24 merrte pjesë në diskutim sepse ishte dikush, babai i të cilit  
25 kishte punuar për autoritetet jugosllave ose për ministrinë e

1 punëve të jashtme të Jugosllavisë për të qenë më konkret.

2 PY. A ju kujtohet që një program televiziv përpara një viti  
3 juve keni thënë që gjatë konfliktit në Kosovë janë kryer shumë  
4 krime përfshirë këtu edhe krime ndaj serbëve, ju kujtohet kjo,  
5 Dëshmitar?

6 PË. Shumë krime përfshirë dhe krime kundër serbëve? Po, besoj  
7 që i jam referuar atyre si dhunë dhe kështu ka qenë rasti,  
8 domethënë, ka pasur shumë dhunë. Dhe kjo ishte arsyeja, pra,  
9 donim që të ndërprisnim dhunën.

10 PY. A ju kujtohet në qoftë se në këtë paraqitje tuajën  
11 televizive ju keni thënë gjithashtu që komentet tua kishin  
12 të bënin me funksionin tuaj si diplomat dhe nuk keni folur si  
13 historian apo si jurist, ju kujtohet kjo gjë?

14 PË. Ky është një koment i përgjithshëm që kam bërë për  
15 situata të tjera të cilat lidheshin me punën që kam bërë si,  
16 për shembull, Marrëveshjen e Rambujesë, bisedat në Rambuje të  
17 cilat në fund të ditës ishin të rëndësishme në mënyrë të tillë  
18 që njerëzit të ishin më tolerant.

19 PY. Do ndryshojmë përsëri temë. Keni dhënë dëshmi të  
20 anëtarëve të familjes së punonjësve të një fabrike elektrike  
21 në veri në Prishtinës ishin të shqetësuar lidhur me atë çfarë  
22 mund t'ju ndodhte këtyre punonjësve. A keni folur ndonjëherë  
23 apo keni përfshirë vëllain tuaj Nicholas, e keni folur me  
24 vëllain tuaj Nicholas sa i takon këtyre incidenteve dhe  
25 ngjarjeve që kanë të bëjnë me Kosovën?



1 PË. Unë asnjëherë nuk kam folur me vëllain tim Nicholas për  
2 çështje të kësaj natyre ose për ngjarje që përfshijnë Kosovën.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të paraqesim në ekran provën P04220.

4 PY. Ky është një dokument i BBC i Shërbimeve të Monitorimit  
5 që mban datën 4 korrik 1998, i referohet një teksti nga  
6 agjencia e lajmeve *Tanjug* dhe teksti lexon si më poshtë:

7 "Beograd, 2 korrik: Të nëntë punonjësit e minierës së  
8 Obiliqit në Kosovë që janë rrëmbyer nga terroristët etnikë  
9 shqiptarë më 22 qershor të këtij viti janë gjallë, sipas  
10 burimeve serbe."

11 Ndërkohë thuhet më tej që:

12 "Sekretari politik i ambasadës amerikane në Beograd  
13 Nicholas Hill premtoi në një takim me përfaqësuesit e EPS-së  
14 më 29 qershor, se në kontakte me përfaqësues të partive  
15 politike etnike shqiptare që kishin lidhje me organizatën  
16 terroriste UÇK, ai do të bënte më të mirën e mundshme që  
17 punonjësit e rrëmbyer të liroheshin dhe punonjësit të mund të  
18 ushtronin të drejtat e tyre për të punuar sipas një deklarate  
19 të nxjerrë nga EPS-ja."

20 Ky incident që raportohet këtu, a është incidenti që ju  
21 raportuat dhe që folët sot paradite kur folët për anëtarët e  
22 familjes së uzinës elektrike?

23 PË. Kur ne mësuam për zaptimin e këtij impianti prodhimi  
24 energjie elektrike, që me ç'më kujtohet është në veri të  
25 Kosovës, megjithatë nuk më kujtohet të kem pasur ndonjë bisedë

1 me asnjë person në ambasadën në Beograd. Megjithatë më  
2 kujtohet që ishte një çështje e ndjeshme që Kosova të --  
3 zhvillimet në Kosovë të mbuloheshin nga ambasada në Beograd  
4 sepse Kosova ishte ende pjesë e Serbisë dhe ndërkohë e di që  
5 çështja i është raportuar në mënyrë të drejtpërdrejtë  
6 Uashingtonit. Ka të ngjarë që ambasada në Beograd ka bërë  
7 gjëra ose ka raportuar gjëra të cilat kanë qenë absolutisht të  
8 pakoordinuara me njëra-tjetrën.

9 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekranin.  
10 PY. Dëshmitar, si i dërguari i posaçëm në Kosovë përfshirë  
11 këtu dhe 1998, a do kishit ju ndonjë kontribut në raportin e  
12 shtetit të Departamentit të Shteteve të Bashkuara që trajtonte  
13 Kosovën në kontekstin e praktikave e të drejtave të njeriut  
14 atë vit?

15 PË. Jo, fare. Unë trajtoja një çështje shumë konkrete, shumë  
16 specifike në Kosovë dhe kjo kishte të bënte me gjetjen e një  
17 lloj marrëveshjeje që mund të binin dakord palët.

18 PY. Por raportet që prodhoheshin a i lexonit, apo jo?

19 PË. Nuk kujtohet. Megjithatë për aq kohë sa bëhej fjalë për  
20 raporte të të drejtave të njeriut besoj që këto do kishin të  
21 bënë kryesisht me Maqedoninë.

22 PY. A ju kujtohet që keni lexuar një raport që kishte të  
23 bënte me ndalimin e 13 politikanëve shqiptarë nga UÇK-ja në  
24 Qirez?

25 PË. Nuk më kujtohet. Politikanë shqiptarë të Kosovë? Jo, nuk

1 më kujtohen. Tani që po flas më vjen në mend që më kujtohet  
2 rasti i punonjësve serbë të rrëmbyer dhe kam shprehur  
3 shqetësimet e mia.

4 PY. Jo, pjesën e punonjësve serbë të rrëmbyer i cekëm pak më  
5 lartë. Kjo pyetje nuk ka të bëjë lidhur me të.

6 PË. Jo, më kujtohet që kam shprehur shqetësimet e mia lidhur  
7 me këta punonjës serbë po jo me politikanë. Përsëri, kjo është  
8 një çështje e ndjeshme ku përgjegjësitë i kishte ambasada në  
9 Beograd, përfshirë këtu dhe aspektet logjistike apo mbështetje  
10 të tjera për KDOM-in që ka qenë në udhëheqjen e Shaun Byrnes.

11 PY. A ju kujtohet që Ibrahim Rugova t'ju ketë folur lidhur me  
12 kërcënime, sulme ose krime që pretendohen të jenë kryer nga  
13 anëtarë të UÇK-së?

14 PË. Jo, nuk kujtohet asnjë gjë që të më ketë thënë Rugova  
15 lidhur me këtë. Më kujtohen persona të tjerë në Prishtinë që  
16 kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë e Rugovës.

17 PY. A ju kujtohet Ibrahim Rugova apo ndonjë person tjetër që  
18 ju ka përmendur ju personalisht ndonjë gjë lidhur me anëtarët  
19 e UÇK-së që kanë kërcënuar një historian shqiptar ose një  
20 aktivist shqiptar në selinë e UÇK-së në Jabllanicë në tetor të  
21 1998 pasi ky person kishte kritikuar shprehimisht UÇK-në?

22 PË. Ju kërkoj ndjesë, po as kjo nuk më kujtohet.

23 PY. Jo, s'ka pse të vijë keq, s'ke pse kërkon ndjesë. Sa i  
24 takon takimit të Dragobilit më 6 nëntor 1998, me Hashim Thaçin  
25 dhe të tjerët, dje ju bë pyetja e mëposhtme, po lexoj nga

1 transkripti në kohë reale faqja 54.

2 "PY. A ju kujtohen diskutime për personat e ndaluar në  
3 këtë takim?

4 "PË. Jo, jo në këtë takim. Megjithëse çështja e  
5 personave të ndaluar diskutohej në përgjithësi, por nuk më  
6 kujtohet që kjo temë të ketë qenë një temë e veçantë e  
7 diskutuar në këtë takim."

8 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: Kur ju  
9 kujtohet juve që tema e personave të ndaluar të jetë diskutuar  
10 në përgjithësi?

11 PË. Ju kërkoj ndjesë. Në "përgjithësi", doja të thoja se doli  
12 si temë po nuk më kujtohen specifikat ose hollësitë. Ndoshta  
13 do të duhet që të shikoj procesverbalet ose dokumente të tjera  
14 që kanë të bëjnë me këtë takim për të më kujtuar ndoshta diçka  
15 më tepër. Sërish dua ta theksoj dhe një herë për të disatën  
16 herë që unë isha i përqendruar në atë çfarë më kishte kërkuar  
17 Shtetet e Bashkuara, që të bëja konkretisht që të ndihmoja për  
18 arritjen e një marrëveshjeje autonomie midis shqiptarëve të  
19 Kosovës dhe Beogradit.

20 PY. Për t'u siguruar që e kuptoj mirë përgjigjen tuaj si dje  
21 dhe sot, juve nuk ju kujtohet që të ketë pasur një bisedë  
22 lidhur me personat e ndaluar në nëntor, në takimin e  
23 Dragobilit të nëntorit të 1998, qoftë temë e përgjithshme ose  
24 konkretisht.

25 PË. Në atë takim, nuk më kujtohet të jetë bërë një diskutim i

1     tillë. Do të më duhet që të konsultohem me shënimet e mbajtura  
2     nga Tina Kaidanow. Por nuk më kujtohet sot, kanë kaluar 27  
3     vite dhe nuk më kujtohet që të jetë biseduar lidhur me këtë  
4     temë. Më kujtohet që është diskutuar pyetja nëse UÇK-ja do  
5     ishte e përgatitur që të negocionte për çështje të cilat ishin  
6     ngritur në Marrëveshjen e Rambujesë.

7             Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem paraqisni në ekran  
8     dokumentin P00792-ET dhe P00792 dhe të paraqisni faqen  
9     SPOE00068088.

10    PY.    Sikurse besoj mund ta shikoni në ekranin tuaj në të  
11    djathtë, ky është procesverbali i shqyrtimit gjyqësor mbajtur  
12    në Gjykatën Themelore të Gjakovës më 2 shkurt 2018.

13             Z. PACE: [Përkthim] Do ju lutesha Sekretares të kalojmë  
14    në faqen e dytë në të dyja versionet. Në fillim shkruhet:  
15    "Thërritet Dëshmitari Jakup Krasniqi ..."

16             Tani do të kalojmë tek faqja tjetër ku unë do lexoj duke  
17    filluar nga pyetja e fundit nga kjo faqe, atëherë tek faqja  
18    tjetër pyetja e fundit.

19    PY.    Për t'ju riorientuar, ky është një seancë dëgjimore e  
20    dëshmisë që ka dhënë dëshmitari Jakup Krasniqi në një Gjykatë  
21    të Kosovë në vitin 2018.

22    PË.    Ky është Jakup Kastrati. Jo Krasniqi.

23    PY.    Do kalojmë dhe te ky emër, por besoj që e patë tek faqja  
24    që ju tregova para një çasti ku dëshmitari ishte Jakup  
25    Krasniqi.

1 PË. Në rregull.

2 PY. E sikurse e thatë dhe juve, këtu shohim që prokurori bën  
3 pyetjen:

4 "Prokurori: Arrestimi i Jakup Kastratit dhe Cen Deskut  
5 janë prekur, janë cekur gjithashtu në një kumtesë. A keni  
6 pasur ju në atë kohë njohuri për arrestimin e tyre?

7 "Dëshmitari", që është z. Krasniqi thotë:

8 "Po, kam dëgjuar lidhur me këtë. Kemi qenë në një takim  
9 në një shtëpi në Dragobil, ku ka qenë dhe ambasadori i SHBA-ve  
10 në Maqedoni, Chris Hill i cili e ka ngritur këtë çështje dhe  
11 unë i kam thënë se ata do të lirohen dhe ata janë liruar, kjo  
12 ka ndodhur në muajin e nëntorit të vitit 1998."

13 Thjesht ua paraqita në qoftë se do ju kujtohej diçka  
14 lidhur me emrat Jakup Kastrati dhe Cen Desku?

15 PË. Jo, nuk më kujtohet asgjë. Megjithatë nuk është e  
16 pazakontë në një takim kur ti përgatitesh për tema të  
17 caktuara, ku ke studiuar lidhur me gjëra që do të diskutosh  
18 dhe kur dikush ngre një çështje tjetër, kjo çështje mund të  
19 jetë ngritur në takimin kur kam qenë unë, por nuk më kujtohet.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shikoj që ka  
21 shkuar ora 3.30, ka ardhur koha e një pushimi të shkurtër.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
23 pushim për dhjetë minuta. Duket sikur bëjmë shumë pushime, po  
24 kemi shumë veta që punojnë pas xhamave, shumë përkthyes që  
25 përkthejnë për seancën, kemi dhe stafin audioviziv dhe dua që

1 t'ju japim herë pas here ndonjë pushim për të marrë pak frymë.

2 Kështu që ju falënderojmë për mirëkuptimin.

3 Faleminderit. Dhjetë minuta pushim.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 --- Seanca ndërpritet në orën 15.30

7 --- Seanca rifillon në orën 15.42

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë me  
10 pyetjet që bën Prokurori.

11 Vazhdoni z. Pace.

12 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

13 PY. Ju kujtohet rreth nëntorit 1998 që keni ndërhyrë për të  
14 siguruar lirimin e gazetarë të Tanjugut?

15 PË. Nuk më kujtohet kjo.

16 PY. Ju kujtohet që Ambasadori Holbrooke ka deklaruar  
17 publikisht në praninë tuaj se dy gazetarë të Tanjugut do të  
18 ishin të vdekur po të mos kishte qenë falë përpjekjeve tuaja  
19 dhe Shaun Byrnes dhe Ambasadorit Walker?

20 PË. Nuk më kujtohet kjo Ambasadori Holbrooke jepte shpesh  
21 deklarime apo bënte deklarata të fuqishme të kësaj natyre, por  
22 nuk më kujtohet kjo.

23 PY. Ju kujtohet nëse në shkurt të '99-s KDOM-i i Shteteve të  
24 Bashkuara komunikoi me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së për të  
25 siguruar lirimin e dy vëllezërve serbë që ishin punëtorë

1 pylltarë, që prisnin dru?

2 PË. Nuk më kujtohet kjo. Kërkoj ndjesë. Si koment i  
3 përgjithshëm do të thoja se për neve ishte e rëndësishme që të  
4 bindnim Beogradin se struktura që kishim vendosur, krijuar në  
5 Kosovë ishin struktura që shërbenin edhe interesat e  
6 Prishtinës edhe të Beogradit dhe për këtë arsye çdo lajm i  
7 mirë i kësaj natyre ne e bënim publike, pra, komunikon në  
8 lidhje me këtë. Por kjo konkretisht nuk më kujtohet për dy  
9 pylltarët.

10 Z. PACE: [Përkthim] Shfaqim në ekran tani dokumentin  
11 P01078, faqen e parë.

12 PY. Tani që mund të shihni dokumentin në ekran shohim që  
13 është një kabllogram nga ambasada amerikane në Shkup dërguar  
14 Sekretarit të Shtetit në Uashington DC dhe të tjerëve, dhe  
15 përveç në qoftë se e lexoj gabim, nata është 1 mars 1999. Pak  
16 më poshtë shohim që përmendet "raporti i KDOM-it amerikan për  
17 datën 27-28 shkurt 1999". Më poshtë shohim që është  
18 klasifikuar nga ambasadori Hill.

19 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër të  
20 dokumentit.

21 PY. Dhe këtu në fund të dokumentit nën paragrafin 13 dhe  
22 "konfidencial" shohim "Hill".

23 Ju keni qenë Ambasadori i SHBA-së në Shkup në atë kohë,  
24 në kohën e këtij kabllogrami dhe e keni klasifikuar atë siç  
25 shihet në faqen e parë.



1 PË. Të gjitha kabllogramet që kanë dalë nga ambasada  
2 përmbanin personin që ishte përgjegjës në ambasadë në dy  
3 vende: një thjesht si fjalë përfundimtare e ambasadës që do të  
4 thotë kabllogrami fjala përfundimtare e kabllogramit është aty  
5 ku shihet emri, dhe së dyti, që është kërkesë, kusht për të  
6 thënë kush -- për të treguar se kush e ka klasifikuar  
7 dokumentin, kush ishte personi kush kishte të drejtën të bënte  
8 këtë klasifikim dhe në postet tona kjo ka qenë -- këtë gjë  
9 klasifikimin e ka bërë ambasadori. Pra shihet emri i  
10 ambasadorit në mungesë të ambasadorit mund të ketë qenë  
11 personi tjetër më i lartë pas ambasadorit. Për këto çështje  
12 administrative, këto janë çështje administative dhe s'kanë të  
13 bëjnë fare me përmbajtjen e mesazhit.

14 PY. Bazuar në klasifikimin dhe emrin tuaj aty në fund të saj  
15 nuk do të thotë detyrimisht që e keni shkruar ju atë?

16 PË. Saktë, kështu është, nuk do të thotë.

17 PY. Duke qenë se ka dalë, është dërguar nga ambasada juaj  
18 edhe pse nuk e keni shkruar duhet ta keni lexuar këtë?

19 PË. Mund ta kem lexuar, por ka shumë kabllograme. Sot ka më  
20 pak kabllograme, në kohët e sotme njerëzit dërgonte mesazhe  
21 përmes emaileve dhe mjeteve të tjera të komunikimit. Në ato  
22 ditë një ambasadë si ajo në Shkup kishte rreth 7 deri në 8.000  
23 mesazhe në vit që dërgoheshin.

24 Pra, nuk do të thotë që detyrimisht e kam lexuar atë.

25 Mund të ketë qenë diçka që ka ardh në vëmendjen time më herët

1 më parë dhe kjo thjesht për nevoja të mbajtjes së  
2 procesverbalit apo të të dhënave, të shënimeve. Mund të kem  
3 qenë në dijeni të informacionit, por nuk është e thënë që ta  
4 kem lexuar atë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen 075370, ju lutem. Do  
6 lexoj nga paragrafi 3. Në qoftë se shkojmë më poshtë pak. Në  
7 rregull.

8 PY. Dhe këtu thuhet në kabllogram, pra, do lexoj si në vijim:

9 "UÇK-ja ndaloi tre prerës drunjësh, pra pylltarë afër  
10 Rahovecit në fund të shkurtit, 28, të datës 28 shkurt. Në fund  
11 të shkurtit KDOM-i amerikan ishte angazhuar me Shtabin e  
12 Përgjithshëm të UÇK-së dhe zyrtarë të lartë të KVM0së për të  
13 siguruar lirimin e dy të ndaluarve që kishin ngelur sa më  
14 shpejt që të ishte e mundur.

15 A jua freskon kujtesën lidhur me këtë incident?

16 PË. Jo, por natyrisht që nuk është e pazakontë dhe kur KDOM-i  
17 kishte sukses, ne natyrisht donim që të siguroheshim që edhe  
18 të tjerët ta merrnin vesh dhe ta dinin për këto sukses,  
19 kryesisht Beogradi që ishte gjithmonë duke thënë që struktura  
20 që ne kishim krijuar në Kosovë ishin në një farë mënyrë në  
21 favor të Kosovës dhe përpiqeshim që kjo struktura të ishin në  
22 interes të të gjithëve, në dobi të të gjithëve.

23 Pra lajmi i mirë i kësaj natyre siç ishte ky do të bëhej  
24 publik dhe do të komunikohet sa më gjerë. Por si ambasador ju  
25 shpesh, që të flasim thjesht, përqendrohesh në lajmet e këqija

1 më shumë sesa në lajmet e mira.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë.

3 PY. Ju dëshmuat kur filloi -- se kur filloi fushata ajrore e  
4 NATO-s ju nuk kishit ndonjë kontakt me Hashim Thaçin apo  
5 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Gjatë seancë përgatitore  
6 javën e kaluar. Dëshmitar, ju thatë që jeni takuar me Hashim  
7 Thaçin gjatë një vizite në Kosovë me James Rubin në verë '99-  
8 s. A mund ta sqaroni?

9 PË. Kjo ka qenë pas fushatës ajrore dhe nuk -- dhe ka qenë në  
10 lidhje me një udhëtim që James Rubin ka bërë aty. Unë jam  
11 larguar nga Ballkani në gusht, me 8 gusht dhe do të thoja që  
12 kjo duhet të ketë ndodhur diku në mes gjatë bombardimeve dhe  
13 gushtit dhe datës 8 gusht dhe mendoj që kjo pasqyron një prej  
14 vizitave që kam bërë, prej dy vizitave që kam bërë.

15 Vizita e parë ka qenë në qershor kur Ibrahim Rugova iku  
16 dhe u lagua në Romë, e kam shoqëruar atë në Prishtinë. Dhe u  
17 largua nga Roma, pra. E kam shoqëruar atë në Prishtinë, kjo ka  
18 ndodhur me shumë gjasë në gusht pastaj ka qenë një udhëtim  
19 tjetër dhe kam qenë me Hashim Thaçin. E kam fjalën -- sorry, e  
20 ngatërrova, më vjen keq, ishte me James Rubin në atë kohë. Dhe  
21 me sa më kujtohet vizita ishte, duhej të shkohej gjatë kësaj  
22 vizite edhe në Gjakovë që ishte -- që kishte qenë shënjestër e  
23 veçantë e forcës së sigurisë serbe dhe ku pjesa e tregut e  
24 këtij qyteti të bukur ishte shkatërruar.

25 PY. A ju kujtohet që keni qenë ndonjëherë në Prishtinë,

1 konkretisht keni takuar anëtarë të Qeverisë së Përkohshme në  
2 hotel Grand atje?

3 PË. Nuk më kujtohet. Më kujtohen që jam takuar me anëtarë të  
4 stafit të Kombeve të Bashkuara aty. Mund të kem takuar njerëz  
5 nga Qeveria e Përkohshme, por nuk më kujtohet saktësisht  
6 takimit me ta.

7 PY. Në këtë rast do të -- ndoshta kjo mund t'ju rifreskojë  
8 kujtesën. Është nga intervista me Blerim Shalën dhe aty  
9 thuhet:

10 "Ndihesha pak më pak optimist kur takova me Qeverinë e  
11 përkohshme, ma merr mendja të ketë qenë ditën në hotel, në  
12 Grant Hotel, isha pak i shqetësuar. Njerëzit duket të ishin më  
13 të shqetësuar për pozitat e tyre sesa për të ndërtuar vendin e  
14 tyre të shkatërruar dhe që ishte në nevojë të mardhe."

15 A jua freskon kujtesën kjo gjë?

16 PË. Kjo është tërësisht në përputhje me mënyrën se si e kam  
17 parë situatën dhe çështje të tjera që ishin të pranishme aty.  
18 Pra ishte ditë shumë e bukur e gëzueshme kur NATO-ja pati  
19 mundësi të hyjë në Kosovë dhe të marrë përgjegjësinë për  
20 çështje të sigurisë. Mendoj që unë paguhem që të shoh edhe të  
21 jem i kujdesshëm për ditët që janë të pagëzim, e nesërmja e  
22 gëzimit, pra, dhe mund të themi që do të kishte probleme dhe  
23 kishte në fakt shumë probleme. Kisha shpresuar që do të kishte  
24 shumë më ditë muaj mjalti mund të themi apo ditë të gëzueshme  
25 edhe që marrëdhëniet të ishin më të mira midis fraksione të

1 ndryshme, po ishte e qartë që problemet ishin aty që në  
2 fillim.

3 PY. Në verë të intervistës suaj me -- kur keni bërë  
4 intervistën tuaj me Mbrojtjen e z. Thaçi, në korrik të këtij  
5 viti, lexuam si në vijim:

6 "Koncepti se konflikti kishte vazhduar pas Rezolutës 1244  
7 është tejet i ekzagjeruar. Nuk kishte, nuk ekzistonte ndjenja  
8 se konflikti vazhdonte fare pas momenteve të gëzimit të para  
9 përfundimit të këtyre momenteve."

10 PË. Mendoj që kjo është ndoshta e saktë. Çështjet që ndodhën  
11 menjëherë në atë periudhë kohore kishin të bënin me  
12 çarmatosjen, zhbërjen e UÇK-së dhe si kjo mund të realizohej  
13 sepse shumë njerëz nuk donin të dorëzonin armët e tyre dhe kjo  
14 temë, kjo çështje filloi -- pra, të krijohet nocioni i trupave  
15 mbrojtëse të Kosovës, diçka që do të përkujdesej për  
16 fatkeqësitë natyrore, në raste të fatkeqësive natyrore.

17 Unë isha në fillimet e fundit nga kjo, pra do të  
18 largohesha pasi kishim një ambasador bazuar në Uashington,  
19 James Rubins [Sipas përkthimit], i cili do të merrej me  
20 çështjet e rindërtimit pas luftës dhe formimin e qeverisë.

21 PY. Që të ndërrojmë edhe një herë temë, e dini nëse KFOR-it  
22 ka raportuar në me të korrikut 1999 e ushtarë të UÇK-së kanë  
23 shkuar në Viti me qëllim që të eliminonin kriminelë të dyshuar  
24 të luftës, edhe t'i eliminonin nga qyteti.

25 PË. Nuk jam i vetëdijshëm për këtë raport, por nuk më habit.

1 A dini nëse OSBE-ja ka raportuar se me pjesëtarë -- anëtarë të  
2 UÇK-së janë parë duke menaxhuar pika kontrolli në Rahovec në  
3 shtator të '99-s?

4 PË. Nuk jam në dijeni të kësaj. Unë në atë kohë isha kthyer  
5 në Uashington.

6 PY. Në mëngjes dëshmuat lidhur me arsyet për të cilat ju  
7 pranuat të ishit dëshmitar i thirrur nga Hashim Thaçi. Shënimi  
8 juaj -- në shënimin tuaj përgatitor thuhet që një prej arsyeve  
9 për të cilat ju e pranuat këtë ishte se ju kishit ndjenjën që  
10 ajo që po ndodh me z. Thaçi është e gabuar. A ju kujtohet të  
11 keni thënë këtë gjë Mbrojtjes së Thaçit javën e kaluar?

12 PË. Nuk më kujtohet të kem thënë këtë. Pikëpamja ime  
13 personale është dhe vazhdon të jetë, është se UÇK-ja është  
14 përpjekur të prezantojë dhe të paraqitet si një ushtri me vija  
15 vertikale të fuqishme. Nuk e kam parë këtë dhe nuk e kam parë  
16 këtë në atë kohë. Dhe për rrjedhojë kam shqetësime të vërteta  
17 lidhur me përpjekjet për të shtuar në këtë strukturë komandën  
18 dhe kontrollin. Dhe mendoj që, duke patur parasysh kalimin e  
19 kohës, ndihesha i rehatshëm që të paraqisja këto vërejtje dhe  
20 këto komente pa u përfshirë në politikat e brendshme.

21 PY. E keni lexuar aktakuzën në këtë çështje?

22 PË. Nuk e kam lexuar aktakuzën në tërësi?

23 PY. E keni lexuar dosjen paraprake të Prokurorisë në këtë  
24 çështje gjyqësore?

25 PË. Besoj që po, e kam lexuar.

1 PY. Dhe a keni marrë vetë apo ju është dhënë juve nga dikush  
2 tjetër?

3 PË. Duhet ta kontrolloj këtë. Nuk jam i sigurt. Kryesorja  
4 është që e kam lexuar. Kanë qenë një tërësi telegramesh në  
5 kohën -- disa prej të cilave mi treguar edhe ju sot, por  
6 natyrisht dua të konsultoj shënimet e mia për t'u siguruar për  
7 pasaktësitë aty.

8 PY. A i keni ndjekur deklaratat hyrëse të Prokurorisë në këtë  
9 çështje gjyqësore?

10 PË. Para ditës së sotme?

11 PY. Pra, deklaratat hyrëse janë deklaratat e bëra nga ZPS-ja,  
12 zyra ime që kanë dhënë në fillim të hapjes së këtij gjykimi.

13 PË. Jo, nuk i kam lexuar.

14 PY. Para dy vjetësh bëhej fjalë.

15 PË. Jo, nuk i kam lexuar.

16 PY. Dhe keni ndjekur qoftë live apo përmes transmetimit në  
17 faqen e internetit apo në YouTube apo raportet e ndryshme  
18 online dëshmitë e dëshmitarëve që janë paraqitur në këtë  
19 çështje gjyqësore?

20 PË. Jo, nuk i kam ndjekur.

21 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera.

22 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Z. Misetic, nuk keni pyetje juve, nga ana juaj?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Më jepni vetëm -- mund të kem

1 vetëm disa pyetje në qoftë se më lejohet.

2 Pyetjeve vijuese nga z. Misetic:

3 Z. MISETIC: [Përkthim]

4 PY. Dhe ju falënderoj për durimin tuaj në fund të kësaj dite  
5 të gjate, Ambasadori Hill. Më jepni vetëm një çast, ju lutem.

6 Mund të filloj që tani ndërsa po vendosim dokumentet të  
7 cilat do të përdorim.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, në listën e  
9 dokumenteve që kemi paraqitur fillimisht, ju lutem të shfaqim  
10 në ekran provën materiale P01077.

11 PY. Ambasador Hill, po nxjerrim një kabllogram që do ta  
12 shfaqim në ekran që besoj është i daëts 25 shkurt 1999 lidhur  
13 me pyetjen që iu bë juve nga Prokurori rreth 13 shqiptarëve të  
14 ndaluar, politikanë. A ju kujtohet që iu bë pyetje nga  
15 Prokurori?

16 PË. Po.

17 PY. Në qoftë se shikoni faqen e parë të kabllogramit thuhet  
18 aty që besoj që është dërguar nga Ambasada në Shkup?

19 PË. Ky ishte raporti i KDOM-it, ata i shkruanin këto raporte  
20 ose na vinin neve ose shkonin në Beograd, dhe pastaj  
21 dërgoheshin përmes sistemit tonë.

22 PY. Kur thoni KDOM-i më lejoni të [E pakuptueshme] të shohim  
23 nëse mund të na ndihmoni se kush e ka shkruar këtë raport.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen 8 të  
25 dokumentit.



1 PY. Data shihet është 25 shkurt 1999 sipër pjesës ku thuhet  
2 Ambasada e SHBA-së në Shkup.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim është faqja 8, paragrafi 7.  
4 Kthehemi mbrapsht. Është paragrafi me numër -- pak më poshtë,  
5 ndoshta dhe kthehemi mbrapsht pak. Po.

6 Një çast, ju lutem.

7 PY. Po, tek numri 7, shohim një pjesë të redaktuar, pastaj  
8 thotë:

9 "Këshilloj se Sahit Hasari kishte zëvendësuar Sabit Gecin  
10 si shef i policisë speciale të UÇK-së. Shtabi i Përgjithshëm  
11 kishte liruar Gecin për shkak 'gabimesh' të bëra. Burimi jonë  
12 citoi vendimin e Gecit, në shtatorin e kaluar për të ndaluar  
13 delegacionin -- për të ndaluar delegacionin e shqiptarëve të  
14 Kosovës, të politikanëve shqiptarë të Kosovës të moderuar dhe  
15 kërcënimet e vazhdueshme kundër figurave politike të LDK-së si  
16 disa prej veprimeve që kanë çuar në shkarkimin e tij nga  
17 detyra."

18 Tani, keni ndonjë dijeni nëse Sabit Geci ka ndaluar këta  
19 persona për të cilët u pyetët nga Prokurori?

20 PË. Nuk kam, nuk më kujtohet një gjë e tillë, por do të thoja  
21 që këto lloj gjërash ndodhnin, ndalimet e njerëzve dhe  
22 natyrisht kemi punuar që ata të lirohen shumë, kemi punuar  
23 shumë që ata të lirohen dhe kjo ishte pjesë e madhe e punës që  
24 bënte KDOM-i.

25 PY. Faleminderit. Tani do kalojmë tek një dokument tjetër që

1 është dokumenti që u përdor nga Prokurori. Besoj se është në  
2 librin e shkruar nga Blerim Shala, në vitin 1989, 1999 që  
3 është ndryshe, nuk është nga libri që përmban intervistën e  
4 tij me juve. Thjesht dua t'ju tregoj një pjesë. Juve ju bënë  
5 pyetje lidhur takimin me Shtabin e Përgjithshëm pas takimit me  
6 ose rreth datës 7 -- 8 mars 1999, dhe dua t'ju tregoj një  
7 pjesë tjerë.

8 PË. Po.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në  
10 ekran SPOE0058337 deri në SPOE00058431-ET [Sipas përkthimit].  
11 Është pjesë e dokumenteve që kemi vendosur rishtazi.

12 PY. Nëse zbresim pak më poshtë në fund të faqes ku Blerim  
13 Shala diskuton këto ngjarje, pra, tre, katër ditë pas takimit  
14 me UÇK-në, në paragrafin e fundit lexohet:

15 "Megjithatë, vendimi i panjohur i Shtabit të Përgjithshëm  
16 të UÇK-së pas mbledhjes, takimit të tyre të enjten dhe të  
17 premtën, me 11 dhe 12 mars, ishte akoma diçka për të cilën ne  
18 nuk kuptonin shumë. Iu afrova në një moment Jakup (Krasniqit)  
19 dhe arrita që ta pyes atë se çfarë ishte vendosur në /takimin/  
20 që ishte mbajtur në Shtab në mbledhjen e natës përpara,  
21 mbrëmjes përpara. Jakupi dukej i qetë dhe i sjellshëm, dhe tha  
22 'Gjithçka është në rregull ... Do ta nënshkruajmë marrëveshjen  
23 ...', u përgjigj ai. Pak më vonë takova Hashim (Thaçin). Dukej  
24 i lodhur, ndoshta sepse për shkak të udhëtimit të gjatë dhe të  
25 rrezikshëm që kishte bërë në këmbë përmes kufirit që ndan --

1    që i kishte ndarë shqiptarët për një shekull. Prania e Thaçit  
2    në Shtabin e Përgjithshëm ishte e domosdoshme me qëllim që të  
3    krijohej një atmosferë në mbështetje në favor të marrëveshjes  
4    që ishte ofruar. Hashim (Thaçi) tani kishte dhe mandatin si  
5    kryeministër i ri i Kosovës. Në bisedën që patëm" -- mendoj që  
6    duhet të lexohet "që ai më shpjegoi mua se si kishte shkuar  
7    mbledhja e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, se si ai në  
8    mënyrë të qetë dhe përmes urtësisë diplomatike kishte bindur  
9    udhëheqësit e luftës se ne duhej të prananim këtë ofertë  
10    historike dhe se duke nënshkruar atë, ata konfirmuan se i  
11    jepnin atij, Hashim (Thaçi), mandatin për të pranuar  
12    Marrëveshjen e Rambujesë. 'Më besoni, fola përballë  
13    komandantëve të UÇK-së, ashtu siç Ambasadori Hill më kishte  
14    shpjeguar dhe mbrojtur këtë marrëveshje përpara nesh në  
15    Rambuje', Hashimi më tha dhe pastaj vazhdoi t'u tregonte  
16    pjesëtarëve të tjerë të delegacionit -- anëtarëve të tjerë të  
17    delegacionit të Kosovës lidhur me vendimin e madh të Shtabit  
18    të Përgjithshëm të UÇK-së."

19            Po bëj një pushim për përkthyesit.

20            Tani, a e dinit ju më parë se bazuar në këtë të paktën,  
21    z. Thaçi kishte përdorur argumentet tuaja nga Rambuje me  
22    qëllim që të bindte Shtabin e Përgjithshëm që të pranonte  
23    marrëveshjen?

24    PË.    Nuk e di këtë. Por do të them kjo është saktësisht ajo që  
25    ne po përgatisnim, pra, pas tre javësh, dy javësh bisedime të

1 vështira, të ashpra, ata thanë se pajtoheshin, por duhet të  
2 ktheheshin në Kosovë dhe të bindnin të tjerët, pra, kjo ishte  
3 pjesë e procesit. E kuptoj që ka patur -- kishte shumë punë  
4 për t'u bërë akoma, dhe ndonëse ishte e këndshme të dëgjoja që  
5 ai kishte përdorur argumentet e mia përballë delegacionit, kjo  
6 nuk është diçka do të hyj në hollësi. Unë duhej të vazhdoja me  
7 punën time.

8 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund ta pyes  
9 avokatin që të sqarojë, nga dokumenti thuhet, z. Thaçi përdori  
10 argumentet e z. Hill nga Rambuje, me qëllim që të bindte  
11 Shtabin e Përgjithshëm. Unë nuk e shoh këtë. Ndoshta nuk e  
12 pashë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Sapo lexova fjalinë fjalë për  
14 fjalë.

15 Z. PACE: [Përkthim] A është fjalia e tillë?

16 "Më besoni, fola përballë komandantëve të UÇK-së ashtu  
17 siç Ambasadori Hill më kishte shpjeguar dhe kishte mbrojtur  
18 këtë marrëveshje përballë Rambujesë ..."

19 Sepse nuk është ajo që shoh.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani ky është argument. Nëse ai  
21 dëshiron të ngrejë argumente mendoj është shumë e qartë [Folës  
22 që flasin njëkohësisht] ...

23 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj keqinterpretimin.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani unë kundërshtoj  
25 kundërshtimin. Dua të them ...

1 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të shtoj diçka?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdoni.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Gjatë ditës së fundit në Rambuje,  
4 dukej shumë e zyrtë. Pra, serbët e kishin refuzuar  
5 marrëveshjen dhe dukej që shqiptarët do ta refuzonin edhe ata  
6 marrëveshjen. Unë shkova përballë delegacionit shqiptar në  
7 bodrum, në dhomë, në Rambuje ku ata po qëndronin. Nuk ishte  
8 bodrum, ishte një dhomë e bukur por në nivel, në kat më të  
9 ulët të pallatit, dhe iu dhashë një shpjegim të gjatë lidhur  
10 me arsyen se pse ata duhej ta pranonin këtë, pra marrëveshjen  
11 e Rambujesë. Në atë pikë pastaj u largova. Më vonë, rreth 30  
12 minuta, një orë më vonë, Veton Surroi, i cili kishte dalë në  
13 krye të delegacionit erdhi dhe më tha që ata e kishin pranuar  
14 atë. Dhe ai hyri brenda dhe u tha ministrave të jashtëm, të  
15 cilët po prisnin në një dhomë tjetër, se pala e Kosovës e  
16 kishte pranuar marrëveshjen e Rambujesë, por ndërkohë duhej të  
17 konsultoheshin në Kosovë.

18 Pra, ajo që shoh këtu është që Thaçi thotë se ai ka thënë  
19 atë që kam thënë, por ia ka thënë atë grupit të UÇK-së, edhe  
20 unë jam kam thënë këtë delegacionit të shqiptarëve të Kosovës.

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Faleminderit për sqarimin.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, dorëzoj këto faqe për  
24 pranim në prova dhe kërkoj që t'i shtohen pjesës që është  
25 pranuar tashmë -- e paraqitur nga Prokuroria si P04507.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 [Përkthim] SPO00058337 deri në 58431?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] 58341.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Juve thatë  
5 dy, ato dy faqe?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Mund të përdorim dy faqet që  
7 përdora, pra 58337 dhe 38.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të shtoj diçka? A mund të -  
9 -

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një sekondë,  
11 ju lutem.

12 Thuaje edhe një herë të fundit, 58438?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta përsëris edhe një herë.  
14 SPOE00058337.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe pastaj faqja në vijim që duhet  
17 të jetë 338.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po  
19 flisnit. Nuk dëgjova çfarë thatë. 338, në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 Pranohet dhe do të bashkëngjiten siç u sugjerua dhe kërkua.  
23 Po, zotëri, vazhdoni.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Thjesht desha të them se gjatë  
25 gjithë kësaj sage, pra, të kësaj periudhe që fillon nga maji

1 1998 kur unë u përfshiva në këtë, problemi ishte që njerëzit e  
2 ndryshëm që përshkruheshin si UÇK të arrihej dhe të sigurohej  
3 mbështetja e këtyre njerëzve, pra, në këtë proces. Shpesh herë  
4 UÇK-ja ishte më shumë e preokupuar me marrjen e autoritetit  
5 nga LDK-ja dhe ne kemi parë shenja, shfaqje të kësaj gjëje.  
6 Por në kohën kur ne arritëm në ato dy javë në Rambuje, u bë e  
7 qartë se kreu i delegacionit të UÇK-së që z. Thaçi - që është  
8 pra, z. Thaçi, i kishin pranuar idetë se kjo ishte mënyra më e  
9 mirë për të ecur përpara, dhe mendoj që nuk e kisha parë kurrë  
10 më parë, por kjo jep dëshmi se ai kishte kuptuar jo vetëm se  
11 kjo ishte mënyra më e mirë për të ecur përpara, por se  
12 argumentimi që mbështeste këtë ishte mënyra më e mirë për të  
13 ecur përpara.

14 Dhe në ato ditë, në shkurt, mars 1999, ne nuk e dinim se  
15 çfarë duhet të ndodhte më pas. Kishte dhunë në terren, fushata  
16 bombardimeve ajrore vazhdonte, e cila zgjati 7 ditë. Ne nuk e  
17 dinim se ku do të çonte kjo, si do të përfundonte.  
18 Përfundimisht mori fund. Serbët i tërhoqën forcat e tyre të  
19 sigurisë dhe u bë përpjekje që të qetësohej situata dhe kjo  
20 përpjekje mendoj përfundimisht ishte e suksesshme.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë  
22 tjetër, z. Misetic?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] vetëm një material tjetër, në  
24 qoftë se më lejohet.

25 PY. Ambasador Hill, në qoftë se mund t'ju tregoj tani, dhe i

1 kërkoj Znj. Sekretare, që të shfaqë në ekran dokumentin  
2 P04510. Juve iu tregua ky dokument, që është artikull, besoj,  
3 i përgatitur nga z. Krasniqi. Dhe thjesht do t'ju bëj disa  
4 pyetje sepse ju sugjerua juve se Shtabi i Përgjithshëm ishte  
5 pajtuar me Rambujenë dhe se ju kishit nevojë për konfirmimin,  
6 po citoj këtu, të Shtabit të Përgjithshëm.

7 Dhe thjesht dua të shoh sepse nuk kemi trajtuar çështjen  
8 se si, kush keni kuptuar ju se ishte Shtabi i Përgjithshëm.  
9 Dhe dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë.

10 PË. Kjo ka qenë në periudhën kohore përpara nënshkrimit në  
11 Paris. Për këtë e keni fjalën? A e kuptoj saktë?

12 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Kërkoj ndjesë. Kjo ishte periudha nga 8 marsi deri në 15  
14 mars, në atë periudhë.

15 PË. Në rregull.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, duhet t'ju jap  
17 numrin e saktë ERN, që është SPOE00233179 deri në  
18 SPOE00233179-ET në provat e paraqitura nga Prokuroria. Mendoj  
19 që versionin në anglisht është i mjaftueshëm. Ky është  
20 artikulli.

21 PY. E shikoni datën, pra, që është 17 shkurt 2000?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 4 të dokumentit.  
23 Në paragrafin e dytë në tekst ku diskutohet takimit ku u bë  
24 votimi dhe thotë --

25 PË. Krasniqi po diskuton?



1 PY. Po.

2 "Pas analizave të shumta lidhur me rezultatet e mundshme  
3 të një përgjigje 'po' a 'jo', të gjithë anëtarët e Shtabit të  
4 Përgjithshëm dolën në përfundimin, ndonëse nuk ishte një  
5 përfundim i lehtë se përgjigja përfundimtare duhet të ishte  
6 'po'. Komandantët e zonave operative që dukej se nuk kishin  
7 pasur shansin ta diskutonin çështjen në hollësi dhe të  
8 shtjelluar ishin ende të paqarë mes 'po-së' edhe 'jo-së', por  
9 pas një analize të detajuar ishin në favor të 'po-së' edhe  
10 ata. Ata që kishin dilema ishin komandantët e Drenicës dhe  
11 Llapit, përkatësit Sami Lushtaku dhe Rustem Mustafa. Unë i  
12 kuptoj tërësisht qëndrimin e tyre po unë isha i bindur atëherë  
13 sikur jam dhe tani se mundësitë për të punuar me UÇK-në nuk  
14 duhet të zvogëloheshin, por përkundrazi do të rriteshin.  
15 Gjithçka varej nga vullneti ynë.

16 Pyetja ime është kjo -- pra, pyetja im është kjo: A jeni  
17 ju në dijeni se në këtë vendim të Shtabit të Përgjithshëm  
18 ishin përfshirë dhe anëtarë të zonave operative, komandantë të  
19 zonave operative kur morën vendim përfundimtar?

20 PË. Nuk kam -- nuk jam në dijeni të kësaj. Duhet të theksoj  
21 se ka pasur shumë teori me këtë organizimin të ashtuquajtur  
22 Shtabi i Përgjithshëm. Ne donim një person në Rambuje që të  
23 fliste për UÇK-në që më pas të kthehej dhe të konsultohet me  
24 UÇK-në dhe të merrnim një 'Po'. Por ne kishim frikë se mos do  
25 kishim LDK-në edhe grupin intelektualëve të pavarur që do

1 thonin po, dhe UÇK-ja do na thoshte jo. Dhe na e prishte të  
2 gjithë punën kjo gjë.

3 Pra, fakti është që z. Thaçi e shpjegoi që duhet të  
4 kthehej ai dhe të tjerët duhet të ktheheshin, por ai ishte  
5 personi që e kishte më të vështirë tua shpjegonte personave që  
6 ishin skeptikë, ndërsa besoj që Rugova e kishte më të lehtë  
7 detyrën sepse shumica e LDK-së donin të shihnin fundin e  
8 konfliktit.

9 Unë nuk kam qenë në dijeni të kësaj, por unë u ndjeva  
10 shumë pozitiv, shumë optimist kur pashë këtë dhe në fakt ne  
11 kishim të drejtë.

12 PY. Faleminderit për përgjigjet tuaja dhe faleminderit për  
13 dëshminë tuaj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts, a  
15 kishit ju diçka që donit të diskutonit lidhur me atë  
16 kundërshtimin e mëparshëm?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do ta  
19 mbyllin për sot atëherë. Do të rifillojmë nesër në orën 9.00.  
20 Jeni afër fundit. Nesër paradite do të jenë pyetjet e  
21 Gjykatësve, mbase do të kenë ndonjë pyetëse plotësuese prej  
22 palëve, por jemi drejt fundit.

23 Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe shihemi nesër në  
24 orën 9.00.

25 Z. PACE: [Përkthim] Për çështje planifikimi, ne kishim

Dëshmitari: Christopher Hill (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga z. Misetiç

Faqe 163

1 menduar që do të fillonim me dëshmitarin tjetër, nuk e di  
2 çfarë mund të na thotë Mbrojtja.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, dëshmitari ka ardhur sot dhe  
5 do të jetë gati të fillojë nesër pasi të përfundojë ky  
6 dëshmitar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
2 atëherë. Nesër do të fillojmë me dëshmitarin e dytë. Shihemi  
3 nesër në orën 9.00.

4 Ka diçka që doni të thoni z. Dixon? Jo.

5 Mirë. Seanca mbyllet këtu.

6 --- Seanca mbyllet në orën 16.18

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25